

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



# Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit  
SPECIALE



110

vjet

USHTRI  
SHQIPTARE



**DREJTOR**  
ARBEN SKËNDERAJ

**Shefe e Sektorit të Botimeve  
& Kryeredaktore**  
ANJEZA MUSOLLARI

**GRAPHIC DESIGNER**  
AFËRDITA HYSAJ

**REDAKTORE / KORREKTORE**  
SUELA HODA

**Kryetar Bordi**  
ANJEZA MUSOLLARI

### Bordi

- PROF. ASOC. DR. **BERNARD ZOTAJ**  
MJESHTËR I MADH
- PROF. ASOC. DR. **ZAHO GOLEMI**
- KOLONEL (R) **SALI ONUZI**
- GJENERAL BRIGADE **ILIR PUJO**
- GJENERAL BRIGADE(R) **BARDHYL KOLLÇAKU**
- DR. **ASLLAN ZEMANI**
- KOLONEL **HYSNI GJERGJI**
- **SAKIP CAMI**



## SPECIALE

- “Në të ardhmen nuk do të ketë liderë gra, apo burra, do të ketë thjesht liderë”..... **12**
- AFA, arsimim, strategji, doktrinë, inovacion, punë kërkimore ushtarake ..... **16**
- Forca Detare, syri vigjilent i deteve shqiptare..... **20**
- Forca Ajrore, margaritarët e vendit të shqiptonjave..... **24**
- Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, strukturë e re e Forcave të Armatosura ..... **28**
- Shqipëria, pjesë e familjes së madhe të sigurisë euroatlantike, përfitimet dhe detyrimet..... **32**
- Gjithçka është armë dhe fushëbeteja është kudo ..... **36**
- Institucionet e para të Ushtrisë Shqiptare..... **40**
- Liderët që shënjuan histori në rrugëtimin shekullor të Forcave të Armatosura ..... **42**
- 110 vjet FARSH ..... **54**
- 27 shefat e Shtabit të Përgjithshëm ..... **60**
- Shtypi ushtarak, artileria e rëndë e ndërgjegjes, drejt shekullimit të tij ..... **70**
- Krijimi i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës (1912-1914) ..... **74**
- Ngritja e Ushtrisë, Institucioneve të Mbrojtjes dhe Sigurisë, 1925-1939 ..... **80**
- Ushtria Shqiptare në vitet 1945-1990 ..... **84**
- Arsimiti ushtarak shqiptar, 1958-2022 ..... **90**
- Forcat e Armatosura Shqiptare në demokraci ..... **96**



# 08

## Forcat e Armatosura, aseti më i vyer i historisë shqiptare

Parimet themelore që frymëzuan themeluesit e shtetit shqiptar, parimi i së drejtës për jetë, i lirisë dhe i kërkimit të lumturisë, janë themel i patjetërsueshëm i parimeve universale për të drejtat dhe liritë e njeriut kudo në botë...

# 10

## Nderi, Detyra, Atdheu, trinomi që trupëzon vlerat e ushtarakëve

Ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura me mesazhe të rëndësishme për një vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura...

# 14

## Transformimi dhe modernizimi i FARSH-së në 110-vjetorin e saj

Dhjetori i këtij viti shënon 110 - vjetorin e krijimit të Forcave tona të Armatosura, të cilat lindën me shtetin shqiptar dhe pavarësinë e Shqipërisë...

# 18

## AFA, arsimim, strategji, doktrinë, inovacion, punë kërkimore ushtarake...

Misioni i një institucioni arsimor, përfshirë edhe institucionet arsimore ushtarake është në thelb i njëjtë - të përgatisin studentët e tyre...



## 110-vjetori i krijimit të Forcave të Armatosura

Me rastin e 110-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kam nderin dhe kënaqësinë që, si President i Republikës së Shqipërisë dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, të përcjell përhëndetjet më të ngrohta dhe urimet më të mira për të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe civilët, që sot shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare dhe të gjithë ata që kanë shërbyer ndër vite. 4 dhjetori i vitit 1912 është një datë e skalitur jo vetëm në historikun e Forcave tona të Armatosura, por në historinë e shtetit dhe kombit tonë. Të themeluara nga arkitektët e shtetit të sapokrijuar shqiptar, ato u konceptuan si një kolonë e domosdoshme për jetëgjatësinë e tij dhe garantë të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Përgjatë këtij rrugëtimi jo të lehtë 110-vjeçar, ato janë bërë njëherazi edhe përçuese të traditave më të mira shqiptare, qofshin ato ushtarake, shpirtërore, intelektuale apo profesionale, me kontribut të paçmuar në lartësimin e emrit dhe nderit të vendit dhe kombit tonë. Sot kujtojmë me respekt dhe mirënjohje të thellë të gjithë ata kolegë e miq, që kanë shërbyer e shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare dhe kanë vënë në themel të shtetit, lirisë dhe sigurisë së atdheut dhe popullit tonë, përkushtimin, nderin, mundin dhe sakrificat e jetës së tyre. Në mënyrë të veçantë nderojmë kujtimin e atyre, që kanë bërë sakrificën më sublime, duke dhënë jetën në mbrojtje të lirisë dhe nderit të popullit tonë. Kombi u është përjetë mirënjohës burrave dhe grave trime...

Faqe 5



PRESIDENTI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
**BAJRAM BEGAJ**

# Forcat e Armatosura, lavdia, nderi dhe krenaria e kombit shqiptar

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijjnë sot në këtë 110-vjetor të themelimit, si një forcë moderne, anëtare e NATO-s dhe aleate e besueshme, e aftë të përmbushë misionin e saj kushtetues dhe detyrimet Euro-Atlantike.



**M**e rastin e 110-vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kam nderin dhe kënaqësinë që si President i Republikës së Shqipërisë dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, të përcjell përshëndetjet më të ngrohta dhe urimet më të mira për të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët dhe civilët, që sot shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare dhe të gjithë ata që kanë shërbyer ndër vite.

4 dhjetori i vitit 1912 është një datë e skalitur jo vetëm në historikun e Forcave tona të Armatosura, por në historinë e shtetit dhe kombit tonë. Të themeluara nga arkitektët e shtetit të sapokrijuar shqiptar, ato u konceptuan si një kolonë e domosdoshme për jetëgjatësinë e tij dhe garantë të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit.

Përgjatë këtij rrugëtimi jo të lehtë 110-vjeçar, ato janë bërë njëherazi edhe përçuese të traditave më të mira shqiptare, qofshin ato ushtarake, shpirtërore, intelektuale apo profesionale, me kontribut të paçmuar në lartësimin e emrit dhe nderit të vendit dhe kombit tonë.

Sot kujtojmë me respekt dhe mirënjohje të thellë të gjithë ata kolegë e miq, që kanë shërbyer e shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura shqiptare dhe kanë vënë në themel të shtetit, lirisë dhe sigurisë së atdheut dhe popullit tonë, përkushtimin, nderin, mundin dhe sakrificat e jetës së tyre.

Në mënyrë të veçantë nderojmë kujtimin e atyre, që kanë bërë sakrificën më sublime, duke dhënë jetën në mbrojtje të lirisë dhe nderit të popullit tonë. Kombi u është përjetë mirënjohës burrave dhe grave trime, sakrificat e të cilëve do të jetë gjithmonë frymëzim për çdo shqiptar e shqiptare, me uniformë ose jo, për t'i shërbyer atdheut me përkushtim e dashuri, në kohë paqeje a lufte, deri në ditën e fundit të jetës.

Mirënjohje dhe falënderimet më të përzemërta për të gjithë ata që sot janë larg familjeve të tyre, në misionet e ndryshme, përkrah aleatëve tanë të NATO-s, për përkushtimin, shërbimin dhe sakrificat e tyre në lartësimin e emrit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe garantimin e lirisë dhe paqes në rajon dhe botë.

Përkushtimi, integriteti dhe angazhimi i pakursyer i ushtarakëve shqiptarë ndër dekada, ka bërë që Forcat e Armatosura të jenë sot një nga institucionet më të besuara e më të respektuara nga populli dhe institucionet e ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.

Pa asnjë mëdyshje, Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë sot nderi dhe krenaria e vendit, një armatë që u gjendet pranë qytetarëve në çdo kohë, siç është dëshmuar në të gjitha rastet e fatkeqësive të ndryshme natyrore.

Nuk mund të lë sot pa falënderuar, në mënyrë të veçantë, prindërit, bashkëshortet, bashkëshortët, fëmijët e familjet e ushtarakëve, të cilët janë pjesë e familjes tonë të madhe dhe meritojnë, sot e çdo ditë, të gjithë respektin dhe mirënjohjen e çdo qytetari të Republikës për mbështetjen e tyre të vazhdueshme, për sakrificat dhe privimet e shumta.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijnë sot në këtë 110-vjetor të themelimit, si një forcë moderne, anëtare e NATO-s dhe aleate e besueshme, e aftë të përmbushë misionin

e saj kushtetues dhe detyrimet Euro-Atlantike, e angazhuar në një sërë misionesh në mbrojtje të paqes dhe sigurisë, jo vetëm në vend, por edhe në rajon e në botë.

Arritjet e deritanishme janë rezultat i përkushtimit dhe mundit të përbashkët, por edhe i mbështetjes së vyer e të pazëvendësueshme të miqve dhe aleatëve tanë të NATO-s. Mirënjohja dhe vlerësimi jonë është maksimal për ndihmën e dhënë për transformimin, modernizimin, trajnimin, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve tona ushtarake, falë bashkëpunimit tonë të ngushtë në tre dhjetëvjeçarët e fundit.

Ky 110-vjetor vjen me sfida të mëdha. Me fillimin e agresionit të pajustificuar të Rusisë ndaj Ukrainës, disa muaj më parë, u bëmë të gjithë dëshmitarë të një përkeqësimi shqetësues të mjedisit global të sigurisë. Agresioni rus nuk ka cenuar vetëm integritetin dhe sovranitetin territorial të Ukrainës, por ka sfiduar dhe shkëputur gjithë rendin botëror, duke na dëshmuar edhe një herë brishtësinë e paqes dhe paparashkueshmërinë e kërcënimeve të sigurisë.

Shohim që rreziqet e sigurisë sa vijnë e shumëfishohen, ndërthuren në natyra konvencionale e jo konvencionale, duke e bërë tablonë strategjike gjithnjë e më të ndërlikuar e nevojën për përshtatje e gatishmëri gjithnjë e më të domosdoshme.

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s sjell nevojën për ndryshime të ndjeshme dhe bashkëpunim edhe më të ngushtë me vendet aleate për rishikim a përmirësim të planeve të mbrojtjes dhe rritje të ndërveprueshmërisë me aleatët, përmes pjesëmarrjes në stërvitje dhe operacione të përbashkëta.

Ndikimet e luftës në Ukrainë janë dëshmuar të një natyre tejte komplekse. Ato jo vetëm kanë sfiduar fusha si siguria energjetike, kibernetike dhe ushqimore, por kanë rritur gjasat për përkeqësim të sigurisë në rajone të brishta, si Deti i Zi, vendet Baltike dhe Ballkani. Duke marrë në konsideratë synimet destabilizuese të aktorëve të ndryshëm shtetërorë ose jo, bashkëpunimi me vendet e rajonit e në veçanti me Kosovën duhet të forcohet më tej për të bashkërenduar të gjitha energjitë parandaluese dhe reaguese.

Sulmet e fundit kibernetike ndaj infrastrukturës kritike të vendit tonë, nga aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë, mbeten një kërcënim, që duhet të vazhdojë të marrë të gjithë vëmendjen e duhur nga ana jonë për të rritur kapacitetet parandaluese, mbrojtëse dhe reaguese. E gjithë kjo situatë e re paraqet sfida të shtuara për Forcat e Armatosura dhe gjithë institucionet e vendit tonë, të cilat kërkojnë më shumë se kurrë përkushtimin, përgjegjshmërinë dhe angazhimin e pakursyer të të gjithëve ne.

Si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, unë jam i bindur se angazhimi dhe detyrimi jonë do të vijojë të mbetet i shenjtë ndaj Atdheut, Nderit dhe Detyrës!

Në përfundim, më lejoni të them se kam nderin që vij nga radhët tuaja dhe që kam pasur privilegjin e rrallë që kam shërbyer si Shefi i Shtabit i Forcave të Armatosura.

Kjo më ngarkon me përgjegjësi të shtuar në ushtrimin e detyrës, që mbaj sot, për të dëshmuar para jush dhe gjithë kombit shqiptar vlerat më të mira të kultivuara ndër vite, si pjesëtar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gëzuar 110-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura!

Faleminderit për mbështetjen dhe miqësinë tuaj!

*Me përshëndetjet më të ngrohta,*

*Bajram Begaj*



MINISTRI I MBROJTJES,  
NIKO PELESHI

# Forcat e Armatosura, aseti më i vyer i **historisë shqiptare**

Parimet themelore që frymëzuan themeluesit e shtetit shqiptar, parimi i së drejtës për jetë, i lirisë dhe i kërkimit të lumturisë, janë themel i patjetërsueshëm i parimeve universale për të drejtat dhe liritë e njeriut kudo në botë.





**Mirënjohje dhe respekt të veçantë për të gjithë ata burra e gra që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre, duke kryer detyra në shtabet dhe misionet e NATO-s kudo në botë. Jemi krenarë për ju dhe jemi bashkë me ju, përkrah misionëve të vështira ku ju i shërbeni stabilitetit, demokracisë dhe paqes. Misioni që ju kryeni është sa fisnik aq edhe shumë i rëndësishëm.**



I nderuar President i Republikës së Shqipërisë,  
I nderuar zoti Kryeministër,  
I nderuar Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura,  
Gjeneralë,  
Të dashur efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,  
Jam i nderuar, të jem mes njerëzve të sakrificës dhe vetëmohimit sublim, të punosh me ju është privilegj!  
Sot, në 110-vjetorin e krijimit të Ushtrisë Shqiptare, mund të themi pa asnjë mëdyshje se 4 dhjetori i vitit 1912 shënon datën e lindjes së simbolit të një vendi të luftës për liri, demokraci dhe prosperitet. Parimet themelore që frymëzuan themeluesit e shtetit shqiptar, parimi i së drejtës për jetë, i lirisë dhe i kërkimit të lumturisë, janë themel i patjetërsueshëm i parimeve universale për të drejtat dhe liritë e njeriut kudo në botë. E kush më mirë se bijtë dhe bijat e një kombi të etur për liri do të luftonin për të arritur këtë qëllim.  
Ushtria shqiptare, aseti më i çmuar i historisë sonë..., krenarët, të paepurit ndaj çdo sfide. Nuk mund ta përshkruaj trimërinë, nderin dhe traditën e kësaj force luftarake të jashtëzakonshme. Ushtarakët kanë qenë pjesë e triumfit dhe historisë më të lavdishme të popullit shqiptar, nga betejat e mëdha gjatë luftërave, në misionet humanitare dhe mbrojtje të lirive në mbarë botën.  
Ndoshta nganjëherë ne, civilët, ndjehemi të shkëputur nga shërbimi dhe sakrifica e forcave tona të armatosura. Por e di se mund të flas në emër të kolegëve të mi, kur them që kemi nderin të punojmë krah për krah jush, si një ekip në misionë paqeje dhe luftime. Ju ndihmoni të bëni atë, që ne bëjmë të mundur, dhe ju falënderojmë, ju dhe familjet tuaja për orët pambarim, larg tyre... Më 4 Dhjetor 1912, pikërisht disa ditë pasi burri i madh i kombit shqiptar, patrioti Ismail Qemali, vendosi gurin e parë në themelet e shtetit shqiptar, një nga dekretet e para dhe ndër më të rëndësishmit që ai firmosi, ishte krijimi i Ministrisë së Luftës dhe emërimi i Mehmet Pashë Dërallës si ministër i parë i saj. Krijimi i Ministrisë së Luftës, në atë kohë të vrullshme të historisë dhe të ekzistencës së shtetit shqiptar të sapoformuar, ishte domosdoshmëri historike dhe jetike për mbijetesën e kombit tonë dhe të pavarësisë së porsa shpallur.  
Ministria e Luftës, mori përsipër barrën e madhe historike, misionin e ruajtjes së pavarësisë së vendit dhe mbrojtjes së qeverisë së parë të shtetit të ri shqiptar, duke mos pasur asnjë strukturë të mirëfilltë ushtarake, përveç vullnetarëve dhe mbështetësve të tyre, trimave shqiptarë, atyre që ndoqën pas atin e kombit, Ismail Qemali, por edhe krahu i palëkundur i luftëtarëve të Kosovës martire, të cilët krijuan ushtrinë e parë të Ministrisë së Luftës,  
Ata e realizuan me sukses misionin që historia iu kishte ngarkuar.  
Është kjo histori që na bën krenarë, por njëherazi na ngarkon me përgjegjësi akoma më të madhe për të vijuar atë që këta burra shteti filluan në ato kohë shumë të vështira.

Forcat tona të Armatosura kanë trashëguar dhe vazhdojnë të përçojnë vlerat më të mira të traditës sonë patriotike si dhe vetitë më të mira, të atyre që mundësuan formimin e shtetit shqiptar.  
110 vjet histori e artë e popullit shqiptar, e cila na bën krenarë për çfarë kemi arritur në këtë rrugëtim të gjatë dhe plot sakrifica.  
Sot, ne kemi një ushtri profesioniste, të trajnuar dhe arsimuar, e cila po përcohet dita - ditës, duke pasur vizion e synime të qarta për të ardhmen.  
Forcat e Armatosura janë pjesë e organizatës më të fuqishme të sigurisë në botë dhe anëtarësimi në NATO e ka shndërruar Forcën e Armatosur në një pjesë vitale të vendit tonë.  
110 vjet më parë, trimat e kombit shqiptar i dolën për zot vendit, ndërsa sot në më shumë se një shekull, djemtë dhe vajzat e ushtrisë shqiptare, shkojnë t'i dalin zot vlerave të paqes dhe lirisë atje ku e kërkon nevoja, në vendet ku këto vlera janë vënë në rrezik.  
Mirënjohje dhe respekt për punën dhe kontributin tuaj!  
Në këtë ditë të veçantë, dua të përshëndes të gjithë personelin e Forcave të Armatosura për kontributin, angazhimin, përkushtimin, sakrificën e treguar për realizimin e të gjitha detyrave në përmbushje të misionit kushtetues. Këta burra dhe gra sakrifikojnë çdo ditë nga jeta e tyre personale dhe i përkushtohen kauzës së sigurisë dhe të mbrojtjes, jo vetëm të vendit tonë, por edhe të hapësirës euroatlantike, së bashku me familjen tonë të madhe të përbashkët, atë të NATO-s.  
Mirënjohje dhe respekt të veçantë për të gjithë ata burra e gra që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre, duke kryer detyra në shtabet dhe misionet e NATO-s kudo në botë. Jemi krenarë për ju dhe jemi bashkë me ju, përkrah misionëve të vështira ku ju i shërbeni stabilitetit, demokracisë dhe paqes. Misioni që ju kryeni është sa fisnik aq edhe shumë i rëndësishëm.  
Dua t'ju siguroj se kontributi, munda dhe sakrifica juaj, ka vëmendjen, mbështetjen dhe mirënjohjen, jo vetëm të lidershit politik dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, por dhe të gjithë shoqërisë sonë, që sot më shumë se kurrë kupton vlerën e sakrificës tuaj në luftën ndaj atyre që cenojnë vlerat e lirisë, të paqes dhe stabilitetit.  
Përkulem me respekt të thellë për të gjithë ata që me vetëmohim kanë bërë edhe sakrificën më të lartë në shërbim të atdheut, duke dhënë jetën brenda vendit apo jashtë tij, për të ngritur lart emrin e Shqipërisë në krah të aleatëve tanë strategjikë. Do të mbeten pjesa më e ndritur e historisë së kombit shqiptar.  
Forcat e Armatosura, në rrugëtimin e tyre të gjatë por të suksesshëm, kanë arritur të jenë me dinjitet të plotë profesional krah aleatëve tanë strategjikë dhe kjo falë edukimit dhe trajnimit që FA-ja ka marrë në fushën e edukimit, trajnimit dhe përkushtimit.  
Sot arsimimi ushtarak është avangardë i mendimit shkencor, dijes, inovacionit teknologjik, para të cilit jemi në një sprovë të madhe.  
Ne po ndërtojmë qendrën e inovacionit, e cila po merr jetë nga dita

## Me mbështetjen e jashtëzakonshme të qeverisë shqiptare dhe kryeministrit të saj z. Edi Rama, ky përvjetor i gjeti Forcat tona të Armatosura me vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim dhe rritje të aftësive të tyre.



në ditë për të qenë sa më funksionale. Po synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale, por edhe të dijes shqiptare.

Fokusi kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes ka qenë transformimi rrënjësor i Akademisë së Forcave të Armatosura duke i dhënë asaj frymën, formën e përbajtjen e Akademisë “West Point” (SHBA). Kjo kërkoi rritjen e efektivitetit në çdo aspekt të punës që nga modernizimi i kurrikulës, ngritja cilësisht e rekrutimit të trupës pedagogjike e komanduese, motivimi i saj e natyrisht krijimi i një kampusi modern.

Po punojmë për ndërtimin e kampusit të ri të AFA-së me të gjithë parametrat. Është duke përfunduar master-plani, aty ku sot është Batalioni i Mbështetjes, kemi në përfundim procedurat për lidhjen e kontratës dhe fillimin e ndërtimit të godinës së parë. Jam i bindur që në rajon do të jetë projekti më i mirë, më i bukur dhe më i plotë, duke u kthyer në vatrën ku përgatitet mendimi më i përparuar në fushën e sigurisë e të mbrojtjes.

Zhvillimi dhe Inovacioni duhet të bëhet kryefjala e punës kërkimore e shkencore e stafëve akademike - mësimore e strukturave kërkimore e shkencore.

AFA do të jetë krenaria e Forcave tona të Armatosura, e hapur vetëm para një viti. Ndërkohë ajo sot është vendosur në qendër të ambicies sonë për modernizimin e FA-ve. Për ne, modernizimi nuk është vetëm investim në infrastrukturë, në kapacitete, por së pari fillon nga dija.

Akademia e FA-së është institucioni i dijes i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, është struktura e parë e integruar në strukturën euroatlantike, që është aspirata e gjithë popullit shqiptar, pra, ne jemi pjesë e NATO-s dhe nesër hapi tjetër i yni është integrimi në Bashkimin Europian. Jemi anëtarë të denjë në NATO, kemi përfaqësuar vendin tonë, një vend të vogël me burime të kufizuara, por me shpirt të madh në misionin ndërkombëtar, duke fituar një emër të mirë në radhët e NATO-s.

Vlen të përmendim stërvitjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Ne patëm shansin të integrohemi në një shkallë të gjerë, në stërvitjen më të madhe të zhvilluar në 30 vite në rajonin tonë, “Defender-21”, që ishte një mundësi e jashtëzakonshme e FA-së për t’u ballafaquar me forca të tjera të armatosura, me ushtri të tjera, për t’u integruar me ta, për të rritur ndërveprueshmërinë dhe për të fituar, mbi të gjitha besim se, edhe një vend i vogël si Shqipëria mund të luajë një rol të madh. E kemi zhvilluar me shumë sukses pjesëmarrjen tonë në “Defender Europe 2021”. Ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për ne dhe kemi faktuar që jemi një partner strategjik shumë i rëndësishëm për NATO-n. Njëkohësisht zhvillimi i stërvitjeve në rrafsh kombëtar ka gjetur dhe gjen mbështetje në planifikimin e bërë nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në të gjithë drejtimet e Mbrojtjes.

Rekrutimi gjithashtu është një nga aktivitetet, apo proceset, i cili do të ngrihet në një nivel tjetër, në mënyrë që ne të përthithim sa më

shumë djem dhe vajza nga rinia shqiptare në FA; ta sjellim aktivitetin tonë të rëndësishëm më pranë të rinjve shqiptarë, në mënyrë që të rritet edhe më shumë interesi i tyre për t’u bërë pjesë e FA-së.

Me mbështetjen e jashtëzakonshme të qeverisë shqiptare dhe kryeministrit të saj z. Edi Rama, ky përvjetor i gjeti Forcat tona të Armatosura me vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim dhe rritje të aftësive të tyre. Angazhimi dhe përkushtimi i tyre ushtarak, i bën ato të kenë plotësisht respektin e merituar, besimin e popullit dhe vëmendjen e autoriteteve të vendit dhe të aleatëve tanë në NATO. Devotshmëria e Forcave të Armatosura ndaj atdheut, nderit dhe detyrës i bën ato të jenë të suksesshme në përmbushjen e misionit të tyre të nderuar dhe fisnik. Një arritje e madhe është dhe buxheti i vitit 2023, i cili ka vlerën 40 miliardë e 256 milionë lekë, ku është parashikuar në buxhetin afat-mesëm që në 2024-ën të shkojmë në 2.1% në fakt, që është 0.1% mbi angazhimin që kemi në NATO dhe 21.2% të cilave do të jenë për investime në 2024-ën, sipas projeksionit të sotëm. Ndërsa në vitin 2025, do të arrijmë në 2.21%. Për shpenzimet në mbështetje të plotësisht të objektivave dhe kapaciteteve, mbështetet financiarisht plotësisht i kapaciteteve operacionale të deklaruara në NATO, nëpërmjet modernizimit të FA-ve rreth 13.8 miliardë lekë, ose 51% e shpenzimeve kapitale dhe 22.3% e totalit të shpenzimeve të vitit 2023. Pra një pjesë të madhe të buxhetit po e kalojmë drejt objektivave të kapaciteteve të deklaruara në NATO. Garantohen kapacitetet e reja për teknologjitë e informacionit dhe mbikëqyrja nëpërmjet blerjes së dronëve, të shërbimit satelitor dhe mbrojtjes kibernetike, që shkojnë në vlerën 1.4 miliardë lekë.

Për të nderuarit ushtarakë, ne kemi parashikuar një tjetër rritje për pagat në vitin 2023. Rreth 7 mijë, është numri që do të përfitojnë një rritje të re të pagës me buxhetin 2023. Nga korriku ju keni filluar të merrni një rritje 30% më shumë në pagë, në janar mbi këtë 30% shtohet edhe 7%.

Pra, është një rritje 40% e pagës. Nëse një ushtarak merre 50 mijë lekë në 2022, tani do të marrë 70 mijë lekë, kjo është për pagën më të ulët, dhe vijon për të gjithë deri në pagat më të larta. Ky është një vizion i qeverisë shqiptare. Kryeministri e ka thënë dhe po e mbajmë këtë fjalë që do të risim çdo vit pagat e Forcave të Armatosura, pavarësisht se jemi në kushtet e një buxheti rezistence, pra do të rriten çdo vit, deri sa të kalojmë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Të nderuar ushtarakë, civilë, pjesë e kësaj armate të madhe, familjarë, ju falënderoj për çdo ditë sakrifice, lodhjeje e përkushtimi. Dhe ju garantoj përkrahjen time si lideri politik i Ministrisë së Mbrojtjes, se do të jem me ju dhe për ju në çdo çast të misionit tonë të përbashkët.

*Gëzuar 110-vjetorin e krijimit të Ushtrisë Shqiptare, festofshim edhe gjindra të tjerë me nderin që na lanë të parët!*







SHEFI I SHTABIT TË  
PËRGJITHSHËM,  
GJENERAL BRIGADE  
**ARBEN KINGJI**

# Nderi, Detyra, Atdheu, trinomi që trupëzon vlerat e ushtarakëve

Ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura me mesazhe të rëndësishme për një vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim, shumëfishim dhe rritje cilësore të aftësive të tyre.



**D**hjetori i këtij viti shënon 110 - vjetorin e krijimit të Forcave tona të Armatosura, të cilat lindën me shtetin shqiptar dhe pavarësinë e Shqipërisë dhe i kanë shërbyer e i shërbejnë me besnikëri dhe vetëmohim shtetit shqiptar dhe Shqipërisë.

4 Dhjetori i vitit 1912 është një kushtim i historisë dhe të parëve tanë ndaj kujtesës kombëtare për vlerën dhe rëndësinë e Forcave të Armatosura. Kjo ditë është tribuna për të shprehur nderimin dhe mirënjohjen tonë ndaj themeluesve dhe arkitektëve të forcës ushtarake të vendit dhe të gjithë gjen-eratave që kanë shërbyer dhe shërbejnë në të. Ky është edhe rasti simbolik për t'i siguruar të gjithë që Forcat e Armatosura, në çdo kohë dhe situatë, mbeten shërbëtorë të dedikuar të interesave kombëtare dhe vlerave euroatlantike. Kjo ditë është momenti që të ndjehemi krenarë për rrugëtimin e lavdishëm dhe për statusin e nderuar e të vlerësuar që kemi fituar brenda shoqërisë tonë, por edhe midis aleatëve tanë në Aleancën Euro-Atlantike.

Bashkëshoqëruese dhe pjesë e pandarë e zhvillimeve të historisë së vendit, Forcat e Armatosura kanë ndryshuar, janë rritur, zhvilluar dhe maturuar, janë reformuar dhe transformuar bashkë me Shqipërinë, deri në një forcë ushtarake profesionale moderne e inkuadruar në aleancën e madhe Euro-Atlantike të NATO-s. Ato janë sot nderi dhe krenaria e vendit, në saje të angazhimeve dhe kontributeve të qenësishme e të rëndësishme në operacionet brenda vendit dhe në misionet ndërkombëtare. Ky është një motiv i mjaftueshëm për të shprehur mirënjohje dhe respekt të veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në vite dhe atyre që janë aktualisht të angazhuar në vijën e parë të frontit të Aleancës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë në Letoni, Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, Sudan dhe kudo.

Në këtë përvjetor, për të gjithë ne njerëzit me uniformë, është gjithashtu çasti solemn, t'i kushtojmë një përlulje dhe homazh të veçantë të gjithë heronjve tanë që me vetëmohim kanë bërë edhe sakrificën sublime në shërbim të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit. Respekt dhe mirënjohje edhe për gjithë familjet e ushtarakëve, që me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre të pakushtëzuar dhe të pakursyer, janë bërë pjesë e pandarë e kontributeve dhe komunitetit tonë ushtarak.

Me shërbimin dhe kontributin e tyre në çdo situatë nevojë dhe emergjencë të komunitetit e qytetarëve, në çdo skaj të vendit, Forcat e Armatosura janë bërë pjesë integrale, e dashur dhe e kërkuar e gjithë shoqërisë shqiptare. Ato kanë një mision të pandryshueshëm kushtetues, por roli dhe detyrat ku ato angazhohen janë në funksion të nevojave, ndryshimeve dhe zhvillimeve të situatave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë. Kjo ka qenë e evidente për çdo qytetar të vendit, të cilët i kanë parë Forcat e Armatosura të angazhuara në detyra tipike luftarake në pikat më të nxehta të globit, në misionet e Irakut

dhe Afganistanit, por edhe në shumë misione të tjera në tre kontinente, që janë mbyllur me sukses dhe faqebardhë. Realiteti i pamohueshëm është që të gjitha komunitetet e vendit kanë ndjerë dorën e forcave ushtarake në rolin e ndërtuesit të urave, të digave, të rrugëve, por i kanë pasur aty, ditën dhe natën, në rolin e shpëtimtarit të jetës në përmbytje, në bllokime dimërore e sëmundje, në tërmete, në zjarre dhe në shumë e shumë situata të tjera, deri tek pandemia e pazakontë e COVID-19. Forcat tona të Armatosura, pa zhurmë dhe pa zë, kanë qenë dhe do të jenë aty ku ka pasur nevojë vendi, aty ku na ka kërkuar populli, aty ku na ka thirrur detyra. Këto angazhime, do të vazhdojnë të ngelen prioriteti dhe detyrimi më i rëndësishëm i Forcave tona të Armatosura.

Ky përvjetor i gjen Forcat tona të Armatosura me mesazhe të rëndësishme për një vëmendje të shtuar përkujdesjeje, për një mbështetje dhe motivim të merituar dhe rritje të dinjitetit të të gjithë personelit që shërben dhe ka shërbyer në Forcat e Armatosura, por edhe për një modernizim, zhvillim, shumëfishim dhe rritje cilësore të aftësive të tyre. Forcat e Armatosura e kanë nevojë të përhershme përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre operacionale.

Situatat e kohëve që po jetojmë na kanë vënë para detyrimeve të reja, sfidave të parashikuara, por edhe të paparashikuara. Forcat e Armatosura që po përgatisim dhe zhvillojmë, garantojnë të jenë të gatshme dhe të afta t'i përgjigjen çdo nevojë të vendit në çdo situatë krizash dhe emergjencash, të vetme apo me institucionet e tjera kombëtare dhe të përmblin me dinjitet e nder detyrimet euroatlantike të Shqipërisë në kuadër të Aleancës dhe më gjerë. Këtë e garanton përkushtimi dhe profesionalizmi i grave dhe burrave në uniformë, mbështetja e plotë dhe e sigurt e gjithë autoriteteve shtetërore dhe aleatëve tanë, të cilët, në këtë ditë tonën të shënuar, gjej rastin t'i falënderoj për mbështetjen dhe vëmendjen që i japin Forcave të Armatosura.

Kam bindjen time të palëkundur se me angazhimet dhe përkushtimin tonë, kurdoherë do ta meritojmë plotësisht dhe denjësisht respektin dhe besimin e popullit, të autoriteteve të vendit dhe të aleatëve tanë në NATO. Është rasti i këtij përvjetori, t'i sigurojmë të gjithë, se devocioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë gjithmonë atdheu, nderi dhe detyra.

Me besimin e plotë që Forcat e Armatosura do t'i gjenden vendit me përgjegjësi, devotshmëri dhe sakrificë, në këtë përvjetor të 110-të, i shpreh çdo efektivi ushtarak dhe civil të Forcave të Armatosura, gjithë mirënjohjen dhe vlerësimet e mia më të larta për kontributin e tyre dinjitoz dhe fisnik në shërbim të interesave kombëtare dhe Shqipërisë.

Gëzuar 110-vjetorin e Forcave të Armatosura!  
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm,  
gjeneral brigade Arben KINGJI





ZËVENDËSSHEF I SHITABIT  
TË PËRGJITHSHËM TË FA-së,  
GJENERALMAJOR  
MANUSHAQE SHEHU

“Në të ardhmen  
nuk do të ketë  
**liderë gra,**  
*apo burra, do të ketë*  
**thjesht liderë”**

Ky 110-vjetor i gjen Forcat e Armatosura me një bilanc suksesesh të rëndësishme në realizimin e misionit të tyre kushtetues për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit.



**M**ë 4 dhjetor 1912, vetëm 6 ditë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, u krijua Ushtria Kombëtare. Për herë të parë në historinë shekullore të vendit u krijua Ministria e Mbrojtjes Kombëtare, (Ministria e Luftës), e drejtuar nga Mehmet Dëralla (Tetova) dhe Shtabi i Përgjithshëm i drejtuar nga major Ali Shefqet Shkupi.

Forcat e Armatosura Shqiptare u themeluan në flakët e kryengritjeve të mëdha, ku vendosej fati i kombit tonë, si garanti kryesor për ruajtjen e tërësisë territoriale të trojeve shqiptare. Nga kjo periudhë e deri më sot, plot 110 vjet, Forcat e Armatosura shqiptare, u zhvilluan, u konsoliduan e u modernizuan në përputhje me kushtet e brendshme të vendit, situatën gjeopolitike në rajon e atë globale dhe me etapat e zhvillimit të vendit, sidomos pas çlirimit të vendit me ekzistencën e luftës së ftohtë dhe sot në kohën e demokracisë si vend anëtar i denjë i NATO-s, duke mbartur kurdoherë në vetvete vlerat më të mira të traditës kombëtare të popullit tonë.

Ky 110-vjetor i gjen Forcat e Armatosura me një bilanc suksesesh të rëndësishme në realizimin e misionit të tyre kushtetues për mbrojtjen e integritetit territorial të vendit, dhënien e ndihmës ndaj popullsisë në rastet e emergjencave civile dhe marrjen pjesë në operacionet ndërkom-bëtare, duke eksportuar paqe e siguri.

Sukseset e Forcave të Armatosura pa dyshim janë rrjedhojë e politikave të zhvillimit, përcaktuar nga qeveritë në kohë të ndryshme të ekzistencës së shtetit shqiptar. Secila periudhë e zhvillimit të vendit, dhe në këtë aspekt edhe i transformimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura, ka rëndësinë e vet. Ato u kanë qëndruar dhe u qëndrojnë besnike interesave të popullit shqiptar.

Sot Forcat e Armatosura i gjen të ristrukturuara e transformuara në strukturë, të modernizuara në armatim, teknikë e pajisje, por edhe me mentalitete e koncepte të reja bashkëkohore, të njëjta me vendet e NATO-s, si anëtare e saj me të drejta të plota në aleancën më të fuqishme Euro-Atlantike. Forcat e Armatosura janë më të pakta në numër, por më të konsoliduara, më të motivuara dhe më të afta profesionalisht. Ato i gjen duke u stërvitur në çdo skaj të vendit, pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta brenda e jashtë vendit, në kuadrin e NATO-s, siç ishte "Defender 2021", zhvilluar në vendin tonë para dy vitesh, e cila pritet të zhvillohet edhe në vitin 2023. Ato i gjen duke u stërvitur në det, në ajër e kudo. Ato i gjen në misione paqeruajtëse kudo në zonat me konflikt, ku të drejtat e njeriut nëpërkëmben dhe ku jeta e njeriut dhe e popujve vihet në rrezik. Prej vitesh Forcat e Armatosura shqiptare janë

pjesë përbërëse e misioneve paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO, BE e OKB-ja.

Rezultatet e Forcave të Armatosura në këto vite janë fryt i përkushtimit, profesionalizmit dhe devotshmërisë së dhënë nga breza të tërë oficerësh, nënoficerësh dhe ushtarësh aktiv e rezervistë në gjithë vendin. Në ditët e sotme, Forcat e Armatosura shqiptare janë një garanci, që dëshmon jo vetëm ekzistencën, por edhe rolin e tyre si kontribuuese në rajon e më gjerë në mbështetje të paqes dhe të sigurisë.



Ne sot kemi të drejtën të ndihemi krenarë për këto arritje cilësore të Forcave të Armatosura. Ne ndihemi krenarë për vlerësimet që bashkëpunëtorët tanë në botë, japin për ushtarakët shqiptarë, të cilët me përkushtim, mund e djersë kryejnë detyrat sipas zinxhirit të komandim - kontrollit. Ne ndihemi krenarë sot për besueshmërinë e lartë, respektin e konsoliduar dhe prestigjin që figura e ushtarakut shqiptar gëzon me meritë tek qytetarët e këtij vendi.

Historia e Shqipërisë, është histori lufte për mbijetesë, e përpjekjeve për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, e sakrificave të mëdha për liri e pavarësi.

Pjesë e këtyre përpjekjeve për liri e demokraci kanë qenë edhe gratë shqiptare. Ka kaluar mbi gjysmë shekulli që në Forcat e Armatosura, krahas ushtarakëve meshkuj, janë edhe femrat ushtarake, duke nisur nga viti 1967, ku 70 gjimnazistet e para filluan shkollën ushtarake, duke sfiduar çdo mentalitet të kohës. Ato ishin përfaqësuese të një brezi që ecën në gj



mët e vajzave e grave trimëshra partizane, por edhe më parë që kishin rrëmbyer armët për mbrojtjen e vendit dhe çlirimin e tij. Numri i oficereve, nënofficereve dhe ushtarëve profesioniste në Forcat e Armatosura është rritur së tepërmi, sot rreth 14.76% e gjithë personelit janë femra.

Shqipëria dhe Forcat e Armatosura krenohen me përparimet që ka bërë gruaja ushtarake, ajo sot është më e sigurt, më e përparuar, më pranë familjes së madhe europiane, e barabartë me gruan ushtarake të aleancës në NATO-s. Kjo është pjesë e meritës së tyre. Kjo na detyron që të jemi mirënjohës duke i vlerësuar për punën e tyre, duke ndjerë krenari për sakrificat e bëra në rrugëtimin e tyre nën uniformën ushtarake.

Si femër në uniformën e gjelbër, qysh prej rinisë time të hershme, duke kryer detyra të rëndësishme, duke filluar nga niveli më i ulët taktik, operativ e deri në detyrën e lartë prej disa vitesh të zëvendësimit të Shtabit të Përgjithshëm të nivelit strategjik, dëshiroj që në këtë përvjetor të lavdishëm të Forcave të Armatosura t'u drejtohem në mënyrë të veçantë gjithë femrave ushtarake, oficere, nënofficere dhe ushtarë profesioniste se me punë, guxim, përkushtim, sakrificë, por edhe ambicie pozitive, si gra dhe vajza të mençura e plot vizion, të luftoni për të qenë të suksesshme në karrierën ushtarake për të arritur objektivat tuaja deri në gradë madhore, pse jo edhe Gjenerallejtënant.

Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t'ju drejtohem juve, jo vetëm si zëvendësimit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj: Gëzuar 110-vjetorin e FA-së, shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore!" Në mënyrë të veçantë dëshiroj të përshëndes femrat ushtarake që ky përvjetor i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake jashtë vendit.

Ky përvjetor një pjesë të femrave i gjen në fushat e poligonit e stërvitjes, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore (ku tani kemi edhe piloten e parë femër), i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojës, në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura, në Shtabin e Përgjithshëm dhe në Shtabet e Komandave të Forcave, e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave. Ato i gjen, jo vetëm nëntoger, toger, kapitene e major, por edhe me grada të larta si nënkolonel e kolonel e deri gjeneral-major, ku sot është grada më e lartë në Forcat e Armatosura, e cila mbahet në supet e brishta të një femre, por me forcën dhe vitalitetin, për të përballuar çdo lloj sfide që detyra i ngarkon. Ato i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, atashe ushtarake etj.

Në këtë përvjetor gjej rastin të falënderoj titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për kujdesin e mbështetjen e treguar në vite ndaj femrave ushtarake, si në rekrutimin, promovimin dhe ecurinë e tyre në detyrë e karrierë.

Puna që bëhet për zbatimin e Planit të Veprimit Kombëtar



e Planit të Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes për zbatimin e Rezolutës 1325 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për Gruan, Paqen e Sigurinë", ka bërë të mundur që gratë ushtarake të zënë sot rreth 14.76% të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak aktiv me objektiv e synim për të arritur 15% të efektivave të jenë gra. Gjithashtu miratimi para dy vitesh nga Ministri i Mbrojtjes të dokumentit "Politikat kundër ngacmimeve dhe ngacmimit seksual në ambientet e punës", u ka dhënë femrave më shumë siguri, përkujdesje e mbrojtje nga strukturat shtetërore.

Ambiciet tona si individë, në pozicionin e punës, por edhe në grup si gra duhet të jenë të arrijmë gjithçka që është e mundur, gjithmonë të tregojmë me aftësi e me punë se jemi në gjendje të bëjmë punë të dobishme ndaj shoqërisë dhe atdheut, aq sa



## Sot, Forcat e Armatosura i gjen të ristrukturuara e transformuara në strukturë, të modernizuara në armatim, teknikë e pajisje, por edhe me mentalitete e koncepte të reja bashkëkohore, të njëjta me vendet e NATO-s, si anëtare e saj me të drejta të plota në aleancën më të fuqishme Euro-Atlantike.



edhe kolegët tanë meshkuj në uniformë. Prandaj luftoni e kontribuoni më shumë për veten tuaj! Mos pushoni së studiuar për të arritur me punë e mundim çdo ambicie profesionale e të karrierës, edhe atë që konsiderohet e paarritshme! Luftoni dhe kërkoni të gjejnë zbatim të gjitha ligjet në fuqi që u japin të drejta grave ashtu si edhe burrave! Luftoni e kërkoni që promovimi në detyrë e gradë të mos konsiderohet si “lëmoshë e mëshirë” ndaj jush, por si një e drejtë që ju takon dhe e meritoni! Luftoni dhe kërkoni që edhe në familje të mos bini pre e dhunës dhe e diskriminimit, siç ndodh në ndonjë rast edhe ndaj femrave ushtarake! Kurrë mos pranoni dështimin në karrierën tuaj! Edhe nëse ndodh përpikuni për të bërë të pamundurën. Dështimi juaj duhet të jetë sfidë për të tjerat!

Angazhimet dhe përgjegjësitë e Forcave të Armatosura brenda e jashtë vendit, në kryerjen e detyrave për rritjen e aftësisë mbrojtëse të vendit, në përbalimin e emergjencave civile dhe vijimin e kontributeve në misionet paqeruajtëse në kuadrin e NATO-s, BE-së e OKB-së, edhe në të ardhmen do të jenë gjithmonë në rritje. Nga më të rëndësishmet për vitin 2023 do të veçonim stërvitjen e përbashkët në kuadrin e NATO-s “Defender - 23”, që zhvillohet në vendin tonë. Të gjitha këto

kërkojnë përkushtim e profesionalizëm nga të gjithë pjesëtarët e Forcave të Armatosura, burra e gra në uniformë.

Në këtë përvjetor të lavdishëm të Forcave të Armatosura, si zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe si një ushtarake me eksperiencë e gradë madhore, atë të gjeneralmajorit, u drejtohem me respekt dhe përlësi gjithë ushtarakëve aktiv, oficer, nënoficer e ushtarë profesionistë, por edhe civilëve që punojnë përkrah ushtarakëve, duke i falënderuar për punën, sakrificat, përkushtimin e treguar ndaj kryerjes së detyrave në interes të Forcave të Armatosura. Gjithashtu një urim të veçantë edhe ndaj gjithë ushtarakëve në lirim e në rezervë, sakrificat e të cilëve janë pjesë e krenarisë sonë e në veçanti ato që aktualisht janë në misione paqeruajtëse jashtë vendit.

Gëzuar 110-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura, vlerësim e mirënjohje për kontributin e dhënë në vite si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i kini shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj, duke përmbushur më së miri trinomin “Detyra, Nderi, Atdheu”! Qofshi përjetë të lumtura!

Gëzuar 110-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura!





KOMANDANT I AFA-së,  
GJENERAL BRIGADE  
**BILBIL BITRI**

# AFA, arsimim, strategji, doktrinë, inovacion, punë kërkimore ushtarake...

**MISIONI I NJË INSTITUCIONI ARSIMOR, PËRFSHIRË EDHE  
INSTITUCIONET ARSIMORE USHTARAKE ËSHTË NË THELB  
I NJËJTË - TË PËRGATISIN STUDENTËT E TYRE PËR TË  
NDRYSHUAR TË SOTMEN E PROJEKTUAR TË ARDHMEN.**



Intervistoi:  
Shefe e Sektorit të Botimeve,  
**ANJEZA MUSOLLARI**

---

**A**rsimimi ushtarak shqiptar ka kaluar një rrugë plot sakrificë dhe arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor është një proces në zhvillim e sipër. Arsimimi është mjeti i suksesit tonë të ardhshëm, mirë arsimimi i brezave rrit kohezionin shoqëror, garanton ruajtjen dhe përcimin e vlerave kombëtare, si dhe rrit ndërvëprimin rreth vetes dhe botës. Ai i aftëson ushtarakët për të përbushur qëllimet më të rëndësishme për vendin. Një sistem arsimor cilësor zhvillon ndjenjat e qytetarisë dhe kontribuon në konsolidimin e institucioneve. Në një intervistë për revistën “Mbrojtja” komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri do të sjellë një faqe të rrugëtimit të këtij institucioni të FA-së, si dhe këndvështrimin e tij mbi të ardhmen akademike të ushtrisë shqiptare...

#### **Kur është krijuar Akademia e Forcave të Armatosura?**

Më lejoni në krye të herës t’ju falënderoj për mundësinë e komunikimit me lexuesit e revistës “Mbrojtja”, në këtë 110-vjetor të krijimit të Forcave të Armatosura.

Për t’u kthyer tek pyetja. Lufta dhe përpjekjet e shqiptarëve për ndërtimin e shtetit dhe të institucioneve të dijes ka qenë e gjatë dhe e mundimshme. Shpallja e pavarësisë dhe krijimi i institucioneve të shtetit të ri shqiptar kishte brenda tij dhe përpjekjet e fragmentuara për krijimin edhe të institucioneve të arsimit ushtarak. Në vitin 1928 u mundësua hapja e shkollës së parë ushtarake për përgatitjen e oficerëve, por e pati jetën të shkurtër pasi do të mbyllej në vitin 1933 për mungesë fondesh. Edhe ideja e hedhur në vitin 1936, për të ngritur një Akademi Ushtarake, mbeti vetëm e tillë për arsye që lidhen me problematikat e shtetit dhe ushtrisë shqiptare të asaj periudhe. Studentët dhe oficerët më të zgjedhur shqiptarë vijuan të arsimoheshin dhe kualifikoheshin nëpër akademitë ushtarake të Italisë, të Austrisë, Greqisë e madje edhe të Francës.

Mungesa e një akademie kombëtare përveç vështirësisë për të akomoduar shkollat e ndryshme nuk garantonte formimin patriotik të studentëve, përfundimin e identitetit të tyre kombëtar dhe dashurinë për atdheun.

Këtu nuk dua të spekuloj, pasi pjesa dërmuese dashurinë për atdheun e kishin marrë në familje dhe e manifestonin përgjatë gjithë vepërimitarisë, por kjo është një nga kërkesat që e bën të domosdoshëm arsimimin ushtarak kombëtar edhe pse akademitë e tjera mund t’u ofronin arsim dhe formimin më të mirë për kohën atyre.

Arsimimi ushtarak, në formën e kurseve afatshkurtër, ka filluar që në vitin 1944, por institucioni i Akademisë Ushtarake me misionin dhe detyrat që ka një institucion i tillë u krijua më 10 maj 1958, në Tiranë, jo shumë larg prej vendit ku është e vendosur sot Akademia e Forcave të Armatosura. Ndër vite akademia ka mbajtur emërtime të ngjashme por pa ndryshuar në thelb misionin dhe funksionin e saj.

Për shkak të misionit dhe funksionit unik të saj dhe nivelit të lartë akademik, Akademia ka shërbyer si qendër e zhvillimit të mendimit ushtarak me të drejtën edhe të dhënies së titujve shkencor. Janë mbrojtur mbi 130 doktoratura dhe sot është i vetmi institucioni që gëzon të drejtën me ligj për të ofruar programe studimi të nivelit II dhe III në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

#### **Cili ka qenë misioni, detyrat dhe struktura organizative e saj?**

Misioni i një institucioni arsimor, përfshirë edhe institucionet arsimore ushtarake është në thelb i njëjtë - të përgatisin studentët e tyre për të ndryshuar të sotmen e projektuar të ardhmen.

Misioni i Akademisë ka qenë dhe është gjithmonë në funksion të misionit të Forcave të Armatosura: Arsimimi dhe përgatitja si lider e oficerit të ri, kualifikimi ushtarakëve dhe civilëve në të gjitha nivelet e drejtimit dhe më tej, zhvillimi i koncepteve dhe doktrinës ushtarake në interes të Forcave të Armatosura të RSH-së.

Do të ishte e vështirë të ofrohej një listë “shteruese” e detyrave që burojnë nga misioni që ka Akademia, por do të thosha se lista e gjatë e detyrave dhe e njerëzve që angazhohen për t’i realizuar është e gjitha për: krijimin e ushtarakut me karakter e integritet që i shërben vendit dhe shoqërisë; realizimin me cilësi të procesit akademik, krijimit dhe përmirësimit të infrastrukturës akademike, krijimin, mbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për jetesë dhe stërvitje, krijimin e infrastrukturës sportive e sociale.

Për sa lidhet me strukturën organizative, duhet thënë se ajo ka reflektuar gjithmonë rrethanat e kohës dhe objektivat që Akademia ka pasur si pesë e së tërës - Forcave të Armatosura. Objektivat janë cilësorë dhe sasiorë. Objektivat cilësorë kanë “diktuar” natyrën e strukturës, ndërsa objektivat sasiorë kanë diktuar madhësinë e strukturës. Duhet theksuar se arsimimi ushtarak (institucionet e tij) ka qenë gjithmonë në varësinë e drejtpërdrejtë të ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të përgjithshëm. Kjo tregon edhe rëndësinë e tyre.

#### **Cili ka qenë roli dhe kontributi i Akademisë së Forcave të Armatosura për përgatitjen e oficerëve në vite?**

Duke u nisur nga misioni i saj, mund të thuhet se treguesit janë të dukshëm e cilësorë. Fakti që, deri më sot, janë me mijëra ushtarakë e civilë që janë arsimuar e kualifikuar, tregon për punën e madhe që kanë bërë pedagogët dhe të gjithë drejtuesit në këtë institucion. Duke qenë se Akademia e Forcave të Armatosura qysh nga



vitet '70-të ka marrë të drejtën e dhënies së gradave shkencore, duhet të themi se deri më sot janë dhjetëra e dhjetëra ushtarakë e civilë që kanë marrë grada shkencore “Doktor i Shkencave”, si dhe tituj akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor Doktor”. Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni më i lartë arsimor ushtarak dhe shkencor për Forcat e Armatosura, ku bëhet kualifikimi i të gjithë personelit ushtarak, por edhe kualifikimi i personelit civil për fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në Akademinë e Forcave të Armatosura janë kualifikuar edhe oficerët e nivelit operativ e strategjik, që kanë filluar studimet me Kursin e Shtatmadhorisë më 1976, të pasuar nga Kolegji i Mbrojtjes e më vonë Kolegji Rajonal me emërtimin Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes, që u hap në shtator të vitit 2007; ndërkohë që është edhe një simbolikë domethënëse, në kuadrin e integritimit real në NATO, kurs që ka vijuar të zhvillohet me sukses të plotë në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Akademisë së Forcave të Armatosura. Siç dihet, aty përveç ushtarakëve shqiptarë e drejtuesve të lartë civilë, ka pasur edhe pjesëmarrës nga vende mike e partnere.

### **Çfarë ofron sot Akademia e Forcave të Armatosura?**

Akademia e Forcave të Armatosura është sot institucioni i vetëm i Arsimit të Lartë që gëzon të drejtën e ofrimit të programeve të studimit në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në të tre nivelet. Ajo është në një proces transformimi në një model të ngjashëm me Akademinë Ushtarake të SHBA-së, “West Point”.

Tre janë programet e nivelit të parë që zhvillohen aktualisht në Akademi: programi i Shkencave Ushtarake dhe dy programe të përbashkëta, programi i Navigimit Detar; dhe programi IT (Information and Technology). Paralelisht me to zhvillohet edhe Kursi i Përgatitjes së oficerit të ri. Ky program është rreth 1-vjecar dhe është dizajnuar për studentë që kanë një diplomë Bachelor.

Duhet përmendur që prej vitit të kaluar dhe këtë vit akademik, Akademia ofron dhe programin e nivelit të dytë, Master Profesional në Mbrojtjen Kibernetike.

### **Ku qëndron lidhja e arsimit ushtarak me strategjinë, doktrinën ushtarake dhe punën kërkimore?**

Nuk dua të komentoj pyetjen, por unë mendoj se e kundërta e pyetjes do ishte vështirë të provohej. Arsimi, strategjia, doktrina dhe puna kërkimore ushtarake mendoj janë pjesë e së tërës dhe nuk do të mund të “jetonin” pa njëra tjetrën. Ato e ushqejnë njëra-tjetrën po aq sa ndihmojnë në përmirësimin dhe ndryshimin reciprok të tyre. Konceptet, strategjitë dhe doktrinën u paraprijnë transformimeve të FARSH-së dhe janë bazë për përgatitjen dhe stërvitjen e tyre, por janë të tilla dhe për arsimimin ushtarak. Njëherazi ato bëhen objekt i studimit e kërkimit shkencor për t’u rishikuar e përshtatur në përputhje me realitetet që krijohen. Transformimi, i nisur nga Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) për t’u kthyer në një institucion që i përgjigjet sfidave të kohës, provon pikërisht sa të ndërlidhur midis tyre janë arsimimi ushtarak, strategjia, doktrina dhe kërkimi shkencor.

Strategjia dhe doktrina ushtarake përbën themelin e referencave mbi të cilat bazohet procesi arsimor.

Studentët e sotëm janë liderët e të nesërme dhe arsimimi ka përgjegjësinë e përgatitjes nëpërmjet mësimi praktik dhe eksperimental të drejtuesve të të gjitha niveleve, të aftë që të drejtojnë trupat në fushën e betejës për të përmbushur strategjitë dhe taktikat si dhe metodat më të mira e praktikat e provuara e bashkëkohore të operimit. Kjo është esenciale për të rritur besimin e trupave dhe efektivitetin e përdorimit të kapaciteteve.

Nga ana tjetër arsimimi ushtarak i tejkalon strategjitë dhe i përgatit

për të ditur jo se “ÇFARË” të mendojnë, por se “SI” të mendojnë dhe si të tejkalojnë vetveten, duke mësuar nga gabimet e veta dhe të të tjerëve. Për të qenë të suksesshëm, studentët mësohen për të gjykuar në mënyrë kritike veçanërisht mbi taktikat dhe doktrinën aktuale dhe të orientuar nga misioni si të veprojnë me iniciativë, duke gjetur rrugën më efikase për përmbushjen e misionit.

### **Si gjendet arsimimi ushtarak përballë sfidave të kohës?**

Çdo kohë ka sfidat e saj dhe kjo e jona nuk mund të bëjë përjashtim. Jo vetëm nuk bën përjashtim, por duhet thënë se agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës e ka bërë të ndryshme nga të gjitha “kohët”, që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë. Akademia, përvесе nga sfidat e kohës, është e “sfiduar” dhe nga vetvetja. Siç dhe e përmenda më sipër, prej vitit të kaluar Akademia ka hyrë në një proces transformimi dhe kjo padyshim që është sfidë. Ky transformim do sigurojë dhe “konsolidimin e arsimimit ushtarak” që është dhe një nga prioritetet e shpalosura nga SHSHP në vizionin e tij.

Nga ana tjetër, unë mendoj se Akademia dhe çdo institucion tjetër arsimor, ushtarak ose jo është në sfidë të vazhdueshme me kohën, konsideruar ritmin me të cilin po ecën shkencën dhe teknologjia. “Dua ta bëjmë avangardë të mendimit shkencor”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes në ceremoninë e hapjes së vitit akademik. Ofrimi i programeve cilësore të edukimit nga njëra



anë dhe formimi i liderit ushtarak i aftë të mendojë, veprojë e më kryesorja të drejtojë/udhëheqë, në një mjedis të karakterizuar nga kompleksiteti dhe paparashikueshmëria, patjetër që është sfidë.

Kapërcimi i sfidave bëhet më i lehtë përmes bashkëpunimit dhe Akademia një proces të tillë e zhvillon në dy dimensione. Në atë ndërkombëtar, përmes Consorciut të Akademive Ushtarake të vendeve të NATO-s, por jo vetëm, dhe me institucionet e larta arsimore brenda vendit. Marrëveshjet e bashkëpunimit me një numër universitetesh (Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik, Universiteti i Durrësit, Universiteti Luarasi, Barleti, Qendrën Marshall, etj.). Dua të veçoj Universitetin e Durrësit, pasi na ka mundur ofrimin e programeve të veçanta si Navigimi Detar dhe IT.

Kryefjala e bashkëpunimit mbetet Akademia Ushtarake e SHBA-së “West Point” dhe këtu gjej rastin të shpreh mirënjohjen time dhe besoj të të gjithë akademisë për mbështetjen

që aleati strategjik i vendit tonë, Shtetet e Bashkuara po ofrojnë. Ajo që pritet të ndodhë, në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, është se edhe studentët tanë do të kenë ambiente dhe sistem arsimor si bashkëmoshatarët e tyre në "West Point", kjo falë përkrahjes së kryeministrit Rama dhe vendosmërisë së ministrit të Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ju si media keni ndjekur vizitën e suksesshme të kryeministrit dhe lidershit të MM-së dhe FARSH-së në Akademinë "West Point" vitin e kaluar, që ishte një gur themeli për ngritjen e konceptit dhe vijimin e punës për transformimin e AFA-së sipas këtij modeli. Mbështetja amerikane në këtë drejtim ka qenë e gjithanshme, ne kemi pasur disa ekipe amerikane që së bashku me ushtarakët dhe stafin tonë akademik janë duke punuar për hartimin e programeve, kurrikulave dhe trajnimit pedagogjik të stafit mësimdhënës. Ne synojmë të ofrojmë dhe tërheqim një brez kualitativ të rinjsh, të cilët do të arsimohen dhe do të mund të fitojnë një diplomë të transferueshme në tregun e punës si brenda dhe jashtë vendit.

**Pse të rinjtë shqiptarë duhet të zgjedhin këtë akademi për studime? Çfarë benefitesh iu ofrohen, ndryshe nga fakultetet civile?**

Padyshim që janë një numër faktorësh që e bëjnë AFA-në të ndryshme nga universitetet e tjera në vend. Kjo jo vetëm për programet dhe mbështetjen që u jepet atyre, por edhe për



mundësinë për t'i shërbyer atdheut në një nga profesionet më fisnike.

Së pari, programet të cilat ofrojnë një kombinim midis lëndëve ushtarake dhe atyre civile, për të pasur një "diplomë të dytë" në duart e tyre, kur të mbarojnë akademinë. Gjatë periudhës studentore ata do të sfidohen në forma pak më të ndryshme se bashkëmoshatarët e tyre në universitetet e tjera, duke synuar ndërtimin e karakterit, lidershit dhe të aftësive fizike, ndërsa nga ana akademike programet që kemi në bashkëpunim me Universitetin e Durrësit, por edhe shkëmbimet e eksperiencave me vendet e NATO-s, i përgatisin ata që të përfitojnë ekspertizë të vlefshme si brenda dhe jashtë FARSH-it. Në përfundim të studimeve, këtyre studentëve u ofrohen vende pune të sigurta dhe afatgjatë dhe një karrierë në FA e bazuar në meritokraci dhe performancë.

Se dyti, mbështetja si nga ana e kushteve të jetesës, të cilat

janë të gjitha falas me kosto zero për studentët, por edhe trajtim financiar i njëjtë me shpërblimin që merr një i ri, i cili sapo i është bashkuar Forcave të Armatosura.

Së fundmi, profesioni i ushtarakut është një prej profesioneve fisnike që rrit atdhedashurinë dhe një mundësi e mirë për t'i shërbyer vendit. Ushtarakët tanë kanë ngritur flamurin kombëtar lart si në fushëbetejat më të famshme në tre dekadat e fundit, për të garantuar liritë që ne i gëzojmë, deri tek garat sportive, ku një numër i sportistëve elitarë janë pjesë e AFA-së. Ndaj, liria që ne gëzojmë nuk mund të merret e garantuar, por kërkon kontributin e çdo qytetari, siç është edhe shërbimi në FA.

**A janë ushtarakët shqiptarë njësoj me homologët e tyre të vendeve të NATO-s?**

Mendoj se kjo pyetje e ka marrë tashmë përgjigjen. Përmes pjesëmarrjes në misione, operacione, aktivitete të Aleancës dhe strukturat e saj të përhershme, qysh edhe para anëtarësimit në Aleancë, ushtarakët shqiptarë kanë provuar se janë njësoj të aftë të mendojnë e veprojnë në përmbushje të misionit dhe detyrave, respektivisht ku ato kanë shërbyer e shërbejnë.

Nga ana tjetër arsimimi ka qenë plotësuar me kualifikimet, specializimet dhe trajnimet e bëra në shumë shkolla të vendeve të perëndimit si SHBA, Itali, Gjermani, Turqi, Greqi, Britani e Madhe dhe ndërveprimi ka qenë përgjithësisht i arritur përpara se të angazhoheshin në shtabet e NATO-s apo shtabet e tjera ndërkombëtare, përfshi në operacione, misione, stërvitje e trajnime apo aktivitete të tjera në kuadër ndërkombëtar.

**Një fjalë të fundit?**

Misioni i AFA-së në arsimimin, edukimin, kualifikimin dhe trajnimin e oficerëve në vendin tonë vijon të jetë i veçantë dhe i pazëvendësueshëm, por sfidat e kohës kërkojnë përgatitje e angazhim serioz. Akademia vijon arsimimin dhe përgatitjen e oficerëve të ardhshëm dhe mjedisi i sotëm i sigurisë zhvillohet në mënyrë dinamike, me konflikte komplekse. Faktori njerëzor, teknologjia, kompleksiteti rajonal e global kërkojnë drejtues të aftë, programues, metodistë, bashkëpunues, ndërveprues dhe këtë mund ta përmbushë vetëm një elitë pedagogjike e aftë dhe e standardizuar sikurse homologët tanë euroatlantikë. Në kushtet e modernitetit dhe të informacionit masiv, për sigurinë dhe mbrojtjen është shumë i rëndësishëm identifikimi i fushave kryesore të arsimimit, trajnimit dhe edukimit, zhvillimi progresiv i programeve dhe kurrikulave mësimore.

Programet synojnë të nxjerrin më në pah disa role dhe karakteristika lidhur me oficerin profesionist, të cilat e veçojnë profesionin e oficerit nga profesionet e tjera të shoqërisë shqiptare. Oficeri është një profesion i veçantë në fushën operacionale. Nga ana tjetër ai kërkohet që të jetë edhe diplomat, menaxher, lider, sepse ai është e duhet të jetë intelektual që lidh natyrshëm shoqërinë dhe shtetin ligjor me misionet e forcave të armatosura, me bashkëpunimin me aleatët në mjedise ndërkombëtare dhe ndërkulturore. Është kjo arsyeja që FSM në AFA harton dhe pasqyron programe profesionalë të oficerit, këtij qytetari me uniformë, që di të reflektojë profesionalisht dhe me etikë komunikimi në rrethana nga më komplekset e të vështirat. Nivelet e arsimimit të lartë ushtarak kanë nevojë për programe të rishikueshme, për të ecur "me hapin e kohës".

*Faleminderit dhe njëherë për mundësinë që më dhatë!*



KOMANDANT I FORCËS DETARE,  
KUNDËRADMIRAL  
ADNAND AGASTRA

# Forca Detare, syri vigjilent i deteve shqiptare

FORCA DETARE DREJTOHET NGA KUNDËRADMIRAL  
ADNAND AGASTRA DHE NË PËRBËRJE NUMËRON RRETH  
20 ANIJE, TË CILAT KRYEJNË DETYRA TË NDRYSHME  
NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË SAJ, DHE SË SHPEJTI  
FORCA DETARE DO TË KOMPLETOHET ME NJË ANIJE  
TË MADHE PATRULLUESE LUFTARAKE DHE 6 ANIJE TË  
VOGLA PATRULLUESE LUFTARAKE.





**M**e shpalljen e pavarësisë, më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e Forcës Detare shqiptare nga qeveria e Ismail Qemalit, por fillimi i Luftës së Parë Botërore e ndërpreu këtë angazhim.

Në vitin 1925, organizimi i ushtrisë synoi të bëhej mbi bazën e statusit të Shqipërisë hartuar më 07.03.1925. Mbi bazën e këtij statusi u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Ushtarake.

Më 25 dhjetor 1925, mbërrinjë nga Italia dy anije 190 tonësh, të cilat u emërtuan me emrat domethënës "Shqipëria" dhe "Skënderbeg". Këto anije u pajisën me efektiva marinarësh, duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare.

Më 1928, u krijua Komanda e Marinës dhe më konkretisht më 24.06.1928, kur u mblodhën rekrutët e parë për këtë armë.

Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan "Saranda" dhe "Durrësi". Gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore pothuajse u shkatërrua gjithçka nga këto anije.

Çlirimi i Shqipërisë e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme me pothuajse të gjitha anijet e mbytura në portet e bregdetit shqiptar.

Në prill 1945, u krijua Kantieri Detar - Durrës, për riparimin e varkave ekzistuese, nxjerrjen e anijeve të mbytura gjatë luftës dhe përgatitjen e tyre për qëllime ushtarake.

Më 15 gusht 1945, u bë përirimi i hedhjes në ujë të dy motoskafëve trofe, me numër MS-10 dhe MS-12. Këto motoskafë u armatosën me mitraloza të lehtë dhe filluan patrullimin për ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë e Sarandë. Më 14 shkurt 1954, u krijua Skuadrilja e Katrave Silurues me vend-bazim në ishullin e Sazanit, kjo shënon edhe fillimin e një stadi të ri të zhvillimit të Forcës Detare. Në këtë kohë Forca Detare drejtohej nga komandanti i parë i Forcës Detare, kundëradmiral Abdi Mati, i cili pati ndikim shumë të madh dhe të rëndësishëm në zhvillimin e Forcës Detare.

Në gusht të vitit 1961, u hap Shkolla e Marinës në Vlorë, sot Shkolla e Trupës e Detarisë, e cila ka luajtur një rol të madh në përgatitjen dhe furnizimin e Flotës Luftarake Detare me personel oficerë. Më 21 shtator 1958 u ngrit flamuri luftarako-detar në katër nëndetëse të klasit "Whiskey" në Bazën e Pashalimanit, gjë e cila shënoi kalimin në shërbim të Flotës Luftarako-Detare Shqiptare. Për një periudhë të gjatë pasja në përdorim e katër nëndetësive tregonte një fuqi dhe epërsi të madhe në krahasim me vendet e rajonit disa prej të cilëve nuk kishin fare nëndetëse për atë periudhë. Gjithashtu për

vetë specifikën e llojit, nëndetësja ishte një armë strategjike që ishte e vështirë për t'u diktuar. Kjo jepte avantazhe të mëdha në operacionet luftarako-detare.

Periudha e viteve 1961-1980, shënoi zhvillimin e mëtejshëm të Forcave Detare, krijimin e disa reparteve të KS, kompletimin me anije luftarake moderne të kohës. U krijua Shërbimi Hidrografik, si organizim sigurimi lundrimor-detar e të veprimeve luftarake, i cili përgatiti e ngriti një varg faro-fenerësh në gjithë bregdetin, u modernizuan mjaft pika sinjal-vrojtuese dhe u pajisën me një rrjet të gjerë radiolokatorësh.

Periudha e viteve 1980 - 1990, mund të konsiderohet si periudha e vijueshmërisë së lundrimeve, mbijetesës, drejtimit dhe sigurimit të gatishmërisë teknike të anijeve mbiujëse e nënujësë. Një kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë edhe Kantieri Detar i Riparimit të Anijeve në Pashaliman.

Mbas viteve '90, për Forcën Detare shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integrim të natyrshëm me strukturat e NATO-s dhe BEP-it.

Ngjarjet tronditëse të marsit 1997, shkaktuan në repartet e Forcës Detare dëme shumë të mëdha. Gjysma e dytë e vitit 1997 dhe viti 1998, shënon një etape ringritjeje dhe riorganizimi të reparteve të Forcës Detare pas shkatërrimit total. Pas një pune këmbëngulëse dhe përkushtimi maksimal të efektiveve të Forcës Detare, u bë e mundur ringritja dhe funksionimi i Distrikteve Detare të Durrësit e Vlorës, si dhe Bazat Ndihmuese, Sarandë e Shëngjin. Në mars të vitit 1998, me ndihmën e qeverisë së SHB-ve, Forcat Detare u pajisën me 5 motovedeta, të cilat u bënë protagonistë të operacioneve SAR në vitet e ardhshme.

Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit dolën jashtë strukturave luftarake të Forcës Detare, të 4 nëndetëset e saj pas një veprimtarie 40-vjeçare.

Në vitin 2002, me kontributin e qeverisë italiane pas miratimit të ligjit të Rojës Bregdetare shqiptare, nr. 8875 datë. 04.04.2002, Forca Detare u pajis dhe me 6 motovedeta nga Italia, të cilat së bashku me anijet amerikane u futën në strukturat e Rojës Bregdetare. Në gusht 2002, 14 anije të Forcës Detare morën pjesë në operacionin e gjerë antitrafik "PUNA", në bashkëpunim me organet e rendit, anti-kontrabandës, peshkimit, etj., i cili u realizua me sukses dhe bëri të mundur bllokimin e këtij trafiku.

Në qershor 2004, dhurohen nga pala italiane 6 motovedeta për Rojën Bregdetare, duke e çuar në 12 numrin e tyre.

Më datë 5 shtator 2008, në Kalatën Nr. 5 të Portit të Durrësit u zhvillua ceremonia e përirimit të anijes "Iliria" (P-131), e cila mbërriti në Shqipëri në kuadër të zbatimit të kontratës me Ko

## Projekte të tjera të rëndësishme do të jenë dhe modernizimi i sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, si dhe përmirësimi i infrastrukturës së reparteve të Forcës Detare.



paninë Holandeze “DAMEN SHIPYARD”. Projekti me “DAMEN SHIPYARD” vijoi në kantierin e Pashalimanit dhe në vitin 2009 - 2013 u ndërtuan në këtë kantier tre anije të tjera të klasit “Iliria”: “Lisus”, “Oriku” dhe “Butrinti”.

Zhvillimi më i rëndësishëm ishte pjesëmarrja për herë të parë në historinë e Forcës Detare në mision jashtë vendit si pjesë përbërëse e Grupeve Detare të NATO-s. Më datë 21 nëntor 2016, anija “Oriku” P-132 me ekuipazh prej 21 personash u përcoll për në operacionin “Sea Guardian” në detin Egje, si pjesë e SNMG2 (Grupit Detar të NATO-s), parandaloi krizën e emigrantëve. Ky mision vijoi deri në vitin 2019 dhe do të rifillojë në Korrik të vitit 2023.

Misioni dhe detyra e Forcës Detare ndër të tjera janë:

- Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimi i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëpunim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare.

- Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t’iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues.

- Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në drejtimet e kërcënuara.

- Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

- Organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA-së.

- Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det.

- Sigurimi i kushteve hidro-lundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH.

- Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve.

- Të marrë pjesë në përballimin e rreziqeve asimetrike të terrorizmit, kimit të organizuar në bashkëpunim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

Sot, Forca Detare drejtohet nga kundëradmiral Adnand Agastra dhe në përbërje numëron rreth 20 anije, të cilat kryejnë detyra të ndryshme në përbushjen e misionit të saj, dhe së shpejti Forca Detare do të kompletohet me një anije të madhe patrulluese luftarake dhe 6 anije të vogla patrulluese luftarake. Ky kapacitet i ri do të japë një kontribut të drejtpërdrejtë në sigurinë detare dhe në përgjithësi në sigurinë e vendit. Projekte të tjera të rëndësishme ndër të tjera do të jenë dhe modernizimi i sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së reparteve të Forcës Detare.






# KOMANDANTËT E FORCËS DETARE NDËR VITE



Kundëradmiral  
Abdi Mati (1943-1957)



Kundëradmiral  
Teme Sejko (1958-1960)



Kundëradmiral  
Hito Çako (1960-1961)



Kundëradmiral  
Abdi Mati (1961-1973)



Qamili Pona  
(1973-1991)



Ndue Jaku  
(1981-1991)



Tasim Meçe  
(1991-1992)



Kapiten (N) Fitim Halili  
(1992-1993)



Kundëradmiral Edmond  
Zhupani (1993-1994)




Kundëradmiral Muharrem  
Kuçana (1994-1996)



Kundëradmiral Edmond  
Zhupani (1996-1997)



Kapiten (N) Vladimir  
Beja (1997)



Kapiten (N) Robert Bali  
(1997-1998)



Kundëradmiral  
Kudret Çela (1998-2005)



Kapiten (N) Kristaq  
Gërveni (2005-2009)



Kundëradmiral  
Kudret Çela (2009-2012)



Kapiten Ferdinand  
Kreshpani (2012)



Gjeneral brigade  
Qemal Shkurti (2012-2015)



Gjeneralmajor  
Ylber Dogjani (2015-2019)



Gjeneral brigade  
Ilir Xhibexhia (2019-2022)



Kundëradmiral  
Adnan Agastra





KOMANDANT I FORCËS AJRORE,  
GJENERAL BRIGADE  
YLLI PULAJ

# Forca Ajrore, margaritarët e vendit të shqiptonjave

FORCA AJRORE KA NË OBJEKTIVAT E SAJ KOMPLETIMIN  
EDHE ME MJETE TË TJERA AJRORE KRAHAS ATYRE QË KEMI  
AKTUALISHT. ARDHJA E HELIKOPTERËVE “BLACK HAWK”  
DO TA VENDOSË PERSONELIN FLUTURUES PËRBALLË DHE  
PËRKRAH KOLEGËVE TË ALEANCËS.



Përpjekjet e para për t'i futur aeroplanët e parë në shërbim të ushtrisë nisin aty nga fillimi i viteve 1920. Por, vetëm pas çlirimit të vendit, më 24 prill 1951, u krijuan Forcat Ajrore të ushtrisë shqiptare, që mundësuan krijimin e Aviacionit Ushtarak.

Në vitet 1945-1955 Shqipëria ishte shndërruar në një arenë të mbikalimeve të shumta e të pakontrollueshme të aeroplanëve të huaj ushtarakë dhe civilë, ndaj kërkoheshin masa urgjente dhe efektive për mbrojtjen e dimensionit të tretë - atij të hapësirës ajrore, e cila paraqitej më e dobët e tepër delikate, krahas mbrojtjes së kufijve tokësorë e detarë.

Në këtë kohë u shtrua për zgjidhje një problem me karakter strategjik, krijimi i forcave ushtarake kundërajrore, që do të përfshinin: Aviacionin Luftarak, Artilerinë e Mbrojtjes Kundërajrore dhe mjetet e zbulimit të hapësirës ajrore, të drejtuara nga një staf drejtues.

Në vitin 1959 aviacioni ynë u pajis me aeroplanë reaktivë supersonikë interceptues, për kryerjen e detyrave luftarake në të gjitha kushtet meteorologjike dhe u armatos me raketa ajër-ajër. Kështu, u çel në Shqipëri era e aeroplanëve superzanorë.

Pas prishjes së marrëdhënieve të vendit dhe të ushtrisë sonë me Traktatin e Varshavës, aviacionit iu ndërpre të gjitha furnizimet me karburant, për pjesë këmbimi e materiale konsumi, municione, remontin teknik etj. U ndërpre edhe përgatitja dhe shkollimi i kuadrove fluturues dhe inxhiniero-teknik. Ndryshimi i kahut të politikës shqiptare dhe orientimi i saj drejt Republikës Popullore të Kinës ishte zgjidhja e kohës, tashmë me aeroplanë më të sofistikuar, siç ishin ata MIG-21.

Ndërkaq, nisi përgatitja e kuadrove fluturues e teknikë, duke hapur shkollën e aviacionit, e cila përballoi me shumë sukses kompletimin e reparteve me pilotë, teknikë dhe specialistë.

Në periudhën 1961-1978, në mënyrë graduale, u krijuan tre regjimente të aviacionit gjuajtës dhe gjuajtës-bombardues të strehuar në tunele, një regjiment helikopterësh MI-4, një skuadrilje autonome e transportit ushtarak AN-2, u kompletua shkolla e aviacionit me aeroplanë luftarako-mësimorë dhe me të gjitha mjetet e nevojshme mësimore didaktike dhe detashmenti i avionëve qeveritare IL-14.

U ndërtua uzina e riparimit kapital të aeroplanëve dhe helikopterëve. Në Republikën Popullore të Kinës u specializuan rreth 150 pilotë luftarakë për drejtimin e aeroplanëve supersonikë MIG-19 dhe MIG-21.

Në prill të vitit 1945, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare, u krijua Seksioni i Aeronautikës.

Data zyrtare e krijimit të Aviacionit Luftarak Shqiptar është 24 prilli, dita kur piloti shqiptar Peço Polena fluturoi me një avion të Shtetit Shqiptar, të montuar e përgatitur nga specialistët e vendit tonë. Ky fluturim historik u realizua në aerodromin e Laprakës.

#### **Regjimenti i Aviacionit Luftarak, Kuçovë**

Baza e Kuçovës është reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë. Data 15 maj 1955 është data e krijimit të regjimentit. Regjimenti përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktivë MIG-15. Në vitet e fundit ky repart kishte dy skuadrilje me nga 12 avionë MIG-15 dhe 4 avionë UTI MIG-15, gjithsej 28 avionë. Komandant u caktua Niko Hoxha, zëvendëskomandant Fahri Bubësi, zëvendëskomandant për punën politike Babaçe Faiku, kryeinxhinier Qirjako Trebicka, komandant i skuadriljes së parë Vasil Trasha.

#### **Regjimenti i Aviacionit Luftarak, Rinas**

Regjimenti i Rinasit i ka fillimet e tij në vitin 1959, kohë në të cilën përfundoi pista e tij. Në shkurtin e vitit 1962, njësisia ushtarake e dislokuar në këtë aerodrom u emërtua "Regjimenti i Tretë i Aviacionit Gjuajtës Bombardues". Fillimisht, Regjimenti i Rinasit kishte një skuadrilje me avionë MIG-19PM dhe një skuadrilje tjetër me avionë MIG-17, ndërsa në vitet e fundit tri skuadrilje MIG-19, një avion bombardues IL-28,

disa avionë UTIMIG-17 dyvendësh reaktivë dhe katër avionë të lehtë transporti.

Pilotët e Regjimentit të Kuçovës u trajnuan në ish-Bashkimin Sovjetik, për përvetësimin e avionit MIG-19. Ata kishin një eksperiencë katër-pesëvjeçare fluturimi në avionët MIG-15 dhe mjaft prej tyre ishin pilotë të Klasit I.

Komandant i regjimentit u caktua Niko Hoxha, pilot i Klasit I, ndërsa zëvendëskomandant për fluturimin Haki Jupasi, shef i Shtabit të repartit ishte Pep Polena, shef operativ Pertef Myftari, ndërsa komandantë të skuadriljeve ishin Lulo Musaj dhe Kosta Dede.

Këtë regjiment gjatë viteve e kanë komanduar: Niko Hoxha, Edip Ohri, Haki Jupasi, Mahmut Hysa, Gezdar Veipi, Harilla Rebi, Idriz Hoxha, Asim Bime, Petrit Ligaj, Murat Arra, Shefqet Lata, Shahin Guraj, Arçile Kokëdhima, Vladimir Avdia, Thanas Kulegi dhe Tomorr Dyrmo.

#### **Akademia e Aviacionit**

E emërtuar fillimisht si "Shkolla e Aviacionit" dhe më vonë si "Akademia e Forcave Ajrore", u krijua zyrtarisht, më 11 maj të vitit 1962, komandohej nga njëri prej "pionierëve" të Aviacionit Shqiptar, kolonel Babaçe Faiku, pilot i Klasit I. Në këtë Akademi u përgatitën rreth 1 300 pilotë, teknikë dhe specialistë. Në pranverë të vitit 1958 filloi praktika e fluturimit në aerodromin e Tiranës me komandant kursi Areteo Ikonomi.

Në vitet 1967-1968 u bë riorganizimi i shkollës dhe ndarja në dy grupe mësimore, grup teknik dhe grup ajror dhe filloi përgatitja e instruktoreve të rinj, ndërkohë që shkolla kalon nga cikli dyvjeçar në atë trevjeçar. Në vitin 1971, me vendim të Këshillit të Mbrojtjes, ajo u emërtua "Shkolla e Lartë e Aviacionit". Pas viteve '90, Akademia e Aviacionit hyri në rrugën e transformimeve në përshtatje me kushtet e reja që u krijuan në vendin tonë. Pas përfundimit të Universitetit Ushtarak "Skënderbej", aty përgatiteshin nga ana profesionale oficerët dhe gjithë specialistët e Forcave Ajrore. Gjithashtu, ajo shërbeu edhe si qendër për mësimin e gjuhëve të huaja. Pas përfundimit të studimeve nga njëzet nëntogeretë e fundit të diplomuar nga Akademia e Aviacionit në vitin 2005, fillon një etapë e re në jetën e saj, ajo e Shkollës së Trupës së Forcave të Armatosura. Kjo shkollë ka si mision përgatitjen profesionale dhe kualifikimin e oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve profesionistë dhe civilëve të Forcave Ajrore, për të përbushur detyrat funksionale në përputhje me shërbimet dhe specialitetet përkatëse për specialitetet aviacion, mbrojtje ajrore, meteorologji, SAR, trafik ajror etj. Shkolla e Trupës Varet nga Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes. Komandanti i aviacionit është emëruar për herë të parë në vitin 1955, në krye të aviacionit u caktua Edip Ohri, i cili njëkohësisht ishte edhe zëvendëskomandant i MKA-së.

Në vitin 1974 aviacioni u sanksionua si komandë më vete dhe si e tillë ka qëndruar deri në vitin 1995. Në vitin 1995 repartet e aviacionit u bënë pjesë e Forcave të Mbrojtjes Ajrore, një strukturë që përmblihte MKA-në, aviacionin, Regjimentin Radio/Teknik. Në krye të Forcave të Mbrojtjes Ajrore drejtuan gjeneral Perlat Sula dhe gjeneral Agim Baruti. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, u përcaktua se: "Forcat e Armatosura përbëhen nga Forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore". Me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, datë 08.04.2000, "Për fillimin e ristrukturimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", doli urdhri i ministrit të Mbrojtjes, "Për kalimin në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore". Komandant i Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë u emërua kolonel Astrit Jaupi (gjeneral brigade në vitin 2001).

Në vitin 2008 Forca Ajrore emërtohet "Brigada Ajrore", në vartësi të Komandës së Forcës së Bashkuar (KFB), ndërsa në vitin 2010 rimerem emrin ekzistues, "Forca Ajrore".

## **Struktura organizative e Komandës së Aviacionit**

Komanda dhe shtabi i Aviacionit Luftarak Shqiptar ka qenë një strukturë e vogël prej rreth 14 vetash. Si rregull, problemet ushtarake dhe të gatishmërisë drejtoheshin nga shefi i Shtabit. Për një periudhë të gjatë kohe, shefi i Shtabit të Aviacionit ka qenë Elmaz Hasanmataj dhe më pas Sotir Majko. Ndhimësit më të afërt të shefit të Shtabit ishin shefi operativ dhe një shef stërvitjeje. Fillimisht, në këto detyra kanë punuar respektivisht Pertef Myftari e Muço Muçaj, ndërsa më vonë edhe Pandeli Berberi, Barjam Dervishi etj. Dy pilotë, nga më të përgatiturit në vend, ishin ndihmës të komandantit për problemet e cilësisë së përgatitjes për fluturim, si dhe për kontrollin e efektivave fluturues. Inspektorët "historikë" të Komandës së Aviacionit kanë qenë Anastas Ngjela e Koço Biku. Në këtë Shtab një figurë e rëndësishme ishte ajo e kryeinxhinierit të aviacionit. Në shtabin e aviacionit, një oficer përgjigjeje për sigurimin e aerodromeve, ruajtjen e mirëmbajtjen e tyre. Shtabi kishte gjithashtu specialistë ushtarakë për mbështetjen logjistike, teknikën e transportit, organizimin, personelin, sigurimin etj. Edip Ohri qëndroi si komandant aviacioni nga viti 1955 deri më shkurt 1975. Në këtë vit, Aviacioni Luftarak u krijua si komandë më vete pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandant i saj emërohet Bardhyl Taçi, ndërsa komisar Sali Dibra, i pari dhe i fundit në këtë post. Bardhyl Taçi ka komanduar nga viti 1975 deri në vitin 1990. Nga viti 1990 deri në 1993 në këtë detyrë ka qenë kolonel Klement Aliko, ndërsa nga viti 1993 - 1995 gjeneral Perlat Binaj. Që nga viti 1995, në Forcat e Armatosura të Shqipërisë nuk ka funksion organik me emërtimin "Komandant i Aviacionit Luftarak".

## **Regjimenti i Helikopterëve, Farkë**

Më 6 dhjetor të vitit 1967 formohet njësi e emërtuar "Regjimenti i Parë i Helikopterëve" i dislokuar në Farkë. Në vitin 1957 erdhën helikopterët e parë që u montuan në kohë dhe me cilësi. Në shtator të vitit 1962 erdhën nga ish-Bashkimi Sovjetik pilotët dhe teknikët e rinj, që kishin studiuar dhe kryer shkollat e plota për helikopterët, si: Stavri Prenda, Et'hem Mehmeti, Agron Galanxhi, Agim Levanaj, Vangjel Nakuçi, Sybi Koçi, Muharrem Hida, Mikel Janku, Ndue Logu, Agim Nanaj etj.

36 helikopterë të rinj MI-4 erdhën nga Republika Popullore e Kinës, me të cilët më 6 dhjetor të vitit 1967 formohet njësi e emërtuar "Regjimenti i Parë i Helikopterëve", me komandant Lulo Musain e komisar Tomor Avdia. Regjimenti i Helikopterëve në Farkë kishte në përbërjen e tij tri skuadrilje me helikopterë MI-4. Numërohen mbi 3 600 misione dhe mbi 52 000 fluturime të këtij regjimenti. Pas viteve '90 regjimenti ka marrë pjesë gjithashtu edhe në mjaft stërvitje të përbashkëta me ushtri të ndryshme të rajonit.

## **Baza Ajrore e Aviacionit, Gjadër**

Baza Ajrore e Gjadrit është formuar e fundit në repartet e aviacionit. Ajo u krijua në shkurt të vitit 1974 dhe ishte një bazë tërësisht e tunelizuar, e cila kishte dy skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-21. Aviacioni Luftarak Shqiptar në atë kohë numëronte mbi 200 avionë e helikopterë, të cilët që të gjithë ishin të prodhimit lindor. Pothuajse pas dy vjetësh, pas përfundimit të infrastrukturës së plotë, më 18 dhe 19 maj të vitit 1976, do të fillonte në Gjadër ribazimi i skuadriljes së parë të avionëve të këtij reparti, i skuadriljes MIG-21. Së bashku me disa avionë mësimorë, skuadrilja zbarkonte në këtë aerodrom me të njëmbëdhjetë avionët MIG-21.

Në vjeshtën e 1976, regjimenti mori përmasat e plota organike. Komandanti i saj i parë u caktua Bardhyl Taçi, i cili qëndroi fare pak në atë detyrë, sepse pak kohë më vonë u caktua komandant i Aviacionit Shqiptar. Gëzdar Veipi ishte pasuesi i tij si komandant i bazës. Dhori Zhezha ishte komandanti i tretë i bazës.

## **Shërbimi Meteorologjik Ushtarak**

Në vitin 1949, nga Instituti i Shkencës u krijua Rrjeti Meteorologjik Kombëtar, i cili përfshinte tërësinë e shërbimeve meteorologjike në të gjithë vendin. U montuan nëntë vendmatje të pajisura me aparatura të kohës në Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës, Tiranë, Kuçovë, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë. Vendmatjet ishin të shpërndara në të gjithë vendin. Vetëm në Stacionin Qendror Tiranë punoheshin me dorë dhe analizoheshin katër harta sinoptike tokësore, të cilat shërbenin për të mbuluar me parashikim moti të gjithë territorin e vendit. Bashkëpunimi më botën e jashtëm realizohej nëpërmjet Qendrës Meteorologjike në Sofje të Bullgarisë.

Në vitin 1956, pranë Shërbimit Meteorologjik ngrihet sektori i Aerologjisë. Në vitin 1957 të nëntë stacionet e rrjetit të Shërbimit Meteorologjik të Aviacionit regjistroheshin në Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO).

Me krijimin e aeroporteve, në vitin 1960 krijohet Stacioni Sinoptik i Rinasit për sigurimin meteorologjik të Aviacionit Ushtarak, si dhe atij Civil në linjat ndërkombëtare, ndërsa, në vitin 1967 u krijua stacioni sinoptik i Farkës dhe në vitin 1974 stacioni sinoptik i Gjadrit.

Në nëntor-dhjetor të vitit 2000 u kthyen në stacione moderne, Stacioni Qendror Meteorologjik i Tiranës, si dhe ato të Farkës, Gjadrit dhe Kuçovës. Më 23 shtator 2004, filloi dhënia e informacionit të motit në Televizionin Publik Shqiptar nga ana e Shërbimit Meteorologjik të Forcave Ajrore. Shërbimi Meteorologjik ka një rrjet Stacionesh të shpërndarë në territorin e RSH, të vendosura në: Tiranë, Farkë, Kuçovë, Vlorë, Gjadër, Shkodër, Kukës, Peshkopi, Durrës, Korçë, Gjirokastrë si dhe tashmë dhe 3 stacione të rinj në Bajram Curri, Elbasan dhe Sarandë.

Shërbimi Meteorologjik i përket tashmë standardeve të NATO-s, si në pikëpamje të metodologjisë ashtu dhe teknologjisë e pajisjeve në përdorim për kryerjen e matjeve meteorologjike dhe programeve të përpunimit e transmetimit të informacionit.

## **Forca Ajrore sot**

Sot misioni i Forcës Ajrore është sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e NATO-s, në mënyrë të pandërprerë dhe me rigorozitet.

Ajo realizon zbulim të pandërprerë të Hapësirës Ajrore Shqiptare, kryen transport të trupave dhe grupeve taktike ushtarake operacionale, luan një rol kryesor në përbalimin e emergjencave civile në çdo kohë, në detyrë të ndryshme si në transportin nga ajri të të sëmëruarë rëndë apo të plagosur nga zona të largëta të vendit tonë, në transportimin nga ajri të ndihmave emergjente në zona të izoluar nga bora, në evakuimin nga ajri në zonat e përmbytura, në shuarjen e zjarreve në pyje, kullota etj.

Misioni i Forcës Ajrore realizohet nëpërmjet strukturave të saj përbërëse siç janë: Qendra e Kontroll-Raportimit; Baza Ajrore Farkë, e cila është baza kryesore operacionale; Baza Ajrore Kuçovë, e cila ka shërbyer si bazë mbështetëse për zhvillimin e stërvitjeve ajrore të përbashkëta dhe së fundmi do të rritet roli i saj si një bazë ajrore taktike e NATO-s; Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, i cili mbulon me parashikim të motit, të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe Qendra Stërvitore.

Shqipëria, si anëtare me të drejta të plota në NATO, qysh prej vitit 2009, ka përgjegjësitë dhe detyrat e saj për të kontribuar në misionin dhe detyrat e kësaj organizate politiko-ushtarake, për mbrojtjen dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë. Konkretisht, vendi ynë ka kontribuar prej vitesh në shumë misione dhe operacione të ndryshme që ka organizuar NATO si në Afganistan, Irak, Gjeorgji, Letoni, Kosovë etj., në misionet të ndryshme ushtarake dhe paqeruajtëse.

Ristrukturimi dhe modernizimi i Bazës Ajrore të Kuçovës, ka rëndësi të madhe për vendin tonë pasi e rendit Shqipërinë në krah të vendeve anëtare që kanë më shumë potenciale, resurse dhe kapacitete ushtarake, gjithashtu kjo bazë, ka një rëndësi të madhe për NATO-n, pasi ajo do të rrisë aftësitë operacionale të saj, për të operuar me më shumë efektivitet në çdo nevojë të mundshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë si dhe do të shërbejë për trajnimin dhe stërvitjet e përbashkëta të ushtarakëve tanë me ato të NATO-s. Kjo do të mundësojë gjithashtu gjenerimin e një pakete financiare për ekonominë e kësaj zone, rritjen e besueshmërisë për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, rritjen e përgjegjshmërisë dhe dinjitetit të shqiptarëve, duke demonstruar se vendi ynë është një aleat i besueshëm dhe partner serioz i NATO-s.

## **Objektivat e Forcës Ajrore dhe roli i saj në këtë bashkëpunim**

Forca Ajrore ka në objektivat e saj kompletimin edhe me mjete të tjera ajrore krahas atyre që kemi aktualisht. Ardhja e helikopterëve "Black Hawk" do ta vendosë personelin fluturues përballë dhe përkrah kolegëve të Aleancës dhe do t'i angazhojë ato për rritjen e përkushtimit dhe vlerësimit që i duhet bërë trajnimit dhe stërvitjes me mjetet ajrore të gjeneratës moderne siç janë helikopterët "Black Hawk". Gjatë këtyre 13 viteve që Forcat e Armatosura aderojnë në NATO, ushtarakët tanë janë rreshtuar me dinjitet dhe profesionalizëm në krah të ushtarakëve të vendeve më të përparuara, duke marrë pjesë në shumë operacione dhe stërvitje të përbashkëta. Stërvitja që u zhvillua vitin e kaluar, "Defender Europe-21", në vendin tonë, e tregoi më së miri një gjë të tillë, ku Shqipëria mori vlerësime shumë të larta nga aleatët e NATO-s dhe tregoi se një vend i vogël siç jemi ne, mund të koordinojë dhe përballojë edhe stërvitje të mëdha.



# KOMANDANTËT E FORCËS AJRORE NDËR VITE




1951-1952  
Babaçe Faiku



1952-1955  
Niko Hoxha



1955-1974  
Edip Ohri



1974-1990  
Bardhyl Taçi



1990-1993  
Klementin A. Klementin




1993-1995  
Perlat Binaj



1954 - 1955  
Gjeneralmajor Gjin Marku



1955 - 1956  
Kolonel Sotir Hilto




1956 - 1959  
Gjeneralmajor Hito Cako



1959 - 1966  
Gjeneral Arif Hasko



1966 - 1967  
Kolonel Bejto Isufi



1967 - 1970  
Gjeneral Todi Naco



1975 - 1982  
Naum Gjinkasi



1992 - 1995 Gjeneral  
brigade Ylli Dimaj



1995 - 1996  
Gjeneralmajor Perlat Sula



1996 - 1997  
Gjeneralmajor Agim Baruti




1997 - 2001  
Gjeneralmajor Perlat Sula



2001 - 2008  
Gjeneral brigade Asmit Jaupi



2008 - 2013 Gjeneral  
brigade Dhori Spirollari



2013 - 2018  
Gjeneral brigade Fredrik Beltoja



2018 - 2021  
Gjeneral brigade Vladimir Avdiqaj



Janari 2022  
Gjeneral brigade Ylli Gjulaj



*Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes është kursi më i lartë në piramidën e arsimimit në karrierën ushtarake. Ky kurs aktualisht zhvillohet sipas një programi dhe metodologjie të ngjashme me qendrat dhe kolegjet e vendeve partnere.*

# **Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë,** strukturë e re e Forcave të Armatosura



## HISTORIKU

Sistemi arsimor ushtarak në vendin tonë ka pasur dy nivele arsimimi: Niveli i arsimimit profesional bazë, që titullonte oficerë përmes ish-Shkollës së Bashkuar të Oficerëve (me disa specialitete) dhe Shkollat e Larta të Aviacionit dhe Marinës në nivelin e arsimit të lartë. Niveli i arsimimit akademik, që përgatiste drejtues në nivel brigade, divizioni, korpusi dhe drejtuesit e forcave. Ky model ka funksionuar si për përgatitjen profesionale të oficerit për kryerjen dhe drejtimin e veprimeve luftarake në terren, ashtu edhe për edukimin me njohuritë dhe aftësitë për të drejtuar dhe marrë vendime në nivel strategjik. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) është krijuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, datë 16 gusht 2001, në kuadrin e ristrukturimit të përgjithshëm të FA-ve në vendin tonë. Më 1 shtator të vitit 2001, ka filluar funksionimi i saj, kjo datë njihet dhe si data e krijimit të institucionit të KDS-së me komandant gjeneralmajor Perlat Sula, me kompetencë të plotë firme e vule me numër fondi arkivor 509. Nga viti 2001 e në vazhdim, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes në kuadrin e ristrukturimeve të vazhdueshme të FA-së ka pësuar ndryshime në koncepte dhe strukturë.

Institucioni i Akademisë së Forcave të Armatosura, deri në daljen e Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Nr. 7458, datë 11.05.2012

“Struktura Organizative e FA-ve të RSH-së”, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” nga data 01.10.2012, mori emrin “Akademia e Forcave të Armatosura” dhe përbëhej nga dy Fakultete: Fakulteti i Arsimit të Përgjithshëm, (ish-Akademia Ushtarake “Skendërbej”) dhe Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes, (ish-Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”).

Krijimi i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë erdhi si domosdoshmëri e ndarjes së arsimimit për zhvillimin e karrierës së personelit ushtarak e civil dhe si nevojë e përmirësimit të vazhdueshëm cilësor në përshtatje me zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë vjen nga për-

voja e arsimit tonë ushtarak ndër vite, vendeve Baltike dhe e shumë vendeve të NATO-s, tashmë si strukturë më vete arsimore brenda Forcave tona të Armatosura.

Në Forcat e Armatosura kjo strukturë tashmë është institucioni i Arsimit të Lartë Ushtarak Profesional për të gjitha kurset e karrierës deri në nivelin strategjik, nëpërmjet aplikimit të metodave dhe parimeve më të fundit të avancuara arsimore, menaxhimit efektiv dhe përdorimit të burimeve intelektuale shkencore dhe materiale.

Në këtë njësi arsimore në fushën e sigurisë dhe të mbro-



**Struktura e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë është: Drejtimi dhe Mbështetja, Komanda e Kurseve, Dega e Kurrikulës dhe Punës Shkencore, Dega e Administrimit dhe Mbështetjes, Sektori i Financës, Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake, Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara dhe Departamenti i Operacioneve Ushtarake.**







jtjes do t'i jepet rëndësi kualifikimit ushtarak dhe civil të personelit të Forcave të Armatosura në shkallë vendi, të vendeve aleate dhe partnere, duke promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në nivel rajonal dhe duke rritur dukshëm masat e besimit reciprok.

Struktura e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë është: Drejtimi dhe Mbështetja, Komanda e Kurseve, Dega e Kurrikulës dhe Punës Shkencore, Dega e Administrimit dhe Mbështetjes, Sektori i Financës, Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake, Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara dhe Departamenti i Operacioneve Ushtarake.

Në këtë strukturë do të planifikohen, zhvillohen dhe drejto-

hen kurset e karrierës si:

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH), Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP), Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) dhe Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM).

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes është kursi më i lartë në piramidën e arsimit në karrierën ushtarake. Ky kurs aktualisht zhvillohet sipas një programi dhe metodologjie të ngjashme me qendrat dhe kolegjet e vendeve partnere. Kurrikula e këtij kursi nisur dhe nga eksperienca shumë e mirë e realizimit të tij ka bërë që të marrin pjesë në të dhe pjesëmarrës nga vendet e rajonit, të NATO-s dhe ato të PpP-së.

Në kuadrin e qasjes rajonale, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sig-



të tjera të sigurisë kombëtare, për përdorimin kreativ dhe me efikasitet të elementëve të fuqisë kombëtare në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe arsimimin e liderëve civilë e ushtarakë të vendeve partnere dhe të NATO-s.

Kjo përmban një përgjegjësi të madhe, e cila po realizohet me shumë seriozitet nga i gjithë personeli i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë me zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor për të përmbushur pritshmëritë dhe misionin e kësaj strukture të re të Forcave të Armatosura.

*Major Drilona Hoxhaj*



urisë, si strukturë e sapokrijuar, ka ambicien që në një të ardhme të afërt në bashkëpunim me Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të kalojë nën frymën e ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku kursantët e Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursit të Lartë të Oficerit, përveç diplomës ose certifikatës për kurset institucionale mund të marrin dhe Diplomën “Master Profesional”, “Master shkencor” në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, si struktura më e re elitare e Forcave tona të Armatosura ka si mision: Edukimin dhe kualifikimin e personelit ushtarak e civil nëpërmjet programit mësimor, në nivelet e larta të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve





# SHQIPËRIA,

## pjesë e familjes së madhe të sigurisë euroatlantike, përfitimet dhe detyrimet



Gjeneral brigade **ILIR PUJO**,  
Përfaqësues Ushtarak në  
Përfaqësinë e Përhershme të  
Republikës së Shqipërisë në NATO.

NATO dhe BE janë dy nga institucionet kryesore të sigurisë euroatlantike, dhe anëtarësimi në to e rreshton vendin tonë në një arkitekturë unike sigurie, që ofron sigurinë dhe mbrojtjen nga çdo kërcënim i jashtëm konvencional dhe asimetrik dhe në të njëjtën kohë janë një garanci për ruajtjen e vlerave të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit.

Shqipëria prej më se 13 vjetësh (4 prill 2009) është anëtare e Organizatës së Atlantikut të Veriut (NATO), një aleancë politike dhe ushtarake e cila mbledh së bashku 30 vende anëtare (së shpejti 32) nga Europa dhe Amerika e Veriut dhe një nga institucionet ndërkombëtare më të mëdha në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Po ashtu, prej korrikut 2022, Shqipëria çeli zyrtarisht negociatat e anëtarësimin në Bashkimin Europian, duke hedhur një hap tjetër të rëndësishëm drejt anëtarësimin të plotë në këtë organizatë që, përtej dimensionit politik dhe ekonomik, përfaqëson





dhe një dimension të spikatur në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes europiane dhe asaj ndërkombëtare.

Sot, NATO dhe BE janë dy nga institucionet kryesore të sigurisë euroatlantike, dhe anëtarësimi në to, e rreshton vendin tonë në një arkitekturë unike sigurie që ofron sigurinë dhe mbrojtjen nga çdo kërcënim i jashtëm konvencional dhe asimetrik dhe në të njëjtën kohë janë një garanci për ruajtjen e vlerave të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Vetëm NATO sot përfaqëson rreth 1 miliard njerëz dhe zotëron mbi gjysmën e fuqisë ushtarake dhe ekonomike botërore.

Agresioni i paprovokuar rus ndaj Ukrainës në shkurt të këtij viti përbën një realitet të ri strategjik për Aleancën. Ai ka rikthyer në qendër të vëmendjes rishikimin e pozicionit dhe rolit që NATO duhet të luajë si garant i sigurisë dhe mbrojtjes së popullsisë brenda territorit të saj dhe rolit si kontribuues i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe në këtë kuadër edhe të vendit tonë. Më poshtë po japim një panoramë

të përgjithshme se cilat janë disa nga përfitimet kryesore e të qenit pjesë e kësaj familje të madhe të sigurisë euroatlantike, duke vijuar me atë çfarë NATO po bën sot për të garantuar sigurinë e qytetarëve të saj dhe më tej me rolin e Shqipërisë si anëtare e saj dhe aktivitetet që Forcat e Armatosura shqiptare janë të angazhuara dhe po realizojnë në kuadër të NATO-s.

#### **Garancitë dhe përfitimet nga anëtarësimi në NATO**

Garancia thelbësore e të qenit nën këtë ombrellë sigurie euro-atlantike qëndron në Nenin pesë të Traktatit të Atlantikut që është mbrojtja kolektive. Sipas këtij neni, një sulm i armatosur ndaj një vendi anëtar do të konsiderohet si sulm ndaj çdo vendi anëtar të NATO-s. Në Samitin e 30 qershorit 2022 të NATO-s në Madrid, Spanjë, kur iu referua këtij Neni, presidenti amerikan Joe Biden deklaroi se: "Në këtë samit, ne riafirmojmë unitetin dhe vendosmërinë e aleancës sonë për mbrojtjen e çdo centimetri të territorit të NATO-s, dhe ne e besojmë atë kur themi se një sulm

ndaj njërit është sulm ndaj të gjithëve". Prej Nenit 5 të mbrojtjes kolektive, vjen në fakt dhe mbështetja e madhe nga publiku euroatlantik për NATO-n. Për të ilustruar këtë mbështetje, po i referohem sondazhit të fundit të organizuar nga NATO në muajt nëntor - dhjetor 2021, ku mbështetja e vendeve anëtare ndaj NATO-s qëndron në vlera të larta, ndërsa në Shqipëri kjo mbështetje vijon të jetë ndër më të lartat. Kështu, anëtarësimi dhe qëndrimi në NATO mbështetet nga rreth 62% e publikut e vendeve anëtare, dhe nuk mbështetet nga rreth 11% e tyre. Ndërsa në Shqipëri qëndrimi në NATO mbështetet nga rreth 82% e popullsisë dhe nuk mbështetet nga vetëm 2% e tyre.

Kjo mbështetje e gjerë ndaj NATO-s është e paprecedentë në krahasim me organizata të tjera të ngjashme. Megjithatë Neni 5 i mbrojtjes kolektive është garancia kryesore e një mbështetjeje kaq të gjerë ndaj NATO-s, nuk është ai i vetmi përfitim për vendet anëtare. Janë një numër garancish të tjera, të cilat së bashku i japin besueshmëri të lartë NATO-s si organizatë dhe mbështetje të gjerë nga publiku.

Një garanci e rëndësishme që buron nga të qenit anëtar në NATO është përfaqësimi. Sot, si asnjëherë më parë në historinë e Shqipërisë, vendi ynë ulet në tavolinën kryesore dhe ka zërin e vet në të gjitha vendimmarrjet e aleancës. Ky është një përfitim unik. Përgjatë gjithë historisë sonë kombëtare për liri dhe pavarësi, të gjitha vendimet e rëndësishme që janë marrë ndaj vendit tonë nga fuqitë e kohës janë marrë pa vullnetin e popullit tonë, e kjo sepse vendi ynë nuk kishte përfaqësim në tryezat e vendimmarrjes. Anëtarësimi në NATO ka bërë të mundur që ne të ulemi si të barabartë me aleatët tanë, të diskutojmë si të barabartë dhe të marrim vendime si të barabartë me ta, plotësisht në përputhje me interesat kombëtare. Kushdo që ka punuar në NATO dhe në gjithë strukturën e komandës dhe të forcës së saj ka qenë dhe është dëshmitar i kësaj fuqie që të jep përfaqësimi. Një nga fuqitë e rëndësishme të aleancës me përfitime për çdo anëtar është parimi i marrjes së vendimeve me konsensus. Çdo direktivë, proces, politikë apo vendimmarrje në NATO merret nëpërmjet konsultimit dhe konsensusit. Kjo i jep fuqi të barabartë çdo vendi aleat anëtar, të madh apo të vogël. Kjo i ka dhënë dhe i jep në mënyrë konstante vendit tonë, mundësinë të mbajë qëndrime dhe të gjejë konsensus për çështje të interesit të përbashkët por edhe atij kombëtar, siç është rasti, p.sh., i qëndrimeve për Kosovën dhe ecurinë e operacionit të KFOR-it atje, apo operacionit ALTHEA, si operacione të drejtuara dhe koordinuara nga NATO dhe BE, respektivisht në Kosovë dhe Bosnjë - He

cegovinë, për të kontribuar dhe siguruar një ambient të sigurt dhe stabilitet të gjerë në Ballkanin perëndimor. Shembull tjetër kuptimplotë është solidarizimi, reagimi dhe qëndrimi pa ekuivok në krah të Shqipërisë i Aleancës dhe vendeve aleate ndaj sulmeve kibernetike që pësoi vendi ynë, nga një aktor shtetëror duke atribuar e cilësuar si përgjegjëse qeverinë e Iranit. Garancia tjetër që vjen prej aleancës me përfitime të padiskutueshme për vendin tonë është ruajtja dhe mbrojtja e vlerave themelore të demokracive liberale perëndimore. Shqipëria ka fatin të bëjë pjesë në një organizatë ndërkombëtare që nëpërmjet fuqisë politike dhe ushtarake ushtron, mbron dhe promovon paqen në hapësirën euroatlantike, bazuar në vlerat e përbashkëta të demokracisë, lirive individuale dhe sundimin e ligjit. Qëndrimi dhe reagimi i NATO-s ndaj agresionit të paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, ndihma e pakufizuar që i është dhënë dhe po i jepet në nivel politik, ushtarak dhe ekonomik Ukrainës në mbrojtjen e vendit të tyre, janë shembulli kuptimplotë se NATO dhe të gjithë vendet aleate të saj, janë në anën e duhur të historisë, në mbrojtjen e ligjit ndërkombëtar dhe parimeve të paprekshmërisë së sovranitetit kombëtar dhe kufijve shtetërorë të shteteve, të ruajtjes së rendit aktual ndërkombëtar dhe respektimit të vlerave universale të sanksionuara në parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Një aspekt i dallueshëm dhe me terma konkretë përfitimi janë investimet për sigurinë. NATO, nëpërmjet Programit të Investimeve për Sigurinë, investon në projekte infrastrukturore kombëtare me interes të dyfishtë; për forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes së vendeve aleate por edhe në interes të mbrojtjes kolektive. Shqipëria në këtë kuadër ka përfutur dhe po materializon një projekt mbi 40 milion dollarë për përmirësimin e infrastrukturës ushtarake të Bazës Ajrore të Kuçovës, duke e kthyer atë në një Bazë Taktike Ajrore të NATO-s, dhe po punon me Aleancën për sigurimin e një fondi shtesë për pajisje ushtarake për Kuçovën. Në të njëjtën kohë kanë filluar procedurat për bërjen të mundur të një investimi tjetër ushtarak në Portin e ri detar të Porto Romano-s, që do të ndërtohet aty. Së fundi, tipar dallues i NATO-s është uniteti dhe kohezioni. Të qenit në unitet dhe kohezion të plotë përfaqëson një vlerë të shtuar në listën e përfitimeve nga anëtarësimi në NATO. NATO është një organizatë e gjallë, me diskutime e konsultime që shpesh janë të gjata deri në arritjen e konsensusit. Por diskutimet dhe konsultimet për të sheshuar diferencat në qëndrime dhe për të gjetur një platformë apo rrugë të përbashkët për të ecur përpara, janë një kualitet dhe veçori dalluese për Aleancën. Sapo konsensusi është arritur



gjithkush në organizatë, vertikalisht në strukturën e komandim-kontrollit të NATO-s dhe horizontalisht në strukturat kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, punojnë drejt realizimit të objektivave të vendosura dhe angazhimeve të marra. Uniteti dhe kohezioni është forca dhe vlera e shtuar e Aleancës Euroatlantike. Shembull i shkëlqyer uniteti dhe kohezioni është p.sh. puna e përbashkët për hartimin e Konceptit aktual Strategjik dhe miratimin e tij në Samitin e Madridit, në qershor 2022, apo ndihma ushtarake në armatim dhe pajisje të dhuruara për Ukrainën, nga vendet anëtare për mbrojtjen e vendit të tyre.

#### **NATO pas Samitit të Madridit**

Koncepti i ri Strategjik i miratuar në Samitin e NATO-s të mbajtur, më 30 qershor 2022, nën dritën e agresionit rus ndaj Ukrainës, riktheu në qendër të vëmendjes mbrojtjen kolektive të aleancës nga kërcënimet konvencionale dhe asimetrike. Vendet aleate arritën në konkluzionin se aleanca gjendet përballë kërcënimeve konkrete konvencionale dhe sfidave komplekse të përfaqësuar nga regjime autoritare dhe agresive që shpërfillin rregullat ndërkombëtare, nga terrorizmi, kërcënimet kibernetike e deri ato raketore, si dhe sfida që vijnë nga ndryshimet klimaterike apo teknologjitë destruktive. Ky koncept përkufizoi për herë të parë Rusinë si kërcënimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë ndaj paqes dhe stabilitetit në zonën euro-atlantike dhe terrorizmin si

kërcënimin asimetrik më të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë së popullsisë së vendeve aleate. Në përgjigje të këtyre kërcënimeve Aleanca ka ndërmarrë një proces transformimi dhe adaptimi ndër më të mëdhatë në historinë e saj, duke rritur investimet në fushën e mbrojtjes, modernizuar kapacitetet dhe investuar në rritjen e gatishmërisë së forcave. Në takimin e majit 2022 të Komitetit Ushtarak në nivel të shefave të Shtabeve, kryetari i Komitetit Ushtarak, admiral Rob Bauer do të deklaronte se: "Pa asnjë dyshim një erë e re për NATO-n ka filluar". Nën këtë objektiv politik Aleanca ka miratuar dhe po vijon punën për implementimin paralel të dy koncepteve të mirëfillta ushtarake; konceptin për Shkurajimin dhe Mbrojtjen (ang. Deterrence and Defence) dhe Konceptin Themelor të Luftimit (ang. Warfighting Capstone Concept). Koncepti i parë fokusohet në krijimin, vendosjen dhe dislokimin e forcave për parandalim dhe mbrojtje, ndërsa koncepti i dytë në mënyrën e luftimit në teatrin e ardhshëm të zhvillimit të operacioneve, që është dinamik, shumë-dimensional, me përfshirjen jo vetëm të tre llojeve tradicionale të forcave tokë, det, ajër, por edhe dimensionin hapësirë (ang. space) dhe kibernetikë (ang. cyber), të përcaktuar tashmë e doktrinalizuar si fusha operacionale ushtarake. Në terma kohorë koncepti i parë përfshin masat dhe aktivitetet që duhet të zbatohen së shpejti, ndërsa koncepti i dytë për ato që do të zhvillohen në të ardhmen. Koncepti i Shkurajimit dhe Mbrojtjes përfaqëson një nivel tjetër më të lartë angazhimi, integrimi dhe koordinimi të aktiviteteve të aleancës euroatlantike. Ai merr në konsideratë të gjithë rajonet gjeografike dhe përfshin të gjithë llojet e forcave (tokë, det, ajër) dhe fushave të reja operacionale (hapësirë dhe kibernetikë). Qëllimi është hartimi dhe vënia në jetë e masave që monitorojnë në 360 gradë kërcënimet dhe rreziqet, fuqizojnë prezencën në gjithë hapësirën euroatlantike, rrisin gatishmërinë e forcave dhe lëvizshmërinë e tyre për përballimin e kërcënimeve kudo ku ato shfaqen dhe në kohën më të shkurtër. Synimi përfundimtar i këtij koncepti është që të sigurojë se NATO qëndron e fortë, qytetarët të qetë, vlerat demokratike të siguruar. Një aspekt i rëndësishëm i konceptit të shkurajimit dhe mbrojtjes është qëndrueshmëria kombëtare (ang. resilience). Ajo që më fjalë të tjera mund të përkufizohet si vijueshmëria dhe siguri i shërbimeve kritike për qeverisjen dhe popullsinë në kohë krize dhe lufte. Sigurimi i qëndrueshmërisë kombëtare bazohet tek Artikulli 3 i Traktatit të Atlantikut dhe shkon përtej Forcave të Armatosura dhe detyrave të Ministrisë së Mbrojtjes, ajo parashikon detyra dhe përgjegjësi për Ministri dhe Agjenci të tjera qeveritare, që kanë fushë të përgjegjësisë së tyre energjinë dhe rrugët e furnizimit të saj,



sistemet e komunikacionit dhe transportin civil, burimet e ujit dhe ushqimit dhe çdo infrastrukturë tjetër me rëndësi kritike në interes të qëndrueshmërisë kombëtare. Qëndrueshmëria kombëtare i adresohet edhe masave që duhen marrë ndaj një sërë aktivitetesh si mbrojtja nga sulmet kibernetike, incidentet teknologjike, terrorizmi, apo edhe dhe pandemitë dhe ngjarjet ekstreme klimaterike. Koncepti i ri Themelor i Luftimit synon përfshirjen e teknologjisë në zhvillimin e ardhshëm të operacioneve luftarake. Një prej aspekteve të rëndësishme të saj është transformimi digjital i Aleancës për të mundësuar më mirë njohjen e situatës dhe mjedisit në tërësi, për të përshpejtuar paralajmërimin e hershëm, shkëmbyer të dhënave, përshpejtuar procesin e vendim-marrjes dhe mbështetur më mirë operacionet e shumëllojshme (ang. multidomain operations).

Mesazhi është i qartë: NATO është një aleancë mbrojtëse, por nëpërmjet implementimit të konceptit të Shkurajimit dhe Mbrojtjes dhe konceptit Themelor të Luftimit po transformohet dhe fuqizohet me qëllimin e vetëm se kushdo që kërkon të shkaktojë dëme ndaj vendeve anëtare do të përballet me unitetin kolektiv dhe vullnetin e palëkundur ushtarak për të mbrojtur njeri-tjetrin.

#### **Shqipëria, roli dhe detyrat e saj në procesin e transformimit të NATO-s**

Vendi ynë, në nivel politik dhe ushtarak ka mbështetur transformimin e Aleancës, si dhe ka kontribuuar dhe mbështetur punën që po bëhet për materializimin e dy koncepteve Ushtarake, atij të Shkurajimit dhe Mbrojtjes dhe Konceptin Themelor të Luftimit. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së mbështesin një NATO më dinamike, afër vendeve aleate dhe e harmonizuar me to, duke mbështetur përf forcimin e aleancës, rritjen e lëvizshmërisë dhe mbështetjen logjistike, fuqizimin e gatishmërisë së forcave, qasjen 360 % në monitorimin e kërcënimeve dhe reagimit ndaj sfidave që vijnë nga të gjitha rajonet gjeografike, dhe në të gjitha fushat operacionale (tokë, ajër, det, hapësirë dhe kibernetikë). Shqipëria ka qenë qysh në fillim jo vetëm mbështetëse por edhe kontribuuese me trupa në Prezencën e Përparuar të NATO-s, për fuqizimin e krahut lindor të NATO-s, në Letoni, në vitin 2014, ndërkohë që ka mbështetur masat e përf forcimit të mëtejshëm duke kontribuar gjatë këtij viti (2022) në Prezencën e Përparuar të NATO-s në Bullgari, në kuadër të vendimeve të reja të Aleancës për përf forcimin e kufijve juglindorë të saj, pjesë e qasjes së re të trajtuar më sipër të shkurajimit dhe mbrojtjes.

Vendi ynë ka përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga plotësimi me burime njerëzore të strukturës së komandës dhe strukturës së forcës së NATO-s, në një kohë që jep një kontribut të rëndësishëm në operacionet e drejtuara nga NATO por edhe BE, të tilla si KFOR në Kosovë, NMI në Irak dhe ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë, kontribut që tashmë vijon prej vitesh, dhe që ka ardhur duke u shtuar vazhdimisht.

Forcat tona të Armatosura janë në koherencë të plotë me masat dhe aktivitetet që NATO ka kryer dhe po ndërmerr në këtë kuadër. FA-të shqiptare përmbyllën me sukses certifikimin sipas standardeve të kërkuara të grup-batalionit të deklaruar

**“**  
**NATO është një organizatë e gjallë, me diskutime e konsultime që shpesh janë të gjata deri në arritjen e konsensusit. Por diskutimet dhe konsultimet për të sheshuar diferencat në qëndrime dhe për të gjetur një platformë apo rrugë të përbashkët për të ecur përpara, janë një kualitet dhe veçori dalluese për Aleancën.**

në NATO, dhe po vijojnë me ritmet e kërkuara procesin e modernizimit dhe fuqizimit të kapaciteteve ushtarake, ndërkohë që i qëndrojnë me besnikëri vendimit politik për rritjen e buxhetit të mbrojtjes deri në 2% të PPB deri në vitin 2024. Transformimi dhe përshtatja e FARSH-së, ashtu si e të gjithë forcave të armatosura të vendeve aleate, është një proces i pandërprerë dhe i vijueshëm. FARSH-të duhet të vijojnë punën për zhvillimin e një Force të Armatosur më të mbështetur, më të modernizuar, më të gatshme dhe reaguese, dhe më të ndërlidhur dhe koordinuar me forcat aleate. Ne duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje masave që fuqizojnë qëndrueshmërinë kombëtare, mbrojtjes së infrastrukturës kritike, koordinimit ndërinstitucional me agjencitë dhe strukturat që kanë për detyrë sigurimin e vijueshmërisë së shërbimeve kritike për qeverisjen dhe popullsinë në rast krize dhe lufte. NATO është sot në paqe, por hapësira euroatlantike nuk është në paqe. Në kufijtë lindorë të saj po zhvillohet luftë. Vendet anëtare po ndeshen me sfida sigurie dhe problematika të karakterit ekonomik dhe politik që kjo luftë ka imponuar. Disa vende, përfshirë vendin tonë, kanë pësuar sulme kibernetike në shkallë të gjerë dhe ndeshen ditaditës me kërcënimin e përdorimit të tyre edhe në të ardhmen, me qëllimin e vetëm për të sjellë destabilitet dhe paqëndrueshmëri sociale dhe politike. Shqipëria është pjesë e familjes së madhe euroatlantike dhe gëzon përfitimet që sjell qenia nën këtë ombrellë sigurie, por në të njëjtën kohë duhet të vijojë të investojë në mbrojtje dhe siguri me qëllim garantimin e mëtejshëm të sigurisë kombëtare dhe asaj euroatlantike. Të investojmë në mbrojtje dhe siguri sot, që të përballojmë sfidat e sigurisë kolektive nesër. Kjo është sot moto e të qenit në NATO.







**Gjithçka është armë  
dhe fushëbeteja  
është kudo**

Kolonel  
HYSNI GJERGJI  
IKSHU/AFA





“**G**jithçka po përdoret si një armë dhe kudo është fushëbetejë”, mund të jetë përkufizimi më i saktë i këtij agresioni ku çdo mjet civil është kthyer në mjet lufte, dhe çdo aspekt i jetës politike, sociale, private, ekonomike etj., është

fushëbetejë. Fusha e betejës së Moskës është shtrirë në çdo shtet perëndimor dhe në çdo domain të luftës, ndërsa armët që po përdoren janë thjesht “gjithçka”. Nuk ka kufizim për zbatim të konventave, në mbrojtjen e civilëve, spitaleve, linjave të komunikimit, furnizimit me ushqim, ekosistemin etj. E fundit që përdori avionët civilë të transportit me pasagjerë si bomba konvencionale është “Al Qaeda”, më 11 shtator 2001, për të goditur SHBA-të.

“Kutia e mjeteve të luftës” në dispozicion të Putin, është e ekspozuar tashmë dhe brenda saj gjejmë: armët politike, diplomatike, ekonomike, financiare, sekrete, zbatimin e ligjit, infrastrukturës kritike etj. Të gjithë instrumentet e fuqisë kombëtare (DIMEFIL) janë vënë në dispozicion të luftës, për arritjen e objektivave strategjikë të Kremlinit.

Ky është “stili i ri i luftës” së fuqive totalitare, të cilat i kryeson Rusia dhe ndiqen nga Irani dhe Koreja e Veriut. Këta shtete synojnë të rrisin statusin e tyre në skenën botërore, pasi nuk mund ta fitojnë vetëm me një përbalje konvencionale. Të bindur se kanë

kërcënim të njëjtë dhe fat të ngjashëm me njëri-tjetrin, Moska, Teherani dhe Peniani po bashkëpunojnë për të mbijetuar. Ndryshimi i sistemit politik është e vetmja frikë e tyre, ndërsa armët bërthamore janë e vetmja mburojë e tyre.

Shumë komponentë të luftës, Putin po i përdor sepse i mohon lehtësisht, siç janë operacionet e shërbimeve sekrete, forcave mercenare, sulmet kibernetike dhe financimi i mbështetësve në territorin armik, të cilat veprojnë pa flamur shtetëror ose me “false flag”. Lufta e “stilit të ri”, duke qenë se është “shumë komplekse” mund të zhvillohet edhe pa konflikte të mirëfillta me armë zjarri. Kjo po ndodh realisht sot, ku pothuaj çdo vend perëndimor është përfshirë në një ose disa dimensione të luftës “pa krisma”, të cilat nuk shihen por përjetohej me pasojat e saj.

“Bombat e pista” të ndaluara nga shumë konventa, kanë qenë armë të operacionit special rus. Në një video të postuar nga korrespondenti i CNN, Frederik Pleitgen, dhe të denoncuar nga ambasadorja ukrainase në OKB, Makarova, më 2 mars, shfaqen kamionë ushtarakë rusë që mbanin T0S-1 të montuara në shasinë e tankeve T-72, shërbejnë për të lëshuar raketa me koka luftarake termobarike dhe bombat me vakum. Nëse shpërthejnë në një vend të mbyllur, banesa apo strehime të civilëve, ato thithin oksigjenin dhe krijojnë një valë shpërthimi që shkatërron organet e brendshme të njeriut.

Moska po lufton gjithashtu me armët 3D (dimër, donacion, drithë) si dhe 3S (spionazh, subversion, sabotazh) kundër gjithë Europës. Shumë shtete të Europës edhe këtë dimër do të jetë nën “kërcënimin” e Rusisë sa i përket burimeve energjetike dhe ushqimore, të përdorura nga ajo si armë. Kjo situatë është e llogaritur shumë saktë që më parë, duke punuar me kujdes për ta futur Europën në kurth, lidhur me furnizimin me gaz dhe drithë. Këtë gjendje krize të shkaktuar nga vetë ata, Moska përpiqet ta “propagandojë” si pasojë të sanksioneve perëndimore. Operacione të tilla, sa ekonomike janë edhe psikologjike, sepse synojnë të krijojnë apo thellojnë hendekun dhe mosbesimin mes qytetarëve perëndimorë dhe qeverive të tyre. Krahas propagandës nacionaliste dhe patriotike, retorika ortodokse është një tjetër mjet, që Putini po përpiqet ta përdorë si “armë”. Ai është shfaqur në publik disa herë me Patriarkun Kirill, i cili lutet për jetën e ushtarëve rusë, sa herë që i përcjell në front për të luftuar kundër vëllezërve ortodoksë ukrainas?! Nacionalistët ortodoksë rusë po përhapin me qëllim parullën e një shenjtori ukrainas të shekullit XX që thotë: “Ashtu si zoti është i përbërë nga tre elementë, ati, biri dhe shpirti i shenjtë edhe Rusia, Bjellorusia dhe Ukraina përbëjnë Rusinë, e shenjtë dhe të pandashme”. Kontrolli, mbi famullitë ruse, i Putinit është i plotë, por e kundërta ndodh në mitropolitë e Ukrainës, Lituaniës dhe Letonisë, të cilat janë në vartësi të Kirill, por deklarohen kundër dhe dënojnë agresionin rus. Mercenarët e huaj dhe kriminelët ordinerë, po përdoren si armë e pamëshirshme, me qëllim për të maskuar, fshehur, zhdukur gjurmët dhe mohuar masakrat e ushtrisë ruse në Ukrainë. Udhëheqësi i grupit Wagner, Yevgeny Prigozhin, që është bashkëpunëtori i Putinit, raportohet nga radio “Europa e Lirë” se ka rekrutuar mijëra të burgosur rusë për luftën në Ukrainë. Dezertimet në masë e kanë detyruar Kremlinin që të shpallë mobilizim, i cili gjithnjë e më shumë po varet nga mercenarët dhe kriminelët ordinerë për

të mbushur organikat. Një nga drejtuesit e mobilizimit të Putinit për luftën në Ukrainë, u gjet i varur pranë shtëpisë së tij në qytetin e Partizansk, më 29 tetor. Sipas "Baikal 24" dhe "Amur Mash", oficeri 49-vjeçar është vetëvrarë, pasi nuk mundi të kryente detyrën. Më 5 nëntor, VOA raporton se Komanda ruse e operacionit ka krijuar njësi speciale, të cilat ndalojnë, arrestojnë dhe qëllojnë mbi dezertorët, pasi numri i atyre që ikin nga lufta sa vjen dhe shtohet.

MEDIA, si pushtet i 4-t, ka qenë gjithashtu një nga armët e fuqishme ruse, e cila në ditët e para të agresionit ka përcjellë dezinformacionin dhe propagandën e Kremlinit, në Rusi dhe në botë. Kjo ishte arsyeja që i ka detyruar shumë vende perëndimore, përveç Serbisë të bllokojnë RT (Russia Today) si një altoparlant të propagandës ruse. Në Rusi është ndaluar me ligj informacioni për luftën, përveç atij që autorizon Ministria e Mbrojtjes. Duhet vlerësuar maksimalisht nga institucionet e sigurisë kombëtare dhe të pastrimit të parave, deklarata e ambasadores Jury Kim, më 29 shtator 2022, në "Tv Klan", se Rusia dhe Kina kanë blerë media dhe gazetarë, që propagandojnë politikat ruse dhe kineze në Shqipëri.

Si armë e dashur ruse, sabotimi në sistemet e infrastrukturës kritike të Europës, ka përfshirë shpërthime në tubacionet e gazit në Detin e Veriut dhe Baltik, prerje të fibrave optike nënujore si dhe ndërprerjen e menaxhimit të sistemeve kompjuterike të një qendre të shpërndarjes së ushqimit në Teksas. Shpërthimet dëmtuan dy tubacionet kryesore të gazit "Nord Stream" pranë ishullit Baltik të Bornholm, dhe janë përcaktuar nga NATO si një akt i pastër sabotimi rus. Ato janë shkaktuar nga minat me aktivizim me kohë, të shpërthyer nga distanca, ose nga një sulm i kryer nga skuadrat e specializuara nënujore të sabotazhit rus.

Desantët nënujorë janë një mjet luftarak që po përdoret nga inteligjenca dhe flota detare ruse. Rusia ka një komandë nëndetëse, të drejtuar nga Drejtoria kryesore e Kërkimeve në det të njohur si "GUGI", e pavarur por me lidhje të drejtpërdrejta me FSB-në. Komanda "GUGI" është e vendosur në gjirin Olenya në Arktik dhe është përgjegjëse për silurin bërthamor balistik të Rusisë "Poseidon", që mbartet nga nëndetësja Belograd. "GUGI" ka një anije të specializuar zbulimi të quajtur "Yantar" si dhe përdor dy nëndetëse, të cilat lëshojnë mini-nëndetëse për operacione vëzhgimi dhe sabotimi në thellësi të detit. Yantar raportohet të ketë qenë aktive në Kanalin Anglez, në ujërat ku kabllo me fibra optike dhe tubacionet transatlantike të gazit dalin në breg.

Bota u befasua në 2014 me aneksimin e Krimesë nga ekipet e "diversantëve të gjelbër", që ishin forca speciale nga toka. Kërcënimi tani është nga "diversantët blu", ose komandat sabotuese nënujore të "GUGI", një forcë shumë më shkatërruese dhe vdekjeprurëse se sa e para. Sabotazhi dhe spiunazhi rus, gjatë tetorit ka shqetësuar edhe qeverinë norvegjeze për rritjen e aktivitetit të tyre, duke përfshirë fluturimet me dronë zbulimi, rreth terminaleve norvegjeze të gazit, si dhe qendrave të komandimit operacional në Karste dhe Kolisnes. U raportua nga media gjithashtu për disa shtetas rusë të arrestuar nga autoritetet norvegjeze për spiunazh, më 28 tetor.

Më 25 tetor ndodhi sabotimi në dy pjesë të kabllove të komunikimit me fibra optike "Shefa-2" që bëjnë lidhjen midis Skocisë, Shetlandit, Danimarkës dhe Ishujve Faroe. Këto u konsideruan si aksidente "ndoshta nga një anije peshkimi" nga propaganda ruse. Por sa mundësi ka që një aksident të rezultojë në dy pika të veçanta në të njëjtën ditë; dhe pse një anije "kërkimi" ruse të ishte në të njëjtin territor detar atë ditë? Të gjitha argumentet, provat dhe analizat na çojnë tek sabotimi rus. Disa ditë pas ndërprerjeve të "Shefa-2", tre kabllo me fibra optike u prenë në Detin Mesdhe jashtë Marsejës, duke ndërprerë internetin në Europë, SHBA dhe Azi.


Spiunazhi dhe sabotazhi rus po dëmtton infrastrukturën kritike britanike pa qenë e nevojshme të përdoren armët e zjarrit. UK është shpallur armiku i dytë në radhë i Rusisë në Europë, pas Ukrainës. Interceptimi dhe hakerimi i celularit të kryeministres së UK-së, Liz Truss gjatë verës 2022, është kryer nga agjentë që punojnë për Kremlinin. Kjo është kambana e alarmit në të gjithë UK-në dhe Europën që tregon sa thellë kanë depërtuar agjentët rusë. "Informacioni i përgjuar në telefonin e shtëpisë së zonjës Truss, ka pasur të dhëna sensitive lidhur me luftën në Ukrainë dhe ky është interesi parësor për Moskën sot", - shkruan Jonathan Blake për BBC News, më 30 tetor. Sa i përket spiunazhit rus nuk ka përrjashim asnjë shtet i Europës, madje edhe Serbia në zbatim të parimit sovjetik: beso dhe kontrollo.

Më 3 tetor 2022, hakera rusë tentuan një sulm kibernetik ndaj MI5 (shërbimi i kundërzbulimit britanik), duke e çuar përkohësisht faqen e saj në vështirësi. Synimi i kësaj goditje është strategjik, shumë i guximshëm dhe tregon objektivin madhor të Moskës në drejtim të UK-së. Përmes të dhënave që synonin të "hakeronin" tek MI5, rusët kërkonin të mësojnë çfarë britanikët dinë për rusët dhe akoma më tej, të zbulojnë rrjetin e spiunëve britanikë që veprojnë në Rusi. Sulmi raportohet se nuk bëri dëm, por ishte një sinjal i qartë se "fushëbeteja e luftës është kudo" për Kremlinin.

Më 3 nëntor, Ministria e Jashtme ruse, ka thirrur ambasadorin britanik Deborah Bronnert dhe e ka akuzuar se pas një sulmi me dron ukrainas mbi flotën e Detit të Zi të Moskës në Krime, javën e kaluar, qëndron Mbretëria e Bashkuar. UK akuzohet se i ka dhënë mbështetje Kievit për të kryer sulmin. Ministria e Jashtme ruse i ankohet ambasadores dhe pretendon se i ka dhënë "fakte konkrete" të "provokimeve armiqësore" të Londrës. Rusët pretendojnë se britanikët po trajnojnë forcat speciale ukrainase në qytetin jugor të Ochakiv për "operacione sabotuese në det". Trajnimi konsiston në përgatitjen e "diversantëve nënujorë për operacione në ujërat e detit të Zi dhe Azov.

"Kutisë së mjeteve të luftës" hibride ruse, për herë të parë i shtohet edhe kërcënimi bërthamor, ose vdekje e sigurt e të dy palëve ndërluftuese, i pa artikuluar qysh në vitet 60-të. Kërcënimi synon nga njëra anë të frikësojë qeveritë perëndimore dhe nga ana tjetër të përçajë dhe manipulojë opinionin publik perëndimor, nga frika e sulmit bërthamor rus. Sir Jeremy Fleming, shefi i spiunazhit të Mbretërisë së Bashkuar, në "The Telegraph", më 12 shtator, tha se nuk kishte "asnjë garanci" që Perëndimi mund të parashikonte kohën për një sulm bërthamor rus. "Do të kemi një angazhim maksimal për ta zbuluar planin e Putin, por nuk ka kurrë asnjë garanci".





Më 17 tetor 2022, NATO filloi një stërvitje dyjavore në Europë, për të trajnuar ekuipazhet ajrore në përdorimin e bombave bërthamore jo strategjike të SHBA-së. Stërvitja është e përqendruar në bazën ajrore Kleine Brogel në Belgjikë, një nga gjashtë bazat ajrore në Europë, që mban bomba bërthamore të SHBA-së. Stërvitja “Stadfast Noon” është e përvitshme, por kjo e vitit 2022 është unike, pasi stërvitja do të zhvillohet gjatë luftës më të madhe konvencionale në Europë, që nga Lufta e Dytë Botërore me tension dhe pasiguri nga agresioni i Rusisë në Ukrainë. Për më tepër, stërvitja e planifikuar e NATO-s përkon me një stërvitje të madhe strategjike bërthamore ruse.

Për NATO-n kjo është stërvitje rutinë, ndërsa për publikun përendimor, është rritje e tensionit dhe e frikës për luftën bërthamore, por nga ana tjetër ofron siguri për aleatët ndaj çdo lloj “çmendurie” të Putinit nga ana tjetër. “Steadfast Noon” ka pjesëmarrës nga 14 vende dhe mbështetet me 60 avionë, F-16 dhe F-15E të gjeneratës së katërt, si dhe avionë luftarakë të gjeneratës së pestë F-35A dhe F-22. Marrin pjesë një numër avionësh cisterna të furnizimit në ajër, avionë zbulimi, si dhe bombardues strategjikë B-52. Stërvitjet ajrore do të zhvillohen mbi qiellin e Belgjikës, Mbretërisë së Bashkuar dhe mbi Detin e Veriut. Stoltenberg deklaroi se anulimi i stërvitjes i kërkuar nga Moska, do të dërgonte një “sinjal të gabuar” tek rusët.

“Sabotimi rus kundër shteteve anëtare të aleancës, është arsye për të nxitur Nenin 5 të NATO-s”, - paralajmëroi, më 10 tetor, Stoltenberg, pas dyshimeve se Moska vendosi eksplozivë në tubacionet nënujore të gazit. “Çdo sulm i qëllimshëm kundër infrastrukturës kritike të aleatëve do të përballlet me një përgjigje të përbashkët dhe të vendosur. Aleanca është thellësisht e shqetësuar nga shpërthimet nënujore të 26 shtatorit në tubacionet “Nord Stream”, që lidhin Rusinë dhe Gjermaninë dhe shtrihen në shtratin e Detit Baltik. NATO-s ka shtuar sigurinë rreth objektivave të mundshëm rusë,

si dhe ka dyfishuar praninë në Detin Baltik dhe të Veriut me mbi 30 anije, të mbështetura nga avionët e patrullimit si dhe kapacitete mbiujore dhe nënujore. Sulmet kibernetike dhe sabotimi janë të mjaftueshme për të aktivizuar klauzolën e mbrojtjes kolektive të Nenin 5, i cili është përdorur vetëm një herë, pas sulmeve të 11 shtatorit në SHBA. Kjo do të thotë se çdo anëtar i aleancës së 30 anëtarëve do ta konsideronte sabotimin një sulm ndaj tyre, duke iu referuar edhe Shqipërisë pas sulmit nga hakerat iranianë të “Homeland Justice”. NATO punon -do ditë për të përcaktuar saktësisht se deri ku shkon vija e kuqe për Nenin 5. Koncepti i ri Strategjik i NATO-s, i miratuar në Samitin e Madridit, në qershor, e bën të qartë se “Qëllimi i aftësisë bërthamore të NATO-s është ruajtja e paqes, parandalimi dhe pengimi i agresionit. Për sa kohë që ekzistojnë armët bërthamore, NATO do të mbetet një aleancë bërthamore.

Në kontekstin shqiptar, ne jemi realisht në një luftë të shpallur nga Rusia dhe Irani, të cilët janë aleatë edhe në agresionin kundër Ukrainës. Vetëm më 5 nëntor, Teherani detyrohet të pranojë se i ka shitur dronë “kamikazë” Rusisë, por para agresionit. Këta dy fuqi ushtarake dhe bërthamore nuk kanë reshtur dhe vazhdojnë të godasin infrastrukturën e sigurisë së RSH-së, me spiunazh sabotazh dhe sulme kibernetike. “Irani po kërkon ndihmën e Rusisë për të forcuar programin e tij bërthamor, vlerësojnë zyrtarët e inteligjencës amerikane”, - shkruan Natasha Bertrand në CNN, më 4 nëntor 2022. Janë sensitive dhe me pasoja të rënda të dhënat që publikon herë pas here nga organizata “Homeland Justice”, por më të rëndësishme, gjykoj se janë informacionet që iranianët kanë hakuar, ruajnë, përdorin, nuk i publikojnë, por i ndajnë me rusët. Është koha të pranojmë se jemi në luftë reale, të jemi vigjilentë, të stërvitemi dhe të shqetësohemi realisht.

# Institucionet e para TË USHTRISË SHQIPTARE

## Institucionet e Luftës dhe Shtabi Madhor

Ushtria Shqiptare dhe institucionet kryesore të saj e kanë zanafillën tek Pavarësia dhe Shteti i parë shqiptar. Ato kanë moshën e Qeverisë së parë dhe të ministrive përbërëse të saj. Institucionet lindën së bashku dhe vijnë deri tek ne pikërisht nga 4 dhjetori 1912, kur në Vlorë u shpall dhe u promovua Qeveria e Përkohshme, si e para qeveri e një shteti të pavarur dhe modern shqiptar.

Në vizionin dhe strategjinë fillestare të Qeverisë të Përkohshme, të sapoformuar të Vlorës një shqetësim i parë dhe i ngutshëm i saj ishte edhe "... ngritja dhe organizimi i një Force të Armatosur, e një ushtrie sado të vogël, për t'u mbrojtur nga sulmet e fqinjëve". Në atë kohë, në Vlorë guxohej të mendohej, madje, për të përzgjedhur modelin e sistemit më të përshtatshëm të organizimit ushtarak për territorin ku e shtrinte pushtetin Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Organizatorët ishin të bindur se më i përshtatshëm për kushtet e Shqipërisë së atëhershme ishte pikërisht modeli ushtarak austro-hungarez. Kjo ishte një dëshmi e fortë se Qeveria e Vlorës e kishte një vizion për krijimin dhe organizimin e një force ushtarake, për mbrojtjen e pavarësisë dhe të shtetit të vogël shqiptar.

Lindja e ushtrisë moderne shqiptare ishte e vështirë për shumë arsye. Rrethanat ishin të ndërlikuara, jo vetëm për mjedisin, por dhe hapësirën shqiptare. Në pikëpamje gjeopolitike dhe strategjike, territori shqiptar ishte shndërruar në një objektiv të lakmuar të Luftërave Ballkanike, të ndërmarra prej Koalicionit të shteteve

ballkanike kundër Turqisë dhe trupave ushtarake të saj, në tërë hapësirën ndër ballkanike, ku përfshihej edhe Shqipëria. Një ndër synimet kryesore të tyre, e ndërthurur me të parën, ishte shpëputja e pjesëve të territoreve shqiptare dhe tjetërsimi i tyre. Për këto shkaqe luftohej në trevat veriore dhe jugore të Shqipërisë, ndërsa në disa zona shqiptare shihej ende një prani e madhe e forcave të ushtrisë turke, ende pa u tërhequr së andejmi, duke e shtuar kaosin dhe anarkinë dhe duke e trazuar më tej rendin e qetësinë në vend. Po t'u shtohet këtyre rrethanave edhe gjendja tejet e vështirë ekonomike, financiare dhe ushtarake, si dhe pamundësia dhe brishtësia e shtetit dhe e Qeverisë së Përkohshme, të porsakrijtura, për t'i menaxhuar drejt dhe në kohë ato, kuptohet se situata ishte mjaft e vështirë dhe delikate.

Me gjithë këto, synimet dhe përzgjedhjet e mësipërme nuk mbetën vetëm ide. Përkundrazi, Qeveria e Vlorës ndërmoi hapa konkretë për t'i dhënë jetë projektit me vizionin dhe strategjinë e saj, sado e vagullt dhe e paplotësuar ishte ajo.

Në këto rrethana, kur po ngriheshin kumtet e institucioneve të shtetit të ri të pavarur shqiptar, i cili ende nuk e kishte marrë pëlqimin e shteteve të Fuqive të Mëdha të fillim shekullit XX, lindën edhe institucionet kryesore të Mbrojtjes. Pikërisht aty i pati fillimet edhe Ushtria dhe organizimi ushtarak shtetëror shqiptar që, këtë fillim dhjetori, mbushin plot njëqind e dhjetë vjet jetë!

Në përbërje të kabinetit të parë, një ndër ministrinë kryesore, u përfshi edhe Dikasteri i Luftës apo ndryshe i Mbrojtjes Kombëtare,

**Në vizionin dhe strategjinë fillestare të Qeverisë të Përkohshme, të sapoformuar të Vlorës një shqetësim i parë dhe ngutshëm i saj ishte edhe “... ngritja dhe organizimi i një Force të Armatosur, e një ushtrie sado të vogël, për t’u mbrojtur nga sulmet e fqinjëve”.**



**Qeveria e Përkohshme e Vlorës, me gjithë hallet dhe andrallat e shumta që kishte, më 4 maj 1913, mundësoi krijimin e aparatit të rëndësishëm për organizimin, stërvitjen dhe drejtimin e forcave ushtarake, Shtatit Madhner (Shtabit Madhor), me në krye një ushtarak tejet energjik dhe profesionist, majorin Ali Shefqeti (Shkupi).**



me në krye një oficer madhor karriere, me shumë përvojë drejtimi, organizimi dhe luftarake, gjeneral brigade Mehmet Dëralla (Tetova).

“Po ashtu, pak muaj më pas, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, me gjithë hallet dhe andrallat e shumta që kishte, më 4 maj 1913, mundësoi krijimin e aparatit të rëndësishëm për organizimin, stërvitjen dhe drejtimin e forcave ushtarake, Shtatit Madhner (Shtabit Madhor), me në krye një ushtarak tejet energjik dhe profesionist, majorin Ali Shefqeti (Shkupi). Vetëm një muaj më pas, ky shtab hartoi dhe dërgoi për miratim Rregulloren “Mbi organizimin e milicisë shqiptare”, që do të shihet dritën në Vlorë, më 3 qershor 1913. Përmes saj ligjërohej ngritja e një milicie ushtarake, përderisa të mundësohej organizimi i ushtrisë së rregullt shqiptare.

Këto institucione kishin përbërjen dhe rregulloret, me simbolet dhe vultat e tyre, njëlloj si tek ushtritë e rregullta të kohës, sepse oficerët ishin të karrierës dhe profesionistë. Ata ishin arsimuar dhe kualifikuar në shkollat dhe akademitë ushtarake të njohura të Turqisë, por edhe në ato perëndimore, ashtu si dhe nënoficerët,

të gjithë me origjinë shqiptare, të cilët kishin pranuar thirrjen dhe programin ushtarak të Qeverisë së Vlorës dhe ata kishin ofruar shërbimet e tyre atdhetare dhe profesionale ushtarake për shtetin dhe qeverinë e parë të pavarur dhe moderne shqiptare.

Njëherësh me to, kjo qeveri, në përpjekje për të jetësuar strategjinë e saj për mbrojtjen e shtetit dhe të pavarësisë së vendit, përmes institucioneve të Mbrojtjes, të ngritura rishtazi, menaxhoi së pari, një ndër asetet njerëzore të gatshme, siç ishin Forcat Vullnetare Popullore. Ato ishin armatosur dhe ngritur vetë, në mbështetje dhe në mbrojtje të Qeverisë dhe të Shtetit të pavarur shqiptar. Ndërkohë, nisi organizimi i Forcave Rezerviste dhe, krahas tyre, u planifikuan disa masa për të organizuar Forcat Aktive, të dizajnuara sipas formatit të kompanisë tip, të ashtuquajtur “Modele”. Kjo kompani, sipas Urdhërësës së Kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare, i cili, në qershor të vitit 1913, tërhoqte vëmendjen për të përshpejtuar procesin e krijimit të saj pasi ajo shihej, nga të gjitha pikëpamjet, si shëmbëlltyra, sipas së cilës do të modelohej dhe dizajnohej krejt Ushtria Kombëtare Shqiptare.







Liderët që shënjuan

**HISTORI**

në rrugëtimin shekullor të

**FORCAVE**

**TË ARMATOSURA**

---

# Mehmet pashë DËRALLA



## **Ministri i Parë i Luftës, gjeneral brigade Mehmet pashë Dëralla**

Mehmet Dëralla vinte nga familja shqiptare më tradita atdhetare e ushtarake e Hasan Dërallës, nga Gradeci i Tetovës, ku lindi, më 1843. Në Tetovë kreu arsimin fillor, kurse të mesmin në Shkup. Më tej studioi në Akademinë e Parë ushtarake turke të Stambollit, ku dhe u diplomua oficer me rezultate të shkëlqyera. Fillimisht shërbeu në një regjiment këmbësorie në Anadolu. Më pas shkoi për studime në Akademinë e Dytë ose në Shkollën e Lartë të Shtatmadhorisë. Në vitin 1878 arrin gradën "gjeneral brigade" dhe shërben për disa vite në vise të Perandorisë Turke. Më pas kryen detyrën e Komandantit të Vilajetit të Kosovës dhe më tej në Manastir dhe Shkup. Rrethin e lëvizjeve ushtarake e mbylli në Prizren, në postin e komandantit të Qarkut. Gjatë shërbimit në Kosovë, u njoh me udhëheqës të shquar atdhetarë shqiptarë dhe lidhet me lëvizjen për çështjen kombëtare shqiptare, që luftonte për pavarësinë e Shqipërisë. Përkrahu dhe mbështeti Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1879-1881), në organizimin e forcave ushtarake të saj, së bashku me të atin e tij, dhe kryente veprime luftarake kundër shovinizmit sllav. Zgjidhet Komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes për viset shqiptare në Maqedoni, ku lufton kundër forcave operationale osmane të drejtuara prej marshallit turk Dervish Pasha. Me shpërndarjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, merr pjesë në Kuvendin e Pejës (23-29 janar 1899), pas shtypjes së të cilit internohet në Bagdat.

Në vitet 1910-1912, së bashku me të birin, Halim Dëralla, merr pjesë në valën e kryengritjeve shqiptare, në Kosovë, përkrah me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Isa Buletinin, Idriz Seferin etj. I mbështetur fuqimisht edhe nga një plejadë prijësish shqiptarë, mes të cilëve edhe Elez Isufi e Ramadan Zaskoci, gjeneral Dëralla shkëlqen në disa beteja veçanërisht të repta e të njohura, si në Rrëshajë, Jenipazar, Kumanovë, Manastir, Drin, Jakovë etj. Në to, ushtria serbe pësoi humbje të shumta dhe u shpartallua keqas. Pas dështimit të lëvizjes Xhonturke, më 1908, përfitoi nga amnistia dhe kthehet përfundimisht në vendin e të parëve të tij, nga shkretëtirat e Irakut ku ishte internuar. Më 28 nëntor 1912, me shpalljen e Pavarësisë së

Shqipërisë dhe me krijimin e shtetit të parë shqiptar, caktohet Ministër i Luftës në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, të Ismail Qemalit, të dalë më 4 dhjetor të po këtij viti. Ai bëhet kështu, Ministri i Parë i Luftës (Mbrojtjes) në historinë e shtetit të parë shqiptar, duke kryer njëherësh edhe detyrën e Komandantit të Përgjithshëm. Në krye të këtij dikasteri të rëndësishëm, por të vështirë për kushtet e rënda politike, ekonomike, sociale dhe ushtarake që kaloi shteti i brishtë shqiptar, gjeneral Dëralla, i mbështetur nga një grup oficerësh atdhetarë të karrierës, të shkolluar e të përkushtuar, si Ali Shefqeti (Shkupi), Mustafa Aranitasi, Kasem Qafëzezi, Mustafa Maksuti (Shehu), Ali Tetova, Rexhep Shala, Ismail H. Tatazati etj., punuan mjaft të hidhni bazat e krijimit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Në këtë rrjedhë, u formua Shtabi Madhor me disa zyra përkatëse, dhe Xhandarmëria, Forcat Aktive të ushtrisë, me oficerë dhe nënoficerë shqiptarë që kishin qenë pjesë e Ushtrisë Turke, si dhe Forcat Rezervë dhe Vullnetare, me gjithsej afro 12 000 veta. Po kështu u miratuan disa rregullore të nevojshme për jetën e një ushtrie. Ndërkohë forca të kësaj ushtrie morën pjesë në luftën për mbrojtjen e trojeve jugore dhe veriore të vendit nga shovinistët antishqiptarë.

Shteti shqiptar kishte nevojë të domosdoshme ngritjen dhe mbajtjen e kësaj fuqie të armatosur, me gjithë përmasat dhe kufizimet e shpjegueshme që ajo shfaqte. Pas janarit 1914, kur qeveria e Ismail Qemalit dha dorëheqjen, Dëralla iu kushtua bashkimit dhe pajtimit të shqiptarëve, që ishte kryefjala e gjeneralit të shquar. Ndërkohë ai u vu në ballë të qëndresës kundër shovinistëve serbë. Prandaj më 1916, u kap dhe u burgos prej tyre në Podgoricë. Pas lirimt ai u kthye në qytetin e Shkodrës.

Gjeneral Dëralla vdiq i helmuar, më 1918, në moshën 75-vjeçare, sapo Lufta e Parë Botërore ishte mbyllur. Ai nuk hyri në histori vetëm sepse ishte Ministër i Parë i Mbrojtjes në shtetin e parë të pavarur shqiptar, por sepse ishte një nga ata oficerë atdhetarë shqiptarë, që hodhi bazat e institucionit të Mbrojtjes dhe të Ushtrisë Shqiptare. Me atdhetarinë, përkushtimin, korrektesën, idetë dhe aftësitë organizative dhe drejtuese që zotëronte, me dimensionet historike u bë shembull i përhershëm për gjeneralitetin dhe korpusin e oficerëve shqiptarë të të gjitha kohërave pasuan.



## Esad pashë TOPTANI

U lind në Tiranë, më 1863. Mbaroi Akademinë Ushtarake të Stambollit. Më 1914 kryesoi delegacionin shqiptar që i dorëzoi kurorën e fronit shqiptar Princ Vidit. Më 1914 u emërua ministër i Punëve të Brendshme dhe i Luftës. Në Durrës iu organizua një komplot nga oficerët holandezë, këshilltarët austro-hungarezë dhe disa bejlerë me mbështetjen e Vidit. Me ndërhyrjen e Italisë, u largua pa u burgosur.

Mungesa e qeverisjes pas revoltës së Shqipërisë së Mesme dhe nisjes së Luftës së Parë Botërore i dha një mundësi të fundit Esad pashës, i cili ishte jashtë Shqipërisë, që të kthehej. Shpalli shpërndarjen e organeve revolucionare dhe emëroi prefektët e rinj të vendit. Më 21 tetor 1914 ndërmori reformën e parë agrare në vend, kur nxori urdhrin që t'u konfiskohej toka 50 personave nga oxhaqet bejlerë dhe kundërshtarët e tij politikë nga Vlorajt, Toptanajt, Biçakçinjtë (përfshijto Dervish beun), Vrionasit dhe Cakraniotët. Ky urdhër, për shkak të rrethanave të kohës, nuk gjeti zbatim. I dha rëndësi gjendjes së pushimit grek në jug të vendit, kërkoi rihartimin e regjistrave kadastralë të qyteteve ku u dogjën nga revolta e Shqipërisë së Mesme.

## Jusuf DIBRA

Ishte një politikan shqiptar, i cili shërbeu si ministër Luftë në Qeverinë e Esat pashë Toptanit (5 tetor 1914 – 27 janar 1916).

Isuf Dibra ka lindur në fshatin Dohoshisht, Dibër. Ai ndoqi shkollën fillore "Ru diye" në Manastir. Si udhëheqës i një force guerile prej rreth 5 000 mercenarësh, ai ndihmoi Esad Toptanin të merrte pushtetin, në vjeshtën e vitit 1914. Për përpjekjet e tij, në formën e mirënjohjes, Esad Pasha e emëroi ministër të Luftës në kabinetin e tij të sapoformuar. Dibra u emërua si anëtar i pazgjedhur i senatit në Asamblenë Kushtetuese, më 18 dhjetor 1926. Një vit më pas, më 19 mars 1927, u vra në Tiranë nga ndihmësi i tij, në rrethana të panjohura.

## Kara Seit PASHA

Kara Seit Pasha ishte një oficer ushtarak osman që shërbeu si ministër i Luftës në Qeverinë Përmeti II, e njohur më mirë si Qeveria e Durrësit. Ai mendohet të ketë pasur një karrierë të gjatë ushtarake, duke shërbyer në Perandorinë Osmane. Gjatë ditëve të para të lëvizjes për Pavarësi të Shqipërisë, ai shërbeu si komandant divizioni në Selanik dhe në zona të territorit që më vonë do të bëhej Shqipëria e Jugut. Seit Pasha hyri në kabinetin e Turhan Pashë Përmetit në gusht të vitit 1914 dhe shërbeu për një kohë të shkurtër deri më 3 shtator. Më vonë po atë vit u transferua në Shkodër. Emri i tij përmendet si kandidat për ministër në ngjarjet që i paraprinë Kongresit Kombëtar të Elbasanit në vitin 1916.

## Isuf GJINALI

Isuf Gjinali (Tiranë, 1874 - 30 tetor, 1930) ka qenë ushtarak i Perandorisë Osmane dhe i shtetit shqiptar, më tej ministër i Luftës gjatë qeverisë së Pandeli Vangjelit (16 tetor - 6 dhjetor 1921).





## Selahudin SHKOZA

Ka qenë ushtarak i Perandorisë Osmane dhe më pas i shtetit shqiptar, u bë ministër i luftës gjatë qeverisë së Iljaz Vrionit (15 nëntor 1920 – 1 korrik 1921). Është ideatori dhe organizatori reformues i mirëfilltë i Ushtrisë Kombëtare gjatë kohës që ishte ministër i Luftës.

U lind në Shkozë, afër Zhurit, në një familje lumjane. Kreu Gjimnazin Ushtarak të Manastirit, më 1886, pastaj Akademinë e Artilerisë në Stamboll. Më pas, për disa vite, vazhdon shkollimin ushtarak për shtabe e kalorësi, po në kryeqytetin osman. Kështu, në përfundim u diplomua si akademik për Këmbësori, Artileri dhe Kalorësi. Në ndihmë të aftësisht profesional të tij, është dhe fakti i zotërimit perfekt të disa gjuhëve të huaja, si turqisht, arabisht, frëngjisht, gjermanisht etj. Në janar 1921, ai pranoi detyrën e ministrit të Luftës, në përbërje të qeverisë së Iljas bej Vrionit. Vlerësimi zyrtar i kohës është se, nga burra shteti si Shkoza, e ka zanafillën baza e një ushtrie të rregullt. “Ky qe një fat i posaçëm që menjëherë, në fillim, një burrë aq i vlefshëm si Selahudin Shkoza mori përsipër Ministrinë e Luftës. Ai krijoi themelet e ushtrisë së atëhershme”.



## Ali Riza KOLONJA

Ali Riza Kolonja (1880-1930) ishte ushtarak i lartë, diplomat, ministër dhe politikan shqiptar. Ishte një ndër gjeneralët dhe organizatorët e parë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare që u themelua nga qeveria e Vlorës. Ministër i Luftës në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës. Ali Riza Kolonja ishte përfaqësues i palës shqiptare në Komisionin Ndërkombëtar të Kufijve të Shqipërisë (1921-1925). Ai ka luajtur një rol të veçantë për organizimin dhe modernizimin e ushtrisë shqiptare.



## Shefki KOSTURI

Shefki Kosturi ka qenë ushtarak i Perandorisë Osmane dhe i shtetit shqiptar, më tej ministër i Luftës në qeverinë e Idhomeno Kosturit (12-24 dhjetor 1921).



## Zija DIBRA

Zija Dibra (Dibër, 1890 - Harizaj, 20 janar 1925).

Kreu shkollën ushtarake në Stamboll, pati karrierë si ushtarak i lartë në ushtrinë osmane. Kthehet në Shqipëri, më 28 mars 1921, ku emërohet ministër i Punëve Botore në qeverinë Evangjeli. Qe ndër ministrat që provokuan krizën e dhjetorit për rrëzimin e kësaj qeverie.

Spikati si njëri prej organizatorëve të kryengritjes së marsit 1922, më 5 prill 1922 dënohet me vdekje në mungesë. Sipas një marrëveshjeje, u ra dakord të lihej të dilte nga Shqipëria. Më 1923 gjendet në Vienë me Hasan Prishtinën dhe Irfan Ohrin, ku qe bërë pjesë e një organizate antizogiste të themeluar nga Aqif pashë Elbasani.

Mbi bazën e një ujdie të bërë, lejohet të kthehet në Shqipëri. Falet më 2 qershor 1924 nga Kuvendi Kushtetues, kthehet në qershor të 1924. Përkrahu Lëvizjen e qershorit dhe qeverinë Noli të dalë pas saj.



## Ismail Haki TATZATI

Ismail Haki Tatzati, ministër i Luftës në Qeverinë e Xhafer Ypit (24 dhjetor 1921 – 2 dhjetor 1922).

U lind më 1878, në Delvinë. Më 1894-1897 ndoqi gjimnazin e Manastirit, më 1897-1900 ndoqi dhe përfundoi Akademinë Ushtarake të Stambollit. Më 1900-1905 shërbeu si oficer në Seres në Vilajetin e Selanikut dhe më tej, deri më 1906, shkoi me shërbim në Stamboll. Nga viti 1906-1908 shërbeu në Gjirokastrë, më pas deri në vitin 1913 në Elbasan, ku fitoi gradën e “majorit”. Më 1913 drejtoi një batalion xhandarmërie po në Elbasan, ku u burgos dhe më pas u lirua nga kryengritësit e Shqipërisë së Mesme, më 14 maj. Me xhandarmërinë e organizuar nga misioni holandez, u caktua me Mustafa Aranitasin të komandonin batalionet e Korçës dhe Gjirokastrës. Gjatë luftimeve me forcat greke, Tatzati e bëri Hoçishtin qendër veprimi. Në vitin 1916-1918 ka qenë nënprefekt në zonën e pushtim-administrimit austro-hungarez. Gjysmën e parë të vitit 1920 ka qenë komandant i xhandarmërisë i qarkut të Gjirokastrës.



## Mustafa ARANITASI

U lind më 12 prill 1872, në Aranitas të kazasë së Mallakastrës. Ndoqi Akademinë Ushtarake në Stamboll. Në korrik 1913, duke pasur gradën e “majorit”, ishte njëri nga 4 komandantët e detashmenteve të vendit që u formuan nga oficerët holandezë gjatë kohës së ministrit Mehmet pashë Dëralla. Së bashku me major Ismail Haki Tatzatin u caktua në krye të batalioneve të Korçës e Gjirokastrës. Më 1915 shërbeu si komandant i xhandarmërisë në Mirditë, më 1916-1918 komandant batalioni me forcat austro-hungareze. Më 1919-1920, komandant batalioni në Elbasan.

Më 1920-1922 ka qenë komandant i regjimentit të dytë me qendër në Tiranë. Më 1922-1923 qe kryetar i Gjykatës Ushtarake me gradën e “kolonelit”, më 19 gusht zëvendësoi Tatzatin në postin e ministrit të Luftës në qeverinë Zogu.



## Kasem QAFËZEZI

Kasem Qafëzezi (Qafëzez, 1881 - Berat, 29 shtator 1931), qe ushtarak i Perandorisë Osmane dhe i shtetit shqiptar, luftëtar i andarteve greke në jug dhe ministër i Luftës në qeverinë e Fan Nolit (16 qershor-24 dhjetor 1924).



## Enver HOXHA

Enver Hoxha, i lindur në Gjirokastër më 1908, ai punoi fillimisht si mësues, por pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste ai vijoi punën në arsim deri kur u punësua në fabrikën dhe shitoren "Flora" të Ibrahim bej Biçakçiu. U bë anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë pas formimit të saj, më 1941, kurse më 1943 u zgjodh sekretar i parë i saj, me përkrahjen e emisarëve jugosllavë nën drejtimin e të cilëve u themelua partia, Miladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha. 41 vitet e drejtimit të tij, në krye të shtetit shqiptar, ndahen në dy periudha: e para (1944-1976), e karakterizuar me aleanca të përkohshme me fuqitë e kampit socialist - Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën - dhe e dyta (1977-1985), e shënjuar nga izolacionizmi, antirevizionizmi dhe ndjekja dogmatike e marksizëm-leninizmit. I spikatur ishte kulti i individit me të në qendër, i gjithëpranishëm nëpër pankarta e postera, këngë e parulla "Populli - Partia - Enveri", të shkruara edhe anës maleve. Edhe pas vdekjes, kulti i tij u nderua përmes shtatoreve të mëdha në gati çdo qytet të Shqipërisë, kryesuar nga ajo në qendër të Tiranës si dhe ndërtime të një muzeumi kushtuar atij, po në kryeqytetin shqiptar.



## Beqir BALLUKU

Beqir Balluku lindi në Tiranë, ndoqi pak vite Shkollën Teknikë të Tiranës, pa mundur ta përfundonte.

Më 1943 qe anëtar i Partisë Komuniste dhe anëtar i Komitetit Qendror i PK-së. U arrestua më 1943 për pak muaj dhe, më 20 maj 1943, u caktua komandant i batalionit partizan Krujë-Ishëm. Më 18 shtator 1943 ishte komisar i Brigadës së 3-të dhe më pas komandant i Brigadës së 2-të. Më 1944 ka qenë komandant i shtabit operativ të brigadave 2, 9 dhe 20. Më 1945 qe anëtar i Gjyqit Special. Më 1945 - 1948 qe zëvendës komandant i korpusit të parë, komisar i korpusit të dytë dhe komisar i komandave të prapavijës në komandën e përgjithshme dhe komandant divizioni.

Më 28 janar 1948, ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë deri më 1950. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake "Voroshilov". Në kongresin e parë të PKSH së u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe në vitin 1953 nga zëvendësministër u bë ministër i Mbrojtjes Popullore, post që e pati deri më 1974. Një vit më pas mori gradën më të lartë në Shqipëri, atë të "gjenerallejtënant". Nga viti 1946 Balluku ishte gjithmonë deputet i Kuvendit Popullor dhe nga viti 1954 deri më 1974-ën ishte zëvendëskryeministër. Më 1960 u emërua kryetar i komisionit qendror të internim-dëbimeve pranë Kryeministrisë. Në korrik të vitit 1974 u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake, arrestohet më 16 dhjetor 1974 dhe dënohet me vdekje për "tradhti ndaj atdheut.





## Mehmet SHEHU

Mehmet Shehu, u lind më 10 janar të vitit 1913 në fshatin Çorrush. Nis Shkollën Teknike në Tiranë, të cilën e kreu në vitin 1932. U regjistrua në Shkollën e Oficerëve në kryeqytet, por nuk u pranua për shkak të moshës. Më 1934 i mundësohet një bursë ushtarake për në Kolegjin e Napolit. Kthehet në atdhe dhe për shkaqe kundërshtie ndaj regjimit të Zogut, burgoset 2-3 muaj në Tiranë. Ndjek Shkollën e Plotësimit të Oficerëve, ku titullohet në vitin 1937.

Në dhjetor 1937 shkon në Spanjë përmes Francës me ndërlidhje nga Llazar Fundo, ku merr pjesë në brigadën e XII ndërkombëtare e quajtur "Garibaldi" në nder të heroit italian, e cila ishte e përbërë nga vullnetarë nga shumë vende të botës, ai komandonte batalionin e IV të saj.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka kryer një numër detyrash: shkurt 1943, komandant i Çetës Plakë të Mallakastrës; mars 1943, kandidat i K.Q; gusht 1943, komandant i Brigadës I Sulmuese, maj 1944, zëvendës komandant i Divizionit I Sulmues, me gradën e "kolonelit"; gusht 1944, komandant i Divizionit I Sulmues; në tetor 1944 i jepet grada "gjeneralmajor".

Mbas çlirimit të Shqipërisë dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Në periudhën 1945-1946 studion në Akademinë Ushtarake "Voroshilov" në Moskë. Mbas përfundimit të studimeve kthehet në Shqipëri, ku në vitin 1947 emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm. Në periudhën 1948-1954 kryen njëkohësisht detyrën e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të Punëve të Brendshme. Nga viti 1954 deri në vitin 1981 ishte Kryeministër (Kryetari i Qeverisë). Ishte ndër të vetmit nxënës prej atyre që kishin qenë në Shkollën Teknike të Fultz-it që nuk ishte ekzekutuar.

Që nga viti 1948 deri më 1981-shin ishte anëtar i Byrosë Politike. Fliste 5 gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe rusisht. Versioni zyrtar i kohës tregon se kreu vetëvrasje në Tiranë, më 18 dhjetor 1981.



## Kadri HAZBIU

Kadri Hazbiu, ishte djali i Hazbi Cano Dautaj, njërit prej komandantëve të Luftës së Vlorës, më 1920.

Më 1936 nisi Shkollën Tregtare të Vlorës, prej të cilës u përjashtua më 1941. Në shtator 1942 - qershor 1943 lëviz me punë në Drashovicë, si i ngarkuar me punë partie dhe me përgjegjësi ushtarake. Në qershor-tetor 1943 ishte komisar i çetës "Halim Xhelo", në tetor 1943 e deri në janar 1944 vazhdon si komisar i batalionit "Ismail Qemali". Në janar-nëntor 1944, komisar e më pas zëvendës komisar batalioni në brigadën e 5-të. Në nëntor-dhjetor 1944, zëvendës komisar në brigadën e 5-të. Në dhjetor 1944 - shtator 1947 është kryetar i DSU (Degës të Sigurimit të Ushtrisë) në Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit. Në shtator 1947 - prill 1948 ndjek Shkollën e Lartë të Sigurimit në Moskë.

Më 1948-1949, kryetar i degës së 5-të të Sigurimit të Shtetit. Më 1949-1954, ndihmësministër i Punëve të Brendshme dhe drejtori kryesor i Sigurimit të Shtetit. Në përfundim të skemës ekzekutive të vitit 1954, kur Mehmet Shehu zuri vendin e Hoxhës si kryeministër, Kadri Hazbiu e pa veten në postin e lartë të ministrit. Kësisoj, më 1954-1980 ai ishte ministër i Punëve të Brendshme, duke thyer çdo rekord jetëgjatësie. Më 1980-1982, ministër i Mbrojtjes Popullore. Më 1952-1982, anëtar i KQ të PPSH-së. Më 1961-1971, kandidat i Byrosë Politike të Komitetit Qendror. Më 1971-1982 anëtar i Byrosë Politike. Më 1950-1982 ishte deputet i Kuvendit Popullor. U akuzua për faje të bëra vite më parë, në kohën kur marrëdhëniet me sovjetikët ishin të mira dhe e tillë ishte edhe politika e Partisë së Punës.

Më 15 tetor 1982 arrestohet, më 10 shtator 1983 ekzekutohet, pasi u dënua për tradhti të lartë ndaj atdheut si "armik i popullit dhe i Partisë".



## Prokop MURRA

Prokop Murra, u lind më 24 nëntor 1921 në Tiranë. Kreu studimet e larta për ekonomi dhe luftoi në Luftën e Dytë Botërore si partizan i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare.

Në 1943 iu bashkua Partisë Komuniste Shqiptare, si funksionar i sektorit ekonomik dhe industrisë së petrolit dhe më 1956 u bë anëtar i Komitetit Qendror të Partisë. 6 vite më vonë, më 1962-shin, u zgjodh për herë të parë si përfaqësues në Kuvendin Popullor, pjesë e të cilit mbeti deri në fund të legjislaturës së pestë më 1966. Në vitet '70 kreu përkohësisht funksionin e Sekretarit të parë të Partisë së Punës në Shkodër. Gjithashtu, u emërua zëvendës kryetar i Komisionit të Planifikimit Shtetëror, pozicion të cilin e mbajti përkohësisht nga 1980 deri në 1981. Në nëntor 1976, gjatë Kongresit të Shtatë të Partisë, u zgjodh anëtar i Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë, pozicion të cilin e mbajti deri më prill të 1980-ës. Më 26 prill 1980, ai u emërua ministër i Industrisë dhe Minierave. U emërua ministër i Energjisë i qeverisë së Adil Çarçanit deri më 1 korrik 1982. Më 23 nëntor 1982 u caktua ministër i Mbrojtjes Popullore. Emërimi i tij ishte i papritur për shkak se, nga krijimi i Republikës Popullore të Shqipërisë, më 11 janar 1946, ky pozicion nuk iu ishte besuar kurrë civilëve si Murra. Prokop Murra doli në pension, më 9 korrik 1990.



## Kiço MUSTAQI

Kiço Mustaqi, i lindur më 22 mars 1938, është një ish-gjeneral dhe politikan shqiptar i Partisë Shqiptare të Punës. Ai shërbeu si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare, njihet si ministri i fundit i Mbrojtjes i epokës komuniste në Shqipëri dhe ishte anëtar i Politburo-ut. Hyri në Shkollën e Lartë Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, ku u diplomua si oficer ushtarak në vitin 1960, në prag të ndarjes shqiptaro-sovjetike. Ai menjëherë iu bashkua Forcave të Armatosura të Shqipërisë, fillimisht duke shërbyer në një vendndodhje të largët ushtarake dhe pastaj duke u kthyer në Tiranë, ku punoi për 4 vjet në të njëjtën shkollë ushtarake, në të cilën u diplomua. Gjatë viteve 1964-1967, ai studioi në “Akademinë Ushtarake Mehmet Shehu”. Punoi më vonë në Tropojë deri në fund të vitit 1966, ku emërua shefi i Shtabit të Brigadës Sulmuese dhe më vonë Komandant i Brigadës Sulmuese në vitin 1968-1969, duke u pasuar nga puna në Vaun e Dejës si Komandant i Brigadës së Këmbëorisë. Në vitin 1974, ai u bë drejtor i Përgatitjes Ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes. Dy vjet më vonë, komandant i Korpusit Ushtarak të Tiranës. Pas tre vjetësh ai shërbeu si komandant Operativ i Ushtrisë Shqiptare dhe zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Më 1982, ai u bë shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Në vitin 1974, Kiço Mustaqi u zgjodh si përfaqësues në Kuvendin Popullor. Më 9 korrik 1990, zgjidhet ministër i Mbrojtjes në qeverinë e kryeministrit Adil Çarçani. Ai mbajti këtë pozicion deri më 22 shkurt 1991, por u zgjodh përsëri në qeveritë e njëpasnjëshme të Fatos Nanos deri më 12 maj 1991. Në qershor të vitit 1996, një gjyq special u zhvillua në Tiranë kundër tij (në mungesë), ku u akuzua për nxitje të një grushti shteti ushtarak në Akademinë Ushtarake të Tiranës, më 22 shkurt 1991.



## Ndriçim KARAKASHI

Ndriçim Karakashi lindur në Shkodër, 10 qershor 1950, ishte ushtarak karriere dhe ministër i shtetit shqiptar. Ndriçim Karakaçi ishte emëruar si pasardhës i Kiço Mustaqit, i cili kishte qenë ministër i Mbrojtjes për më pak se një vit. Ministri i ri i Mbrojtjes, Ndriçim Karakaçi ishte një oficer me mendje reformash, i cili kishte shërbyer si zëvendësues i Shtabit të përgjithshëm.



## Perikli TETA

Perikli Teta ishte ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë, në vitin 1991. Perikli Teta ishte një inxhinier aviacioni dhe politikan shqiptar, i cili mbajti disa poste ministrore në Shqipëri gjatë dekadës së trazuar të viteve 1990. Ministër i Rendit Publik i Shqipërisë (1998 - 1998).



## Alfred Spiro MOISIU

Alfred Spiro Moisiu u lind më 1 dhjetor 1929, në Shkodër. Më 1941 - 1945 ndoqi gjimnazin e Tiranës. Më 1946 - 1948 ndoqi shkollën e Inxhinierisë Ushtarake të Bashkimit Sovjetik. Më 1949 - 1951 ishte instruktor në Akademinë Ushtarake "Skënderbej". Më 1958 - 1966 ishte oficer në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes. Më 1966 - 1971 u caktua komandant i Brigadës së "Urave të Rënda" në Kavajë. Më 1971 - 1981 ishte drejtor i Xhenios dhe i Fortifikimit në Ministrinë e Mbrojtjes. Më 1981 - 1982 zëvendësministër i Mbrojtjes dhe më pas komandant i Kompanisë së Xhenios në Burrel deri më 1984. Më 1985 deri më 1991 nxirret në pension. Më 1991 - 1992 u emërua ministër i Mbrojtjes. Më 1992 - 1994 ishte këshilltar i ministrit të Mbrojtjes, Safet Zhulali. Më 1994 - 1997 zëvendësministër për Politikën e Mbrojtjes dhe po nga 1994 deri më 2002 president i Shoqatës Shqiptare të Atlantikut. Rinxirret në pension më 1997 deri më 2002-shin, kur dhe u zgjodh President i Republikës nga parlamenti, më 24 qershor dhe mori detyrën, më 24 korrik, duke zëvendësuar Rexhep Meidanin. Këtë funksion Moisiu e ushtroi deri më 24 korrik 2007, kur kreun e shtetit e mori presidenti Bamir Topi, i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, më 20 korrik 2007. Është autor i mjaft shkrimeve, artikujve dhe studimeve të botuara në shtypin shqiptar e të huaj, për problemet e artit ushtarak, të politikës së mbrojtjes e të sigurisë rajonale si dhe për zhvillimet në Kosovë.



## Safet ZHULALI

Safet Zhulali ishte ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë gjatë viteve 1992 - 1997. Safet Zhulali ishte deputet i PD-së në Parlamentin Shqiptar në dy regjistratura 1992-1997. Në vitin 1992 Shqipëria shpalli një pakt ushtarak me Turqinë. Po ashtu në këtë vit Shqipëria hyri në Konfederatën Islamike. Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, në vitin 1992, ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë e quajti Shqipërinë "motër" të Turqisë. Në maj të vitit 1994 Shqipëria dhe SHBA-të nënshkruan marrëveshje për bashkëpunimin ushtarak dhe në fund të këtij viti filluan negociatat mbi aludim të Shqipërisë në programin "Partneriteti për paqen".





## Shaqir VUKAJ

Shaqir Vukaj ka lindur në Reç të Shkodrës. Ka filluar studimet e larta në Moskë dhe i ka përfunduar në Tiranë, ku është diplomuar në degën Kimi Industriale. Për shumë vite ka punuar në detyra të ndryshme si inxhinier, kryeinxhinier e drejtor ndër-marrjeje. Ka aktivitet të gjerë politik e diplomatik. Ka qenë tre herë deputet i Kuvendit të Shqipërisë (në vitet 1992-1996 ka qenë N/kryetar i Kuvendit), dy herë ministër (ministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Pajtitit Kombëtar në vitin 1997, dhe ministër i Tregtisë dhe Turizmit). Ka punuar për rreth 16 vjet në diplomaci. Ka qenë përfaqësues i Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, Federatën Ruse dhe në Republikën Çeke.



## Luan HAJDARAGA

Luan Hajdaraga, lindi në Tiranë, më 2 gusht 1948. Më 1966 - 1970 ndoqi Fakultetin e Psikologjisë në Universitetin e Bukureshtit në Rumani. Më 1973 - 1985 qe punonjës shkencor, dhe më pas drejtor i Institutit të Studimeve Pedagogjike deri në vitin 1992. Në vitin 1992 u zgjodh deputet i Partisë Socialiste, më pas kandidoi po ashtu për kryetar bashkie në Tiranë. Në vitet 1992 - 1996 qe anëtar i Kryesisë së PS-së, ndërsa në vitet 1993 - 1996 nënkryetar i partisë. Në vitet 1998 - 2000 u emërua ministër i Mbrojtjes, ndërsa në vitet 2001 - 2005 qe zëvendësministër i Punëve të Jashtme. Në marsin e 2018-s pësoi një hemorragji cerebrale të rëndë, më pas u dërgua për kurim në Turqi, por më 30 korrik 2018 ndërroi jetë në QSUT, Tiranë.



## Sabit BROKAJ

Sabit Brokaj, deputet në Kuvendin e Shqipërisë që nga viti 1991, ishte dhe ministër i Shëndetësisë i Shqipërisë në vitin 1991 si dhe ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë në një ndër periudhat më kritike për vendin, gjatë viteve 1997 - 1999. Ai studioi kardiologji në Francë, mbante gradën shkencore “Profesor” dhe titullin “Doktor shkencash”, i specializuar në fushën e kardiologjisë. Ndër vite ai ka qenë edhe pedagog i jashtëm në Fakultetin e Mjekësisë.



## Ilir GJONI

Ilir Gjoni (Gjonaj) ishte ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë, në vitin 2000 si dhe ministër i Brendshëm i Shqipërisë gjatë periudhës 12 shtator 2001 - 29 janar 2002.



## Pandeli MAJKO

Pandeli Majko, lindi më 15 nëntor 1967, në Tiranë. Ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Tiranës në vitet 1986-1992. Gjithashtu ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, në vitet 1994-2000.

Ka mbajtur dy herë postin e sekretarit të Përgjithshëm dhe kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Po ashtu dhe postin e Ministrit të Mbrojtjes e ka mbajtur dy herë. Në vitet 1998-1999 do të merrte postin e Kryeministrit në Qeverinë e Shqipërisë. Po këtë post, e ka mbajtur për 8 muaj edhe në vitin 2002. Ka qenë anëtar i Komisionit Parlamentar për hartimin e Kushtetutës shqiptare në Kuvendin e Shqipërisë në vitet 1997-1998.

Pandeli Majko ka qenë Kryetar i Delegacionit shqiptar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, si dhe anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.



## Luan RAMA

Luan Rama, lindur më 9 mars 1966, Peshkopi, Dibër, ish-ministër i Brendshëm i Shqipërisë gjatë periudhës korrik 2002 - tetor 2003 të qeverisë socialiste. U emërua ministër i Mbrojtjes më 23 shkurt 2002.



## Gazmend OKETA

Gazmend Oketa është politikan shqiptar, ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë, nga 28 marsi 2008 deri në vitin 2009. I diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Themelues i partisë Fryma e Re Demokratike së bashku me Bamir Topin. 1993-1995, asistent pedagog në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit; 1995-1997, njësia e menaxhimit të Projektit të Bankës Botërore për Rehabilitimin e Ujësllësit të Durrësit.



## Fatmir MEDIU

Fatmir Mediu, lindi në Durrës, më 21 janar të vitit 1967, është politikan shqiptar, kryetar i Partisë Republikane dhe deputet i kësaj partie në Kuvendin e Shqipërisë. Kreu Universitetin e Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, dega e Inxhinierisë së Nxjerrjes së Naftës. Në vitet 1990-1991 inxhinier në Ndërmarrjen e Nxjerrjes së Naftës, Patos. Ministër i Mbrojtjes shtator 2005 - mars 2008.



## Mimi KODHELI

Mimi Kodheli ka lindur më 11.09.1964. Në vitin 1982 - 1986 ka studiuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, dega Financë; më 2014 ka marrë titullin shkencor "Doktor i Shkencave Ekonomike" nga Universiteti i Veronës, Itali, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik; 1998 - 2000, Master në Administrim Biznesi nga Universiteti i Lincoln-it, Nebraska, SHBA, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës. Dekretohet ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, më 11 shtator 2013.



## Arben IMAMI

Arben Imami, lindur më 21 janar 1958, është politikan, pedagog dhe aktor shqiptar. Arben Imami ishte pedagog në Institutin e Lartë të Arteve, kur iu bashkua Lëvizjes Studentore të vitit 1990, kundër diktaturës komuniste. Ai ishte një nga pjesëmarrësit e përfaqësuesit të studentëve dhe pedagogëve, që u zgjodhën nga studentët protestues, për të marrë pjesë në takimin me diktatorin e fundit komunist në Shqipëri, Ramiz Alia. Në këtë takim u kërkuar lejimi i pluralizmit politik në Shqipëri dhe krijimi i një partie politike të studentëve dhe intelektualëve. Në vitin 2009, mbajti pozicionin e ministrit të Mbrojtjes; 2001 - shkurt 2002, ministër i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit; 2000 - 2001 ministër i Drejtësisë; 1997 - 1999, ministër i Reformës Legjislative dhe Marrëdhënieve me Parlamentin; 1997 - 1998, bashkëkryetar i Komisionit Parlamentar për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; 1997 - 2005, deputet; 1992 - 1996, deputet; 1992 - kryetar i Komisionit Parlamentar të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit; 1991 - 1992, deputet; nënkryetar dhe kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.



## Olta XHAÇKA

Olta Xhaçka ka lindur në qytetin e Tiranës, më 25 dhjetor 1979. Është deputete e Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë. Olta Xhaçka, më 23 mars 2017, emërohet ministre e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë. Në shtator 2017, znj. Xhaçka emërohet Ministre e Mbrojtjes. Që prej janarit 2021, znj. Xhaçka mban postin e ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme.



## Niko PELESHI

Niko Aleks Peleshi, lindur më 11 nëntor 1970, në Korçë. Politikan shqiptar, i cili aktualisht mban postin e ministrit të Mbrojtjes, që prej datës 31 dhjetor 2020. Më parë ka shërbyer si zëvendëskryeministër i Shqipërisë në shtator 2013. Ai ishte Prefekt i Korçës nga viti 2004 deri në vitin 2005 dhe kryetar i Bashkisë së Korçës nga viti 2007 deri në vitin 2012. Që nga viti 2019 është deputet zyrtar i partisë socialiste.

Ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës me rezultate të shkëlqyera, duke marrë titullin "Inxhinier Elektronik". Në vitin 1989 ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme "Raqi Qirinxhi", në Korçë, me Medalje të Artë.

Z. Peleshi ka pasur një angazhim të gjatë në fushën e biznesit privat në qytetin e Korçës, si dhe në vitet 2001 - 2004, ka drejtuar me sukses Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Korçë.

Në vitin 2013 zgjidhet anëtar me të drejta të plota i Komitetit të Monitorimit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës.

Zoti Niko Peleshi, në vitin 2013 zgjidhet zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2017, zgjidhet ministër i Bujqësisë i Republikës së Shqipërisë.



# 110 VJET FARSH

## 27 SHEFA TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM



Prof. Asoc. Dr.  
Zaho GOLEMI

“

**Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin Shtati Madhuer dhe më tej u emërtua “Shtabi Madhuer” kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi.**

Ushtria Kombëtare e shtetit shqiptar është ngritur 110 vjet më parë, krahas Ministrisë të Luftës/Mbrojtjes. UKSH-ja ka pasur në drejtim shtatmadhorët dhe Shtatmadhorinë e saj. Tradita luftarake shqiptare ka ekzistuar që nga ushtritë ilire, në ushtrinë e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, në atë të Pashallëqeve të Bushatllinjve dhe Ali Pashë Tepelenës tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që janë faqe të ndritura të historisë dhe traditës ushtarake shqiptare. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të një shteti të pavarur, në Shqipëri, u formua më datën 4 maj 1913 në Vlorë. Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin “Shtati Madhuer” dhe më tej u emërua “Shtabi Madhuer” kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi. Shtabi Madhuer e kishte qendrën në Vlorë, pranë Ministrisë së Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, që kryesohej nga Ismail Qemal Bej Vlora. Në verën e vitit 1913 ky shtab ishte fare i vogël, ai përfaqësohej nga një zyrë që emërohej Zyra e Shtatit Madhuer të Ushtrisë, pranë Ministrisë së Luftës dhe ishte në përbërje e në varësi të kësaj ministrie. Në pikëpamje organizative Shtabi Madhor përbëhej nga “pjesët e nënzëshme” që emërtohej në terminologjinë e fillim shekullit të kaluar si: “Qarqet e Shtatit Madhuer, Sekretaria e Shtatit Madhuer, Komisioni i rregulloreve e i ushtrimeve, Komisioni i trajnimit të policisë e të xhandarmërisë, Komisioni i ndërtimit”. Shtabi Madhor ishte konceptuar, ndërtuar, por edhe veprroi teorikisht e praktikisht si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Shtabi ishte përgjegjësi kryesor për





organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të FA-së Shqiptare. Nga Shtabi kalonin të gjitha projektet e raportet për Ministrinë e Luftës, që i dërgoheshin asaj nga ana e zyrave apo edhe nga vetë qarqet e tjera ushtarake. Shtabi në këtë periudhë u mor drejtpërdrejt edhe me çështje dhe probleme që kishin lidhje me organizimin dhe kryerjen e luftimeve në mbrojtje në pjesën jugore e juglindore të Shqipërisë, kundër shovinistëve grekë, dhe në pjesën verilindore. Shtabi Madhor ishte përgjegjës për furnizimin me armatime, municione e barna mjekësore të forcave ushtarake shqiptare në zonat e veprimeve. Shtabi merrej me organizimin e forcave dhe strukturave të Ushtrisë, me hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve mbi organizimin, jetesën, stërvitjen dhe veprimtarinë e Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë Shqiptare. Gjithashtu Shtabi kujdesej për kompletimin e forcave dhe të reparteve me veshje, me armë të rënda dhe deri në hartimin e fjalorëve me terma shpjeguese ushtarake në gjuhën shqipe. Menjëherë pas Kongresit të Lushnjës, në janar 1920, dhe krijimit të Qeverisë, në përbërje të së cilës u përfshi përveç Ministrisë së Luftës, me gjeneral brigade Ali Riza Kolonjën në krye, edhe struktura e Shtatmadhorisë me në krye nënkolonel Ali Shefqet Shkupin. Shtabi varej nga Ministri i Luftës; ndërsa në nëntor 1920, në Qeverinë e Iljaz Vronit, në detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor u caktua



“

**Shtabi Madhor vazhdoi të vlerësohej si instrumenti kryesor i domosdoshëm për organizimin, drejtimin, stërvitjen dhe planëzimin për veprimtarinë e Ushtrisë Shqiptare.**

gjeneral brigade Ali Riza Kolonja, i cili kryente edhe detyrën e komandantit të Divizionit Aktiv të Ushtrisë. Shtabi Madhor edhe tani vijoi të vlerësohej si një hallkë e rëndësishme, prandaj për drejtimin e tij u caktua një ushtarak i lartë i karrierës, me formim profesional ushtarak shtatmadhor lindor e perëndimor si dhe me një përvojë të pasur e të gjatë organizative, drejtuese dhe luftarake. Shtabi kishte detyra të natyrës organizative, planëzimi dhe drejtimi. Në pikëpamje të përbërjes ai ishte racional, me efektiv të pakët, por synohej të ishte mjaft efektiv në veprimtarinë e tij konkrete. Nga ai vareshin disa seksione, ku më kryesore ishin ai i mobilizimit, i personelit, i intendencës, i planëzimit etj. Shtabi kryente edhe detyra të shkallës së siç ishin hartimi i projektligjeve apo i rregulloreve për shërbimin ushtarak, por edhe drejtimi i operacioneve ushtarake për ruajtjen e rendit dhe të mos cenimit territorial të vendit. Në krizën politike të dhjetorit të vitit 1921, kryetari i Shtabit Madhor u emërua major Xhavid Leskoviku. Shtabi Madhor vazhdoi të vlerësohej si instrumenti kryesor i do-

mosdoshëm për organizimin, drejtimin, stërvitjen dhe planëzimin për veprimtarinë e Ushtrisë Shqiptare. Edhe emërtimi i Shtabit ishte formuluar “Zyra e Shtabit Madhuer”, që përbëhej nga një ekip i vogël i kryesuar nga kryetari i Shtabit si një organizator që kryente edhe detyrën e inspektorit, një adjutant, drejtorin e shkollës ushtarake, me katër kryetarë seksionesh: të xhenios, artilerisë, transportit, juridik dhe një oficer teknik për artilerinë. Më 1923 Shtabi Madhor drejtohej nga kryetari, që propozohej nga Ministri i Luftës dhe emërohej nga një dekret i Këshillit të Lartë të Shtetit. Shtabi Madhor rregullonte funksionimin e përgjithshëm të mekanizmit të Ministrisë së Luftës; këshillimin me atë ministri, përmbi çështje me rëndësi si dhe për të propozuar projekte pranë ministrit të Luftës. Detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor vijoi ta kryente major Xhavid Leskoviku deri në qershor të vitit 1923, kur ai u ngarkua me një detyrë tjetër dhe në vendin e tij erdhi major Bajram Fevziu. Në qershor 1924 ngeli në krye të Shtabit Madhor major Bajram Fevziu, shtab i cili nuk pati ndonjë





ndryshim as në përbërje organike dhe as në misionin e tij. Në janar 1925, pas shpalljes së Republikës së parë të Shqipërisë, në bazë të Statutit Themeltar ose Kushtetutës, si një strukturë përbërëse, gjithsesi modeste, mbeti Shtabi Madhor. Me vënien në zbatim të organikës së re të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, në postin e kryetarit të Shtabit u emërua koloneli austriak Gustav Von Myrdac, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e kryente që prej vitit 1922. Kryetari i Shtabit Madhor përzgjidhej nga radhët e oficerëve të lartë të karrierës, që të zotëronte përvojë të spikatur për organizimin, drejtimin, stërvitjen dhe planifikimin dhe njëherazi të ishte një prej organizatorëve të Ushtrisë. Në vitet 1929-1931, në kohën e Mbretërisë Shqiptare, Komanda e Mbrojtjes Kombëtare, u përmirësua në përshtatje me shndërrimet shoqërore dhe organizimin ushtarak. Shtabi Madhor përcaktohej edhe si një organ studimi, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme e Komandës së Mbrojtjes Kombëtare përcaktohej si organ zbatimi, kurse Intendenca si një organ administrativ. Në pikëpamje hierarkike kryetari i Shtabit Madhor varej drejtpërdrejt nga Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare. Shtabi Madhor, përmes elementëve përbërës të tij, si drejtori dhe seksione, drejtonte dhe kryente detyra të rëndësishme si rekrutimi, gjendjen e trupës së oficerëve, graduatëve dhe nëpunësve civilë, dekorimet, pensionet dhe transferimet e ushtarakëve të Ushtrisë. Në këtë periudhë, misioni dhe detyrat e Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare ishin rritur dhe zgjeruar dukshëm. Në fund të periudhës së Mbretërisë si në Ushtrinë Shqiptare që u rrit prania dhe roli oficerëve organizatorë, instruktorë italianë, edhe në vet Shtabin Madhor të Ushtrisë u shtua posti i një nënkryetari që vinte pikërisht nga radhët e oficerëve madhor italianë në Shqipëri. Pas vitit 1932 shefi i Shtabit Madhor u rrit në gradë, për vetë rëndësinë e postit dhe të detyrave që ai kryente në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare. Është fakt historik se vetëm në vitin 1922 ka pasur nënministër Mbrojtjeje dhe gjithë periudha deri në





vitet 1939-1940 ka qenë pa zëvendësministra. Në vitet 1941-1942, ka pasur vetëm Sekretar të Përgjithshëm por pa të drejta për firmosje në qeveri. Në mungesë të ministrave mund të firmoste vetëm një ministër qoftë edhe i një ministrie tjetër, por jo sekretari i Përgjithshëm. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, më 7 prill 1939, Ushtria dhe krejt forcat e Armatosura Shqiptare, ashtu si dhe Shteti dhe institucionet e tjerë të tij u bashkuan dhe u njësuën me ato Italiane. Pra nuk flitej dhe nuk ekzistonin më Forcat e Armatosura Kombëtare. Përpjekje për të bërë "... rikrijimin e Ushtrisë Shqiptare të Shtetit Shqiptar", duke ngritur edhe "Komandën e Përgjithshme të fuqive të armatosura", u bënë nga Këshilli i Naltë i Regjencës në nëntor të vitit 1943. Për këtë arsye Komiteti Ekzekutiv Provizor shpalli se "rihynte në fuqi Kodi Penal Shqiptar dhe gjithë ligjet e rregulloret e dhëna për Ushtrinë Shqiptare, përpara datës 7 prill 1939". Më 15 shtator 1943, ishte formuar Komanda e Mbrojtjes Kombëtare. Në urdhrin për këtë vendim, bëhej e ditur se, më 23 tetor 1943, në detyrën e kryetarit të Shtatmadhorisë Shqiptare u emërua Gjeneral Divizioni Gustav Von Myrdaci. Në vartësi të Shtatmadhorisë ishin vënë zyrat e Rregullim-Mobilizimit, të Stërvitjes, të Personelit dhe Zyra e Shërbimeve. Seksioni i Artilerisë, i Xhenios, i Disiplinës, i Shëndetësisë, Veteriner, i Transportit dhe Operacionit. Në të njëjtën kohë ishte edhe Zyra e Veshjes, e Kontratave, e Ushqimit, e Sekretarisë, e Zyrës së Intendencës së Përgjithshme dhe Komisariati. Detyrat e këtij organizmi ishin pothuajse ato që ai kryente në mesin deri në fundin e viteve '30-të të shekullin e XX, që lidheshin me organizimin, armët e shërbimet e ndryshme, stërvitjen, disiplinën dhe deri tek hartimi i planeve luftarake të operacioneve, ushqimin dhe detyra të tjera. Shtabi i kësaj periudhe, ashtu si dhe gjithë strukturat e tjera të Ushtrisë dhe të Forcave të Armatosura Shqiptare, nuk planëzoi dhe nuk ndërmori asnjë operacion ushtarak kundër pushtuesve italianë më 7.4.1939. Përgjatë Luftës Antifashiste

Nacionalçlirimtare, populli shqiptar ishte pjesëtar në Koalicionin Antifashist Botëror, krijoi forca të armatosura antifashiste vullnetare joqeveritare, që luftuan kundër fashizmit dhe nazizmit për çlirimin e vendit dhe, më 10 korrik 1943, në Labinot të Elbasanit, u formua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare. Ky Shtab, ndonëse nuk kishte një formë dhe përmasa klasike të shtabit të një ushtrie të rregullt, kishte origjinalitetin dhe veçoritë e veta organizative si dhe në pikëpamje të detyrave që kryente. Kështu Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së kishte përbërje dhe përmbajtje politiko-partiake-ushtarake, në formë, në përbërje dhe në përmbajtje, pasi kishte krahas Komandantit dhe një Komisar Politik. Shtabi përbëhej nga Komandanti dhe Komisari Politik, përkatësisht nga major Spiro Moisiu dhe Enver Hoxha; përveç tyre bënin pjesë edhe 10 anëtarë si kapiten Dali Ndreu zëvendëskomandant, major Abaz Kupi, toger Bedri Spahiu, Haxhi Lleshi, Myslym Peza, Mustafa Xhani ose siç

thirrej Baba Faja Martaneshi, Mustafa Gjinishi, Ramadan Çitaku, Sejfulla Malëshova dhe Ymer Dishnica. Komandanti dhe komisari Politik i Shtabit përbënin së bashku Komandën Eprorë të UNÇSH-së. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, për të kryer detyrat në planin ushtarak ishte organizuar mbi bazën e një strukture që përbëlidhte: Shtabin operativ, Komisariatit politik, Komisariatit ekonomik, Seksionin e brendshëm, Seksionin e Shëndetësisë dhe Seksionin e informacionit. Detyrat e Shtabit ishin të shumta, por ato më kryesoret ishin organizimi i forcave të armatosura, që nënkuptonte UNÇSH-në; drejtimi operativo-strategjik i këtyre forcave; përpunimi i taktikës së luftës dhe planifikimi i operacioneve të mëdha operativo-strategjike të UNÇ-së; analiza e veprimeve luftarake që kryenin formacionet luftarake e të tjera. Pas 24 majit 1944, me unifikimin e Komandës në Komandë të Përgjithshme, me një komandant të Përgjithshëm në Krye, shef i Shtatmadhorisë u emërua gjeneralmajor Spiro Moisiu. Shtabi i



Përgjithshëm vijoi të mbetej si një organ i specializuar ushtarak, që kryente detyra të ngjashme si dhe më parë. Me çlirimin e vendit, më 1944, ashtu si gjithë UNÇSH-ja, edhe Shtabi i Përgjithshëm iu nënshtrua shndërrimeve të domosdoshme për një ushtri të rregullt të kohës së paqes. Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes në vitet 1945-1990 është riorganizuar në varësi të drejtpërdrejtë të ecurisë së FA-së, duke iu përgjigjur gjendjes, detyrave e strukturave të tyre. Riorganizimet, shërbimet e zhvillimet e Ushtrisë Shqiptare u mbështetën edhe në efektshmërinë e udhëheqjes operative-strategjike. Në këtë periudhë u përsos organi i drejtimit, Shtabi i Përgjithshëm. Për organizimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura, më 1 korrik 1945, u krijua Ministria e Luftës dhe e Mbrojtjes Kombëtare, ku në përbërje të saj vepronte Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm ishte në varësi të Komandantit Suprem, i cili ishte edhe i ngarkuari me punët e Luftës dhe të Mbrojtjes Kombëtare. Në varësi të Shtabit të Përgjithshëm ishin, Drejtoria e Mbrojtjes Kombëtare dhe Drejtoria e Ndërlidhjes dhe tetë seksione dhe më konkretisht Seksioni Operativ, i Informacionit, i Topografisë, i Shifrës, i Stërvitjes Luftarake, i Ekspeditës, i Aeronautikës, i Brendshëm. Komandanti dhe drejtoritë e tjera vareshin drejtpërdrejtë nga Komanda e Lartë Supreme. Në gusht 1946 kryetar i Shtatmadhorisë u emërua Mehmet Shehu, në vend të gjeneralmajor Spiro Moisiut. Që nga 1 tetori i vitit 1946, pasi u suprimuan Komandat dhe disa seksione dhe u krijuan drejtoritë e seksionet e reja, kaluan në vartësi të drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm 7 drejtori: Prapavija, Artileria, Ndërlidhja, Xhenio, Mbrojtja Bregdetare, Operative dhe e Organizim-Mobilizimit, si dhe 10 seksione: i Zbulimit, Sekretariati i Shefit të Shtatmadhorisë, Shërbimi i Brendshëm i Shtatmadhorisë, i Prapavijës i Shtatmadhorisë, i Kimisë, i Tankeve dhe Autoblindave, i Aviacionit, i Stërvitjes Luftarake, i Shifrës, i Topografisë. Në

vitin 1952, gjeneralmajor Petrit Dume emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili u zëvendësua nga gjeneralmajor Arif Hasko në vitin 1954. Në vitin 1956 gjenerallejtënant Petrit Dume riemërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm, i cili qëndroi në këtë post deri në korrik 1974. Më vonë realizoheshin detyrat e gatishmërisë luftarake, të plotësimit, të drejtimit dhe të përgatitjes së komandave e shtabeve. Me riorganizimin në vitin 1966 Shtabi i Përgjithshëm përbëhej nga katër drejtori: Drejtoria Operative, e Zbulimit, e Organizim-Mobilizimit dhe e Ndërlidhjes; dhe nga shtatë degë autonome: e MKK, e Shifrës, e Topografisë, e Administratës, Ekonomike, e Stërvitjes luftarake dhe e Shërbimit, strukturë e cila nuk ndryshoi deri në vitet '80-të. Nga Shtabi i Përgjithshëm nuk vareshin Komandat e Korpuseve, Drejtoria Politike, Drejtoria e Xhenios, Komanda e MBL, Komanda e Artilerisë, Prapavija dhe Forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me krijimin e korpuseve në vitet 60-të, u lehtësua edhe puna e detyrat e Shtabit të Përgjithshëm për zgjidhjen e problemeve të reparteve apo për vështirësitë e drejtimit elastik të reparteve e nënreparteve. Por në vitet 1982-1983 kemi sërish riorganizim nga Korpuse përsëri 22 divizione. Shtabi i Përgjithshëm

merrej me drejtimin dhe udhëheqjen e përgjithshme të veprimtarisë luftarake dhe organizimin e kontrolleve të FA-së. Në riorganizimin e vitit 1974 të FA-ve, Shtabi i Përgjithshëm nuk pati ndryshime nga struktura dhe detyrat që kryente. Me vendosjen e demokracisë, SHP ridimensionoi detyrat e veta në funksion të operacjonalitetit, shkurtimeve të forcave e mjeteve dhe kthimin e FASH-së me struktura më të lehtësuara dhe sikurse edhe ushtritë më progresive të partnerëve tanë strategjikë.

Liderët ushtarakë shqiptarë, në 110 vjet shtet shqiptar kanë punuar për të qenë profesionistë në realizimin e misionit madhor të mbrojtjes së hapësirës territoriale shqiptare, në mbrojtje të identitetit dhe interesit kombëtar, por edhe janë bërë inspirues e promotorë për rritjen e shkallës së operacjonalitetit dhe standardeve për integrim real në rrugën e integritit të plotë euroatlantik. Nëse i referohemi gjeneralit Omar Bradeli, "Udhëheqja ushtarake është e paprekshme, dhe asnjë armë nuk e zëvendëson atë". Lideri ushtarak shqiptar në një shekull e dhjetë vjet është karakterizuar nga dashuria për Atdheun, kuraja, disiplina, përkushtimi dhe besnikëria, si elementë determinues të drejtimit dhe udhëheqjes ushtarake.





# 27

# SHEFAT E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

## 1 Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi

Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën “bimbash”. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef i Shtamadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit Suprem të Ushtrisë Shqiptare në qeverinë e Ismail Qemal Vlorës. Braktisi ushtrinë osmane kur ishte komandant i garnizonit të Stambollit. Për herë të parë në historinë shekullore Shtabi Madhor i drejtuar nga Ali Shkupi, edhe pse erdhi pak muaj më vonë, u bë organizatori i strukturave kryesore përbërëse të ushtrisë shqiptare me forca aktive, rezervë, vullnetare dhe xhandarmëri. Ali Shefqet Shkupi ishte arkitekt i krijimit të kompanisë së parë ushtarake shqiptare, model për gjithë ushtrinë e re shqiptare që do të ngrihej pas pavarësisë. Ai përballoi me sukses dy ndër sfidat themelore në qeverinë e parë shqiptare: organizimin dhe ngritjen e Forcave të Armatosura dhe njëherazi ruajtjen e rendit dhe të qetësisë. Në dokumentet e kohës gjendet që: “Sapo arriti në Vlorë, Ali Shefqeti u prit me nderime të larta nga patriotët më të njohur shqiptarë, që ndodheshin në atë qytet, si dhe nga vetë kryeministri Ismail Qemali.” Vetëm pas disa ditësh nga mbërritja e tij në Vlorë, kryeministri Ismail Qemali e dekretoi Ali Shefqetin në funksionin e lartë të shefit të Shtabit Madhor, të së parës ushtri shqiptare, që sapo ishte krijuar. “Pas marrjes së detyrës, Ali Shefqeti u mor me organizimin e strukturave të ushtrisë, duke krijuar degët e armëve më të domosdoshme të saj dhe të policisë”, - shprehet një nga dëshmitarët e



kohës. Për herë të parë kemi hartimin e një rregulloreje ushtarake shqiptare me 7 nene, me një faqe dhe shumë urdhra e urdhëresa në funksion të funksionimit të Shtabit Madhor. Ali Shefqeti ishte ideatori i krijimit të rregullores për organizimin e Milicisë shqiptare, rregullore që u miratua nga Qeveria e Ismail Qemalit, më 3 qershor 1913. Ali Shefqeti me energjinë e moshës 30-vjeçare ndikoi në zbatimin e përpiktë në përputhje me realitetin shqiptar të të gjithë planeve për ndërtimin e Forcave të Armatosura. Në janar të vitit 1920, pas krijimit të qeverisë, pas Kongresit të Lushnjës, u ringrit edhe struktura e Shtatmadhorisë me në krye nënkolonel Ali Shefqet Shkupin.

## 2 Gjeneral Ali Riza Kolonja

Gjeneral Ali Riza Kolonja, përveç detyrës si ministër Luftë në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet '20, pas Kongresit të Lushnjës me kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria. Ai ishte lindur në Kolonjë në vitin 1880 dhe u arsimua në Manastir, në Stamboll, ndërsa Akademinë e Shtabit e kishte kryer në Gjermani. Kishte kryer me dhjetëra detyra në ushtrinë Osmane e deri në ministër Luftë në vendin e vet. Kishte kulturë të gjerë ushtarake, kishte prirje në diplomacinë ushtarake dhe zotëronte pesë gjuhë të huaja. Në 1922 ishte pjesëtar në Komisionin Ndërkombëtar të Katër Fuqive nënshkruese për kufijtë e Shqipërisë. Komandoi për herë të parë divizionin e parë që u krijua në UKSH. Ishte organizator edhe në mbrojtjen në terren kundër forcave serbe e greke. Si ministër Luftë vuri për herë të parë në zbatim Ligjin për rekrutimin Ushtarak. Është shuar në vitin 1930, por në kujtesën e kombit ka ngulur për ringritjen e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe për mbrojtjen e kufijve shtetërorë.




## 3 Major Xhavid Leskoviku

Major Xhavid Leskoviku ka lindur më 2 maj 1882, në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Dhe është titulluar oficer, më 1 gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vjet me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por, më 1 janar 1913, hyn në shërbim të Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemal Bej Vlorës si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vidit. Duke qenë ushtarak me kulturë të gjerë u caktua me ushtarakët holandezë. Xhavid Leskoviku u caktua të gjykonte komplotin e xhonturqve, ushtarakët e kohës në Gjykatën Ushtarake të Vlorës. Në nëntor të vitit 1919, Xhavid Leskoviku bënte pjesë në organizatën politike "Krahu Kombëtar"; mori pjesë në mbrojtjen e Kongresit të Lushnjës në janar 1920. Me krijimin e ushtrisë, nga fundi i këtij viti emërohet kryetar i Shtatmadhorisë, ndërkohë që ministër Luftë ishte gjeneral Ali Riza Kolonja. Lufta politike ishte shumë e fortë ndërkohë që në vitin 1924 është dërguar atashe ushtarak në Beograd, ambasador më vonë në Shkup dhe së fundi në Ankara. Është akuzuar dhe dënuar pas Luftës si bashkëpunëtor me kuislingët në vitin 1945. Është dalluar si ushtarak profesionist, në ngritjen e UKSH-së e deri në drejtues i Shtatmadhorisë Shqiptare.



## 4 Major Bajram Fevziu

Major Bajram Fevziu ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket. Bajram Fevziu u lind në vitin 1884, në Kolonjë. Me përfundimin e shkollës së mesme shkoi në Stamboll, ku përfundoi studimet në Akademinë Ushtarake, në vitin 1906. Më 1908 kreu studimet në Akademinë e njohur të Shtatmadhorisë në Vjenë. Kur në Shqipëri u shpall pavarësia, ai ndihmoi në organizimin e UKSH-së, si në drejtimin e formacioneve të Vlorës dhe me ardhjen e qeverisë së Princ Vidit (mars 1914), vihet në shërbim të forcave ushtarake të saj me gradën "toger". U shqua për besnikëri, atdhetarizëm, vendosmëri dhe aftësi ushtarake. Me gradën "major" zëvendësoi Xhavit Leskovikun në postin e kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare. Këtë post ai e mbajti edhe me ardhjen e Qeverisë së Fan Nolit. Në krye të Shtabit Madhor, major Fevziu qëndroi deri më 24 dhjetor 1924. Pas rikthimit Zogu shpërndau Ministrinë e Luftës, duke krijuar "Komandën e Përgjithshme të Forcave Armate", shpërndau ushtrinë dhe oficerët e saj, duke i cilësuar ata si mbështetës të Lëvizjes së Qershorit dhe të pasojave të saj. Fillimisht B. Fevziu u përfshi në atë grup që u nxor në lirim pa asnjë shpërblim, qysh në fillim të vitit 1925 së bashku me 43 vetë të tjerë që nuk ishin larguar nga Shqipëria, kur ai ishte vetëm 41 vjeç dhe vuante nga një sëmundje e pashërueshme. Qysh në vitin 1914, ai u fut në përbërje të një komisioni të fshehtë të Lëvizjes Kombëtare në Shkodër, ku B. Fevziu bënte pjesë së bashku me Estref Frashërin, Sotir Peçin, Ali Shefqetin, Hoxhë Kadriun dhe më pas edhe Bajram Currin, pasi ushtarakët e viteve 20-40 lejohej të merrnin pjesë në jetën politike si anëtarë të një partie apo edhe të kandidonin për në Parlamentin e vendit. Në zgjedhjet e vitit 1921 për në Parlament, ai fitoi si deputet i Matit. Në 1919, ishte prefekt në Shkodër. Bajram Fevziu u detyrua të largohej nga karriera e tij në mes moshë, ndonëse vijoi të punonte në heshtje dhe në ilegalitet, por do të shuhej nga jeta në Vjenë, në vitin 1928.



## 5 Gjeneral Gustav Von Myrdac

Gjeneral Gustav Von Myrdac, me origjinë austriake, ishte në postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur më 7 dhjetor 1876, në Vjenë, kryeqytet i Austro-Hungarisë. Ai kishte përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake të Austrisë dhe u titullua oficer më 18 gusht 1897. Vjen në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore. Më 20 maj 1922, ftohet nga ministri i Punëve të Brendshme Ahmet Zogu. Më 18 janar 1925 me riorganizimin e UKSH-së, Myrdac emërohet kryetar i Shtatmadhorisë dhe organizatori kryesor i UKSH-së. Në vitin 1933 i jepet grada “gjeneral”, që me këtë gradë punoi për UKSH-në deri në pushtimin e Shqipërisë në vitin 1939. Ai rishfaqet përsëri në kohën e pushtimit në tendencat për ngritjen e ushtrisë së pavarur shqiptare nën drejtimin e Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, që me pushtimin gjerman u emërtua: “Komanda Shqiptare e Mbrojtjes”. Kjo ishte një UKSH krejtësisht fiktive, ku shefi i Shtabit të Përgjithshëm u caktua Myrdac, ndërsa komandant i Përgjithshëm Preng Prevezi. Ai u dënua nga gjyqi special në vitin 1945 si “kriminel lufte”. Gjeneral Myrdac ka kontribuar në ngritjen e UKSH-së në vitet 1922-1939. Në vitin 1923 ka paraqitur një projekt për reformimin e ushtrisë shqiptare ndonëse nuk u vu dot në veprim.



## 6 Gjeneral Spiro Moisiu

Gjeneral Spiro Moisiu, lindi në vitin 1900 në qytetin e Kavajës. Pasi mbaroi shkollën unike në qytetin e Kavajës dhe Durrësit, Spiro u dërgua për të ndjekur gjimnazin në Vjenë të Austrisë. Pas kthimit nga Austria, aty nga viti 1918-1919, ai mbaroi një kurs disamujor në Shkollën e Plotësimit të Oficerëve në Tiranë, e cila asokohe drejtohej nga instruktorë gjermanë e austriakë, ku dhe mori gradën e “nëntogerit”. Një vit më pas Moisiu mori pjesë në përbërje të forcave qeveritare që u caktuan në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe po atë vit ai u caktua me detyrën e shefit të Shtabit të grupit, në luftimet që zhvilluan në Kaptinë të Martaneshit kundër forcave serbe. Në vitin 1923 ai mbaroi në Tiranë Kursin tjetër njëvjeçar të Oficerëve, që asokohe drejtohej nga ushtarakët gjermanë, ku dhe mori gradën e “togërit”. Në Kryengritjen e Qershorit të vitit 1924, Spiro u rreshtua përkrah ushtarakëve të komanduar nga kolonelët Rexhep Shala dhe Kasëm Qafzezi, të cilët u bashkuan me forcat fanoliste. Po kështu, në dhjetorin e vitit 1924, Moisiu me gradën e “togërit” mori pjesë me forcat qeveritare që dolën në Shkallën e Tujanit për të penguar kthimin e Zogut në Shqipëri. Në vitin 1925, duke pasur parasysh aftësitë e tij si ushtarak tepër i aftë, kryeministri Ahmet Zogu e thirri sërish togë Spiro Moisiun, duke e titulluar përsëri oficer në UKSH. Karriera ushtarake e Spiro Moisiut erdhi në ngritje pas viteve 1929-1930, kur ai mbaroi me rezultate të shkëlqyera në Tiranë shkollën e Perfeksionimit të Oficerëve, që drejtohej nga instruktorët italianë, ku ndër 43 pjesëmarrësit e atij kursi ai u rendit i pari, duke marrë gradën e “kapitenit”. Në fundin e vitit 1940 major Moisiu në krye të Batalionit “Tomori”, u dërgua për të marrë pjesë në luftën italo-greke, por ai nuk pranoi të luftonte dhe u tërhoq nga fronti së bashku me major Prenk Përvizin, duke nxitur dhe dezertimet në radhët e ushtarëve shqiptarë. Pas nxjerrjes në lirim, në vitet 1941-1942, Moisiu u vendos në zonat e Lushnjës e Beratit dhe hyri në lidhje me ish-ushtarakët të tjerë të Monarkisë që kishin filluar organizimin e ngritjen e çetave të para partizane. Duke pasur parasysh të kaluarën e tij të papërlyer dhe aftësitë e rralla si ushtarak i karrierës, në korrikun e vitit 1943 kërret e Partisë Komuniste e thirrën atë në Labinot të Elbasanit, ku dhe i propozuan detyrën e komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai kishte famën e madhe që kishte krijuar si komandant i Përgjithshëm, në Kongresin e Përmetit, por të gjitha funksionet u përqendruan rreth funksionit politik si komandant edhe komisar i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ; ndërsa Spiro Moisiu mbajti vetëm detyrën e komandantit të Shtabit të Përgjithshëm.





## 7 Gjeneralmajor Mehmet Shehu

Gjeneralmajor Mehmet Shehu, lindi më 10 janar 1913 në fshatin Çorush të Mallakastrës. Në vitin 1932 përfundon Shkollën Teknike. Shkon në Napoli për të studiuar në Kolegjin Ushtarak, ku përjashtohet për ide revolucionare nga Kolegji. Largohet nga Italia dhe kthehet në Shqipëri, ku burgoset 2-3 muaj në Tiranë. Me daljen nga burgu, punon në fermën e Shkollës Teknike si traktorist. Ndjek Shkollën e Plotësimit të Oficerëve dhe titullohet në vitin 1937; ndërsa në dhjetor të atij viti shkon në Spanjë, ku merr pjesë në Br12 Ndërkombëtare "Garibaldi" në nder të heroit italian, e cila ishte e përbërë nga vullnetarë nga shumë vende të botës, ai komandonte batalionin IV të saj. Më 1939, pas çmobilizimit të vullnetarëve të huaj, kthehet në Francë dhe qëndron në një kamp përqendrimi. Rikthehet në gusht 1942 dhe caktohet sekretar organizativ i Qarkut të Vlorës për PKSH. Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka qenë komandant i Çetës Plakë të Mallakastrës në shkurt 1943; komandant i Br1S në gusht 1943, Komandant i D1S në maj 1944 me gradën "kolonel", ndërsa në tetor 1944 gradohet "gjeneralmajor". Mbas çlirimit të Shqipërisë dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik. Në periudhën 1945-1946 studion në Akademinë Ushtarake "Voroshilov" dhe pas përfundimit të studimeve kthehet në Shqipëri, ku në vitin 1947 emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm. Në periudhën 1948 -1954 kryen njëkohësisht detyrën e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të punëve të brendshme. Nga viti 1954 deri në vitin 1981 kryeministër; ndërsa nga 1974 deri në 1981 ka qenë ministër i Mbrojtjes. Njohës i pesë gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe rusisht.



## 8 Gjenerallejtënant Beqir Balluku

Gjenerallejtënant Beqir Balluku, lindi më 14 shkurt 1917 në Tiranë. Studioi në Shkollën Teknike të Tiranës. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak, nga viti 1940 deri në vitin 1942. Më 20 maj 1943, u caktua komandant i batalionit partizan "Krujë-Ishëm", më 18 shtator 1943 komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S. Më 28 janar 1948, ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake "Voroshilov". Në kongresin e parë të Partisë u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe në vitin 1953 ministër i Mbrojtjes Popullore. Një vit më pas mori gradën më të lartë në Shqipëri, atë të "gjenerallejtënantit". Balluku ishte gjithmonë deputet i Kuvendit Popullor. Në korrik të vitit 1974 ai u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake nga diktatura dhe u dënua me vdekje dhe u pushkatua, më 5 nëntor 1975, për tradhti të lartë ndaj atdheut.



## 9 Gjenerallejtënant Arif Hasko Mema

Gjenerallejtënant Arif Hasko Mema, lindi në Tërbaç të Vlorës dhe u bë i njohur gjatë LIIB me pseudonimin "Patrioti", gjatë luftës për çlirimin e vendit. Pasi mbaroi filloren në vendlindje, vazhdoi shkollën tregtare në Vlorë. Ai ka udhëhequr në LANÇ formacione të rëndësishme partizane që nga Vlora e deri në veri të Shqipërisë. Në dhjetor të 1943-it, inkadrohet në Br1S, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik. Më vonë kryen detyra të larta si komisar Divizioni, Korpusi, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore. Ai tërë jetën e tij, qëndroi besnik i idealeve të LANÇ-it. Ai kreu detyrën e zëvendëskryetarit të Parë të Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it. Për kontributet e tij është nderuar me shumë urdhra e medalje të akredituara nga ish-Presidiumi i Kuvendit Popullor.



# 10 Gjenerallejtnant Petrit Dume

Gjenerallejtnant Petrit Dume, lindi më 20 maj të vitit 1920, Partizan, komandant brigade, komandant divizioni, shpallur “Hero i Popullit” me vendim të Qeverisë e Polibrosës së PPSH-së e më pas, në vitin 1974, u shpall Armik i Popullit. Deputet, i arsimuar me dy akademi sovjetike ushtarake, shef i Shtatmadhorisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë si shefi më jetëgjatë në Shtabin e Përgjithshëm. Ai ka qenë deputet në të gjitha legjislaturat. Në korrik të vitit 1974 ai u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake nga diktatura dhe u dënua me vdekje dhe u pushkatua, më 5 nëntor 1975, për “tradhti të lartë ndaj atdheut”.



# 11 Sami Meçollari

Sami Meçollari ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër, në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Ka kryer shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe SHBO me rezultate të shkëlqyera, ku u titullua oficer me gradën “toger” në shërbimin e kimisë. Në vitet 1961-1965 kreu Akademinë Ushtarake, në vitet 1967-1968 kreu Kursin e Lartë të Kuadrove Madhorë pranë Akademisë Ushtarake. Në arsimin e përgjithshëm civil, krahas shkollës pedagogjike, përfundoi edhe Fakultetin e Inxhinierisë në Universitetin e Tiranës, Shkollën e Lartë të filozofisë etj. Në të gjitha shkollat ka merituar vlerësimin shkëlqyeshëm. Fillimisht shërbeu si shef i Shërbimit Kimik të batalionit në Berat, për të vazhduar si shef Kimie Brigade në Peshkopi (1960-1963), shef i Shërbimit Kimik në Korpusin e Shkodrës (1965-1967). Më pas kaloi si kuadër gjitharmësh në detyrën e shefit Operativ të Korpusit Shkodër (1968-1970). Në periudhën 1970-1972 u caktua shef i Shtabit të Korpusit të Gjirokastrës. Në vitin 1973 mori detyrën e Komandantit të këtij Korpusi deri në vitin 1974, kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Në dhjetor të vitit 1974 u lirua nga ky post dhe u caktua me detyra të tjera, si komandant brigade, komandant i Shkollës Ushtarake të Oficerëve Rezervë në Zall-Herr të Tiranës, për ta mbyllur karrierën ushtarake si komandant i SHLU-së në Rrëshen. Në vitin 1986 doli në pension. Në vitin 1991 krijoi organizatën ushtarakëve “Pensionistë e të liruar” (OUPLSH), duke u zgjedhur kryetar i saj. Gjatë karrierës ushtarake është karakterizuar nga kërkesa e lartë në punë e stërvitje, duke paraprirë me shembullin personal.



# 12 Veli Llakaj

Veli Llakaj u lind më 18 shkurt 1935, në Kras të Tepelenës. Në vitin 1951 mbaron shkollën 7-vjeçare në vendlindje. Në vitet 1951-1954 punon në gjeologji e tregti në Memaliaj. Në vitin 1954 shkon student në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të cilën e mbaron në vitin 1957 me rezultate të shkëlqyera dhe i jepet grada më e lartë “toger”. Me mbarimin e shkollës, në vitin 1957, emërohet në Shkollën e Bashkuar komandant toge, detyrë të cilën e kryen deri në vitin 1960. Ndërkohë ka mbaruar dhe gjimnazin “Qemal Stafa”, po në Tiranë. Në vitet 1960-1963 punon instruktor në MMP, në Drejtorinë e Përgatitjes Luftarake; Në vitet 1963-1966 kryen Akademinë Ushtarake; Në vitet 1966-1967, shef Shtabi i Br5S Vlorë. Në vitet 1967-1968, oficer drejtimi pranë SHP; Në vitet 1968-1971 është komandant i BrIK, Tiranë. Në vitet 1971-1972, në Akademinë e SHP dhe komandant i Korpusit të Burrelit. Në vitet 1972-1974 ishte komandant i Korpusit të Parë të Mbrojtjes Bregdetare Fier. Në vitin 1974 emërohet zëvendësministër i Parë dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, detyrë të cilën e kryen deri në vitin 1982. Më 13 tetor 1982, Komiteti Qendror i bën gjyq politik si “puçist” e bashkëpunëtor i Mehmet Shehut dhe dërgohet në Cërrik. Në vitet 1978-1982 është deputet i zonës së Kurveleshit së Sipërm në Tepelenë. Në vitet 1975-1982 është një nga 5 anëtarët e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes.



# 13 Kiço Mustaqi

Kiço Mustaqi, ishte një ushtarak karriere që kishte lindur, më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vjet rresht. Në shkurt të vitit 1991 ngarkohet me detyrën e ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së kryeministrit Fatos Nano dhe që u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë, në qershor të po atij viti.



# 14 Kolonel Halim Abazi

Kolonel Halim Abazi, ka lindur në dhjetor të vitit 1944 në Tërbaç të Vlorës. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Kështu në vitet 1953-1960 kreu studimet në shkollën ushtarake "Skënderbej"; në vitet 1960-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1970-1972 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në shkurt-qershor 1991, u përzgjedh për detyrën e lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1993.



# 15 Gjeneralmajor Kostaq Karoli

Gjeneralmajor Kostaq Karoli ka lindur në dhjetor të vitit 1945, në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ka komanduar Forcat e Armatosura kur kishin një efektiv shumë të madh, si aktiv ashtu edhe rezervist me rreth 16 500 oficerë, 9 000 nënoficerë, 60 000 ushtarë e 8 000 civilë; rezervistë rreth 450 000 vetë, dhe 230 000 forca vullnetare. Me 22 Divizione dhe tre Forca që ishin: Mbrojtja Kundër Ajrore, Flota Luftarako-Detare dhe Aviacioni. SHP kishte nën komandë 127 Brigada Këmbësorie, Brigada Artilerie dhe Brigada Sulmuese; rreth 1 050 tanke, rreth 4 000 gryka zjarri artilerie tokësore; 34 regjimente të artilerisë kundërajrore pa llogaritur artilerinë kundërajrore të Brigadave, etj. Në kufi, mitralozat e rëndë (armët roje), bateritë e gatshme të artilerisë kundërajrore, hapnin zjarr për 2-3 minuta. Për 20-30 minuta, batalionet mitraljere në vijën e kufirit ishin bërë gati për luftim; për 15-20 minuta, artileria tokësore e gatshme kishte hapur zjarr. Ka punuar dhe punon në sektorët shkencorë ushtarakë me titullin akademik "Profesor".



# 16 Gjeneral Ilia Vasho

Gjeneral Ilia Vasho ka lindur, më 10 korrik 1944, në Leskovik. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, si dhe kualifikimet më të larta ushtarake. Kështu në vitet 1962-1964 ka kryer Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitet 1976-1978 Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Mbante gradën shkencore "Doktor Shkencash". Në 1992-1994 u përzgjedh për detyrën e lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1997, nga funksioni që ka pasur si përfaqësues ushtarak në NATO, funksion që e kreu nga 1994 deri në 1997.





## 17 Gjeneral me katër yje, Sheme Kosova

Gjeneral me katër yje, Sheme Kosova lindi më 24 mars 1949. Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore të shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ndoqi studimet në shkollën e mesme Pedagogjike në vitin 1967 dhe SHLB në vitin 1971; ndërsa në vitet 1979-1981 ka përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në shef i SHPFASH. Më 2 mars 1997 lirohet nga kjo detyrë madhore.



## 18 Gjeneralmajor Adem Çopani

Gjeneralmajor Adem Çopani, ka lindur në korrik të vitit 1944 në Tiranë. Ka kryer të gjithë llojet e arsimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera si shkollën ushtarake "Skënderbej"; Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe Akademinë e Mbrojtjes. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës. Në një nga periudhat më të vështira e të errëta të ushtrisë shqiptare në mars të vitit 1997 zgjidhet në postin madhor të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, detyrë që e mbajti deri në gusht të vitit 1997. Në karrierën e tij ushtarake ka fituar edhe gradën shkencore "Doktor" si dhe titullin akademik "Profesor". Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1997. Vitet e fundit të jetës banoi në SHBA.



## 19 Gjeneral brigade Aleks Andoni

Gjeneral brigade Aleks Andoni, ka lindur më 8 qershor 1956, në fshatin Vuno të Vlorës. Ka kryer arsimimit ushtarak në shkollën ushtarake "Skënderbej", në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Akademinë e Mbrojtjes si dhe kualifikimin pasuniversitar për pedagogji e psikologji. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1992 deri në gusht 1997 ka dalë oficer në rezervë si rezultat i reformës ushtarake. Në shtator të vitit 1997 u përzgjedh nga klasa politike për detyrën e lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare, detyrë që e kreu deri në vitin 2000 pasi plotësoi mandatin trevjeçar të parashikuar me ligj për këtë post.



## 20 Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi

Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi, ka lindur më 21.10.1957 në Skrapar. Në vitin 1981, ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve; në 1991 u diplomua në Akademinë e Mbrojtjes, në 1992 kursin për "Refugjatët", Hungari, kursin për "Ligjshmërinë Ndërkombëtare për Refugjatët", në Itali; në 1994 kursin për "Orientimin dhe planëzimin e operacioneve", në Turqi; në 1995 kursin "Zbulimi Strategjik", SHBA; në 1996 u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes, Tiranë; në 1996 kursin e NATO-s "Oficer shtabi për operacionet", Holandë; në 1998 kursin për "Ligjin e Luftës", Itali; në vitin 2000 kreu studime pasuniversitare për "Siguri Globale, Diplomaci e Mbrojtjes", Kolegji Mbretëror Ushtarak, Universiteti i Cranfield, Mbretëria e Bashkuar; në vitin 2001 ka mbrojtur nivelin "Master" në Universitetin Cranfield-Kolegji Mbretëror Ushtarak, Angli; në vitin 2012 ka mbrojtur doktoratën në Fakultetin e Filozofisë, Universiteti i Zagrebit për temën "Local Traditions and Foreign Influences in the Albanian Military History 1912-1991". Duke qenë në detyrën madhore të shefit të SHP, gjatë periudhës 2000-2006 ka qenë pjesëmarrës në seminare, konferenca në Shqipëri, në vende anëtare e jo anëtare të NATO-s; ka publikuar në revista të vendit dhe të huaja për çështjet e sigurisë; lektor në Shkollën e NATO-s, Gjermani, në Heidelberg, Gjermani në Racviac, Kroaci; në Klubin Diplomatik të Zagrebit, Kroaci; në Kolegjin e Mbrojtjes, Akademia e Mbrojtjes Tiranë si dhe



ligjërata në institucione kroate 2011-2012. Ka kryer detyrat: komandant toge, instruktor stërvitjeje; zëvendës drejtor në Drejtorinë e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm, grada “nënkolonel”; zëvendës drejtor i Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Më 1 gusht 2007, është emëruar Ambasador i Shqipërisë në Kroaci ndërsa më 09.06.08 - 06.2010, ambasador jo rezident i Shqipërisë në Bosnjë-Hercegovinë. Detyrën e SHSHP e ka kryer në dy mandate, nga viti 2000 deri në vitin 2006. Gjatë periudhës që Pëllumb Qazimi ka qenë në krye të FASH-së ka pasur një progres të dukshëm, duke bërë hapa të sigurt drejt strukturave të NATO-s.

## 21 Gjeneralmajor Luan Hoxha

Gjeneralmajor Luan Hoxha, ka lindur më 28 mars 1960, në Shkodër dhe ka qenë shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008. Pas diplomimit në vitin 1983 e deri në vitin 2008 ka kryer detyra të larta deri në shef Shtabi, si dhe kualifikime të shumta por shpërthimi që ndodhi më 15 mars 2008, i ndërpreu edhe karrierën ushtarake, kur ishte ngjitur deri në detyrën më madhore të ushtarakut, atë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.



## 22 Gjeneralmajor Maksim Malaj

Gjeneralmajor Maksim Malaj ka lindur më 13.12.1958. Ka përfunduar Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve si dhe më vonë ka kryer shumë kualifikime. Në 1981-1982 ka qenë instruktor i Përgatitjes së Zjarrit në Shkollën e Instruksionit, Zall Herr; më tej për pesë vjet ka kryer funksionin si instruktor Stërvitjeje; instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin VIII të Këmbësorisë; komandant Batalioni këmbësor e territorial; në vitin 1992-1993, instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin VIII të Këmbësorisë; në 1993-1994 shef Operacional në Njësi Ushtarake Nr. 1105; në 1994-1997, instruktor në Degën e Stërvitjes në Divizionin VIII të Këmbësorisë; në 1997-2005, inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të ministrit të Mbrojtjes në 2005-2007, shef Shtabi dhe në vitin 2008, komandant i BrRSH. Detyrën e SHSHP e ka kryer në periudhën nga viti 2008 deri më 8.8.2011. Gjatë periudhës që Maksim Malaj ka qenë në krye të FASH-së ka pasur një progres të dukshëm, ku Shqipëria është pranuar anëtare me të drejta të plota në strukturën e sigurisë së kombeve, NATO.



## 23 Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi

Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, ka lindur në Peshkopi, më 30 janar 1963. Ai filloi jetën ushtarake në vitin 1977 në SHMU “Skënderbej”. Në vitin 1985 u diplomua nga Akademia Ushtarake, ku pas saj filloi karrierën e tij ushtarake si komandant toge. Gjatë karrierës së tij, ka qenë komandues, toge, kompanie, batalioni, brigade. Ka kryer kolegjin e Luftës së Forcave Tokësore në Turqi, ku u diplomua në vitin 1998. Nga viti 1998 deri në vitin 2004 ka kryer detyra të ndryshme në Shtabin e Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Ai ishte atashë i Mbrojtjes Shqiptare në Turqi që nga viti 2004 deri në vitin 2007. Në vitin 2007, u diplomua në Kolegjin e Mbrojtjes. Po këtë vit komandoi regjimentin Komando. Në vitin 2009 u gradua “gjeneral brigade” dhe komandoi Brigadën e Mbështetjes Logjistike. Me dekret të Presidentit të Shqipërisë Nr. 7079, datë 8 gusht 2011, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm. Aktivitetet më të rëndësishme të Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë të shumta si Konferenca e Komandantëve të Forcave Tokësore të vendeve të NATO-s dhe atyre partnere, zhvillimi i Konferencës Planëzuese të Stërvitjes së rëndësishme të NATO-s “Combine Endeavour”; takime tepër të rëndësishme të nivelit të lartë me Komandat Ushtarake të NATO-s, takime me Komandantin e Komandës Supreme të Aleancës, Admiral Stavridhis, me Komandantin e Komandës së Aleancës për Transformimin, gjeneralit Abrial etj. Shtabi i Përgjithshëm ka vijuar kontributin e tij të fuqishëm në drejtim të demontimit të municioneve, të kontributit në operacione humanitare në ndihmë të popullsisë, të angazhimit serioz në misionet paqeruajtëse, të modernizimit të Forcave të Armatosura etj.



# 24 Gjeneralmajor Jeronim Bazo

Gjeneralmajor Jeronim Bazo, u lind në vitin 1960. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në vitet 1980-1983, ku edhe u titullua oficer aktiv në FARSH. Karrierën ushtarake e filloi si komandant toge, kompanie, instruktor stërvitjeje, zëvendëskomandant batalioni, duke vijuar më tej me kryerjen e detyrave në fushën e personelit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Gjeneral Bazo u diplomua nga Qendra Europiane për Studime të Sigurisë “George C. Marshall”, për Studime të Sigurisë dhe Ekonomisë së Mbrojtjes. Drejtoi Departamentin e sapokrijuar asokohe të Sigurisë Kombëtare pranë Akademisë së Mbrojtjes të FA-së. Shërbeu si oficer koordinator me NATO-n pranë Ministrisë së Mbrojtjes, komandoi Akademinë e Nënoficerëve dhe më pas u bë komandanti i Akademisë Ushtarake “Skënderbej”, duke shërbyer si komandant i parë i këtij institucioni. Gjeneralmajor Bazo udhëhoqi punën për planifikimin dhe zhvillimin për herë të parë të Kursit të Lartë për Studime për Sigurinë dhe Mbrojtjen. Në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, ishte në krye të procesit që realizoi me sukses integrimin e plotë të Shqipërisë në NATO. Gjeneralmajor Bazo përfundoi Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Mbrojtjes të FA-së si dhe u diplomua nga Kolegji i Luftës i Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, klasa 2006, ku dhe fitoi gradën shkencore “Master Shkencor për Studime Strategjike”. Ai ka marrë pjesë, kontribuar, drejtuar dhe ligjëruar në shumë konferenca e seminare, veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjeneral Bazo ka qenë autor e bashkautor në artikuj dhe kërkime shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përgjatë karrierës mbi 30-vjeçare në FARSH, për shërbimet e kryera, gjeneralmajor Bazo është vlerësuar me medalje karriere, për shërbime të veçanta në MM dhe SHP.



# 25 Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku

Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku është lindur në Pëllumbas të Beratit, më 1967. Kreu studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në vitet 1986-1990, Kolegjin e Komandës dhe Shtabit të FT-së në SHBA, Fakultetin Ekonomik të UT në vitet 2001-2005; kreu Kursin e Lartë Ekzekutiv në qendrën “George C. Marshall” për studime strategjike në Gjermani më 2006. Në vitin 2009 ka mbrojtur doktoratën me temë “Operacionet e informimit në mbështetje të procesit të vendimmarjes”. Ka kryer shumë detyra në FARSH, si komandant toge deri në shef Sektori në Drejtorinë e Zbulimit deri më 2000; shef Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë në MM për dy vjet 2003-2005. Ka shërbyer për vitet 2005-2006 në detyrën e shefit të Sektorit në Sekretariatit Ndërkombëtar të Ministerialit të Mbrojtjes të Europës Juglindore në Tiranë. Është përzgjedhur për drejtimin e batalionit të këmbësorisë të FT-së, të certifikuar nga NATO për dy vite dhe pas kësaj detyre, në vitet 2008-2010, ka shërbyer si shef kabineti i SHP. Pas viteve 2010 ka shërbyer në detyra të larta në NATO, si Drejtor i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM). Në gusht të vitit 2017 merr detyrën e lartë të shefit të SHP me gradën “gjeneral brigade”, detyrë që e ka përfunduar më 30.7.2020. Mban disa urdhra e medalje si vlerësim për kontributin në Forcat e Armatosura. Ka kontribuar për ngritjen në një shkallë më të lartë të stërvitjes e modernizimit të FA-së, për forcimin e kapaciteteve dhe përmbushjen e objektivave strategjike në kuadrin e direktivave të NATO-s. Forcat e Armatosura nën drejtimin e tij u angazhua për ngritjen e niveleve cilësore ushtarake nëpërmjet shndërrimit në një forcë profesioniste, të mirë stërvitur, të pajisur me sisteme të teknikës dhe të armatimit bashkëkohor si një proces i modernizimit të FA-së në vijimësi. Pas përfundimit të karrierës ushtarake 30-vjeçare u përzgjedh nga politika për të vijuar kontributin si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i përzgjedhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Ai shërben me dinjitet në zonën e tij elektorale në Berat dhe eksperiencën e tij në çështjet e sigurisë e vijon në Komisionin e Sigurisë Parlamentare.





## 26 Gjeneralmajor Bajram Begaj

Gjeneralmajor Bajram Begaj, ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm, ka lindur më 20 mars 1967, në Rrogozhinë. Pas studimeve bazë në vendlindje me rezultate të shkëlqyera, vazhdon studimet universitare në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë, ku dhe diplomohet në vitin 1989, mjek aktiv.

Pasi ka përfunduar doktoraturën profesionale, mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi.

Gjatë karrierës së tij ushtarake 32-vjeçare, Begaj ka marrë pjesë në seminare të shumta trajnimi dhe ka përfunduar kurse në Siguri dhe Mbrojtje, Shkollën e Avancuar Pasuniversitare të Mjekësisë, Specializim Pasuniversitar në Gastrohepatologji, Kursin e Menaxhimit Spitalor dhe Kursin Strategjik të Udhëheqjes Mjekësore në Shtetet e Bashkuara, një kurs specializimi në mjekësi dhe një kurs shëndetësor në Greqi.

Z. Begaj ka shërbyer më parë si Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura Shqiptare. Ai ka mbajtur poste të tjera të ndryshme duke përfshirë: shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendës drejtor Ushtarak i USHT-së, drejtor i Spitalit Ushtarak, drejtor i Inspektoratit Shëndetësor etj. Ai u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare në korrik të vitit 2020. Më 4 qershor 2022 është zgjedhur president i 8-të i Shqipërisë.



## 27 Gjeneral brigade Arben Kingji

Gjeneral brigade Arben Kingji, është lindur më 22 dhjetor 1970, në Kukës. Ai u diplomua në Akademinë e Forcave të Armatosura Shqiptare në Tiranë, në vitin 1993 dhe është komanduar si komandant toge në Repartin Ushtarak 9001. Ka një diplomë pasuniversitare në Ligjshmëri nga Universiteti “Wisdom”. Pas diplomimit ka shërbyer komandant toge, instruktor taktik; drejtues i Grupit Special në Batalionin Komando; shef në Batalionin e Forcave Speciale; zëvendëskomandant i Batalionit Forcave Speciale; Oficer Shtabi për Trajnim dhe Vlerësim në Forcën e Përbashkët; komandant i Batalionit të 3-të në Forcën Tokësore; komandant i Brigadës Mbështetëse të SHP; komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake, komandant i Forcës Tokësore, ka shërbyer në katër misione jashtë vendit: në gusht 2002 - shkurt 2003 si komandant i kontingjentit shqiptar në Afganistan; mars 2006 - shtator 2006, komandant kontingjenti shqiptar në Irak; korrik 2009 - janar 2010, si komandant kontingjenti shqiptar në Afganistan; janar 2012 - korrik 2012 si komandant kontingjenti shqiptar në Afganistan. Ka qenë Atashe Ushtarak rezident në Rumani. Ai është diplomuar në Kursin e SHP, KLO, KLSM, si dhe kualifikime të tjera si Kursin e Standardeve të NATO-s; Kursin e Trajnimit CIMIC; Kurs Orientimi për Kontrollin e Armëve; Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit; Kursi i Mbrojtjes dhe Sigurisë Personale; Kursi i Forcave Speciale, Kursi Bazë Komando. Gjeneral Kingji është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij të gjatë ushtarake, si Medaljen për shërbime të shquara nga MM; Medalja e Shërbimit; Medaljen e Shërbimit të Merituar, dhënë nga SHBA-të; Medalja NATO - ISAF; Medalja e Shërbimit Ndërkombëtar, dhënë nga Ministria e Mbrojtjes; Medalja e Karrierës; Medalje për shërbime të veçanta; dhe Medalja “Shqiponja e Artë” e dhënë nga Presidenti i Republikës.



# Shtypi ushtarak, artilera e rëndë e ndërgjegjes, drejt shekullimit të tij




**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit të Botimeve, Kryeredaktore

**U**shtria ka nevojë për shtypin e vet sepse e mban publikun e gjerë të afërt me realitetin dhe me jetën ushtarake. Është pikërisht profesioni i gazetarit që jep lidhjet e plota të mjedisit dhe aktivitetëve. Është gazeta ajo që jep në mënyrën më të gjallë atë që ndodh. Studiuesit e historisë mund t'i referohen këtyre gaz-

etave ashtu siç edhe e kanë bërë sepse në gazeta mbetet i fiksuar aktiviteti i ushtrisë dhe ai i një kohe të caktuar. Një kuadër që drejton ushtrinë mund ta njohë realitetin e jetës ushtarake në mënyra të ndryshme, por padyshim që një mënyrë shumë e mirë dhe efektive është informimi nëpërmjet shtypit. Ky informim mund ta ndihmojë atë për të pasur një perceptim sa më të saktë për ushtrinë. Në ushtri duhet të ekzistojë patjetër dhe të fuqizohet ndërgjegjja. Ushtria bazohet në vetitë morale të cilat janë fuqia më e madhe për njerëzit nën uniformën e gjelbër. Janë bërë studime të panumërta në lidhje me këtë fuqi dhe këtë gjë e ka provuar historia e njerëzimit prej mijëra vjetësh. Kohezioni, forca që e mban një ushtri është morali. Çdo drejtues duhet të studiojë elementin e moralit. Gazeta është një nga format më të mira për këtë lloj drejtimi, pasi artikujt nuk janë thjesht informativë por janë edhe formues. Në shtypin e përditshëm mund të thuhet çdo gjë, shpesh dhe dezinformuese, por në shtypin ushtarak ka një format i cili nëpërmjet botimeve të shkrimeve i shërben unitetit.

Të gjitha këto zhvillime duhet të ecin në mënyrë të shëndoshë dhe t'i shërbejnë qëllimit të forcimit ushtarak. Kjo është domosdoshmëria e shtypit ushtarak dhe forma që duhet të ketë ai. Të gjitha ushtritë kanë traditën e tyre të



GAZETA ËSHTË NJË NGA FORMAT MË TË MIRA PËR KËTË LLOJ DREJTIMI, PASI ARTIKUJT NUK JANË THJESHT INFORMATIVË POR JANË EDHE FORMUES. NË SHTYPIN E PËRDITSHËM MUND TË THUHET ÇDO GJË, SHPESH DHE DEZINFORMUESE, POR NË SHTYPIN USHTARAK KA NJË FORMAT I CILI NËPËRMJET BOTIMEVE TË SHKRIMEVE I SHËRBEN UNITETIT.



TË GJITHA USHTRITË KANË TRADITËN E TYRE TË SHTYPIT, ASHTU SI DHE NE KEMI TRADITËN TONË, E CILA ËSHTË NJË TRADITË E LAVDISHME. NUK DUHET TË HARROJMË GJENEZËN TONË DHE MBI TË GJITHA NUK DUHET TË HARROJMË VLAGËN PATRIOTIKE, E CILA NA BËN TË JEMI SHQIPTARË.

shtypit, ashtu si dhe ne kemi traditën tonë, e cila është një traditë e lavdishme. Nuk duhet të harrojmë gjenezën tonë dhe mbi të gjitha nuk duhet të harrojmë vlagën patriotike e cila na bën të jemi shqiptarë. Këtë vlagë duhet të ketë gazetaria ushtarake dhe fryma e ushtrisë duhet të jetë e ushqyer pikërisht me këtë vlagë patriotike.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare u realizua shtypi duke rrezikuar edhe jetën që ai të dilte në qarkullim, pasi ai ishte një armë e fuqishme. Mund të përmendet rasti i UÇK-së, e cila e

krijoi shtypin në kulmin e luftës, "Agjencia Kosova Press", "Radio Kosova e Lirë", gazeta etj., të rrethuar nga serbët, vetëm që të jepnin mesazhin e luftës dhe optimizmin e fitores. Pse? Sepse ishte një armë e domosdoshme e pazëvendësueshme, një armë e cila në luftë ka dalë nga gjaku, sepse ka shkruar për ata që dhanë jetën për atdheun, sepse është shkruar në llogore, mes borës e plumbave për të treguar sakrificën njerëzore më sublime, vetëmohimin për tokën e të parëve dhe për



gjënë më të shtrenjtë, lirinë. Nëse do të shkatërrosh një ushtri, shkatërroi moralin, shkatërroi shtypin, informimin dhe formimin edukativ dhe ia ke dalë. Kjo është rëndësia e shtypit. Shtypi ushtarak ka historinë e vet. Kjo histori fillon në vitet e lavdishme të Luftës Nacional-çlirimtare. Ajo ishte një luftë e të gjithë popullit shqiptar, ku u ngrit i madh e i vogël për të çliruar vendin nga pushtimi. Janë 70 mijë partizanë e partizane që morën pjesë dhe nuk është pak të jenë 6 mijë gra e vajza në luftë. Ne ishim një popull i vogël dhe këtë sakrificë të madhe para së cilës u vumë në LIIB, nuk mund ta përballonim dot vetëm me burrat, prandaj iu bë thirrje edhe grave e vajzave. Ato u rreshtuan bashkë me vëllezërit e tyre dhe luftuan jo më pak se ata. Kështu, me një frymë të thellë patriotike ato luftuan deri në ekstrem. Në qoftë se në LIIB janë varur vetëm pesë vajza në botë, katër prej tyre kanë qenë shqiptare. Pushkatime ka pasur shumë, por varje janë vetëm këto raste. Kështu, në këtë luftë të madhe, kërkohej edhe një përgjithësim i shembullit të këtyre njerëzve që luftonin me vetëmohim. Në këtë mënyrë lindi nevoja që të kishte edhe organe të shtypit. Pa të cilin brezat nuk do të njihnin historinë e tyre, rrënjët e të parëve.

### **90 vjet revista "Mbrojtja"**

Shtypi ushtarak e ka zanafillën e vet në majin e vitit 1931, kur dritën e botimit e pa numri i parë i revistës ushtarake "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake". Kjo ishte e para revistë ushtarake në Shqipëri, gjatë gjithë historisë 110-vjeçare të Ushtrisë Shqiptare. Në faqet e saj zunë vend artikuj të ndryshëm që kishin të bënin për ushtrinë, reformat, organizimin, protagonistët dhe modernizimin e saj, njëkohësisht u trajtuan edhe probleme teorike të ushtrisë, të teknikës ushtarake si dhe ngjarje dhe lajme të huaja. Revista dilte një herë në muaj dhe u quajt e përkohshme. Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, të cilat gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Ajo doli me 24 faqe.

Më pas në kohë, vendin e saj e zuri "Revista ushtarake", me 60 faqe, që ishte vazhdim i saj. U botuan numrat 78-91, vetëm në gjuhën shqipe.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore kryesisht shtypi ushtarak u përbë nga gazetat e botuara nga shumë formacione luftarake partizane si "Përpara në sulm", "Buçitja", "Ylli çlirimtar", "Pishtari", "Zëri i luftëtarit", "Horizonti në ndriçim", "Përpara", "Zëri i të riut", të cilat kishin kryesisht karakter politik por edhe disi ushtarak. Autorë, që me shkrimet e tyre mbushën këtë shtyp, ishin kryesisht: Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj., që më vonë u bënë shkrimtarë të njohur. Këta ishin gazetarët e parë të shtypit të luftës të viteve '43-'44.

Pjesë e këtij shtypi ishte edhe gazeta "Mundimi", organ politik, propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, botohej e përjavshme me dy faqe. Gazeta më tepër ishte informative dhe botohej në Bari, por shpërnda-

hej në Shqipëri.

Që në vitin 1945 dolën dhe organet e para ushtarake. "Luftëtari", numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë. Gazetë me katër faqe, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të vendit. Ndërsa gazeta me këtë emër doli rregullisht që nga maji i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, duke mbetur në thelb një gazetë ushtarake, me praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake. Gazeta e pushoi jetën e saj në vitin 1991, në kohën e ndryshimeve të mëdha demokratike që ndodhën në vend, për të vazhduar më tej me ushtrinë. Më pas u vijua botimi i saj, me tituj të ndryshëm, si "Ushtria dhe Koha" dhe që nga viti 1997 u titullua "Ushtria". Në fund të viteve '40, shtypit ushtarak të shkruar iu shtua edhe Revista "10 Korriku", e cila ishte një revistë ilustrimi dhe më e afërt dhe më e drejtpërdrejtë me ushtarakët shqiptarë. Ndërsa botimi më profesional ushtarak ishte "Revista ushtarake", e cila u botua në vitin 1948, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Revista trajtonte probleme teorike ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda si dhe tema të ndryshme ndërkombëtare apo edhe tema historike etj. Më pas vijoi të botohej me tituj të ndryshëm si "Revista ushtarako-politike" (1954-1967) apo "Revista politiko-ushtarake", fill pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri. Ndërsa revista tjetër e titulluar, "Për mbrojtjen e atdheut", nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, deri në vitin 1991, kur pushoi edhe ajo jetën e saj, e në thelb revista trajtonte po ato probleme dhe njëkohësisht mbeti një propaganduese e pastër e politikës së asaj periudhe për edukimin politiko-ushtarak të kuadrove të lartë.

Botimit të organeve të shtypit ushtarak, u është dhënë rëndësi prioritare që në momentet e para të historisë së Shtetit Shqiptar, nga vetë figurat udhëheqëse të Shqipërisë. Ahmet Zogu orientoi ndërtimin e një reviste ushtarake, duke kërkuar ndihmën edhe të oficerëve italianë. Më pas, figura kryesore politike e Shqipërisë së asaj kohe, gjeneralkolonel Enver Hoxha urdhëron hapjen e revistës "Mbrojtja". Pas viteve '90 me një VKM ripërcaktohet botimi i këtij organi dhe i shtypit ushtarak në tërësi (pa shfuqizuar gjë). Rëndësia që u ishte kushtuar këtyre botimeve shtetërore, si organe qendrore, unike, zyrtare të MM ishte prioritare. Ndërkohë, shtypi ushtarak përfaqësohet tashmë, nga gazeta "Ushtria", revista "Mbrojtja" por edhe "REVISTA USHTARAKE", organ tekniko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura.

Në të gjithë periudhën thuajse shekullore që është botuar, ka përligjur ekzistencën e saj, pasi ka qenë i nevojshëm publikimi i mendimeve teorike, shkencore, ushtarake, analitike, dokumentare etj. Ajo ka qenë një tribunë e krerëve të Mbrojtjes.

### **Shtypi ushtarak, zëri në kohë i FA-ve**

Forcat e Armatosura kanë simbolikën e tyre. Nuk ka as shtete as ushtri pa simbole e pa identitet. Shtypi ushtarak (Revista "Mbrojtja" një nga shtyllat) përbën një simbol të fuqishëm kombëtar, si simbol qendror i botimeve zyrtare të FA-së e MM-së.

# Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit  
Janar 2022/ Nr. 1



## VJET REVISTA "MBROJTJA"

Ekziston një detyrim sa i shkruar edhe i pa shkruar që çdo shoqëri ka për të dokumentuar ekzistencën e saj. FA-të dhe MM në 110 vite shtet, më mirë se në faqet e shtypit ushtarak, revista "Mbrojtja" dhe gazeta "Ushtria", nuk e kanë të pasqyruar askund aktivitetin e tyre zyrtar. Këtë e dëshmojnë arkivat shtetërore dhe ushtarake si dhe bibliotekat kombëtare apo dhe ajo e FA-së.

Shtypi Ushtarak sot është një institucion me orientim të qartë euroatlantik, me profil perëndimor, zëri dhe imazhi i një Force të Armatosur solide operacionale, misionare në veprim, zëri i Forcave të Armatosura Shqiptare, që kanë shkruar histori suksesi si partnere të denja në NATO.

Mediat dhe ofruesit e tjerë të informacionit janë thelbësorë për demokracinë dhe qeverisjen e mirë, si një platformë për

diskursin demokratik dhe si ofrues i informatave dhe njohurive. Nëse mediat duhet të mbështesin demokracinë, qytetarët duhet të kuptojnë se si t'i përdorin ato në mënyrë kritike, duke ditur se si të interpretojnë informacionet që marrin, duke përfshirë përdorimin e metaforave, ironisë dhe mënyrën se si lajmet dhe ngjarjet janë përshtatur për të sugjeruar kuptime të veçanta. Gjatë kësaj periudhe ajo ka pasqyruar veprimtarinë dhe aktivitetin e Forcave të Armatosura, krijimin, transformimin, ristrukturimin dhe modernizimin e saj, me të gjitha problematikat dhe sukseset, me të gjitha vështirësitë dhe sakrificat.

Shtypi Ushtarak ka një detyrë të madhe, atë të komunikimit dhe të bërit të njohur të modeleve më të mira të sjelljes, të përkushtimit dhe të sakrificës së ushtarakut tonë të FA.

# KRIJIMI I USHTRISË KOMBËTARE SHQIPTARE

## NGA QEVERIA E PËRKOHSHME E VLORËS (1912-1914)



SALI ONUZI  
Kolonel (R)



**Më 4 dhjetor 1912,  
Kuvendi i Vlorës  
zgjodhi Qeverinë  
e Përkohshme dhe  
Ismail bej Vlorën  
kryeministër.**

Sigurimi i Kuvendit kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë, kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim, Ismail Qemali, më 26 nëntor, formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore me anën e së cilës porositeshin të mobilizonin njerëzit e aftë për armë dhe t'i mbanin ata në gatishmëri.

Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi Qeverinë e Përkohshme dhe Ismail bej Vlorën kryeministër. Po atë ditë u zgjodh ministër i Luftës Mehmet Pashë Dëralla. Nga struktura dhe përbërja e Ministrisë së Luftës njohim pozicionin e zëvendësministrit të Luftës, në të cilin u caktua Xhelal Koprencka dhe të disa komandantëve ushtarakë, si Isa Boletini, Hajredin bej Cakrani, Riza bej Gjakova etj. Pas formimit të saj, Qeveria dërgoi një forcë të vogël të armatosur me vullnetarë patriotë (vullnetarë kosovarë) të ruanin bregun e Vjosës. Ajo ngriti komisione të mbrojtjes kombëtare nëpër krahina dhe urdhëroi mobilizimin e batalioneve Redif e Mustafëz për mbrojtjen nga forcat greke që kishin ardhur deri në Himarë. Kërkesa e saj për të çarmatosur ushtarët turq në Myzeqe e për të armatosur ushtarë shqiptarë nuk u pranua as nga Turqia e as





nga Austro-Hungaria e Italia.

Në janar 1913, Qeveria kish ngritur dhe armën e Xhandarmërisë, e cila në fund të vitit numëronte 4 detashmente me nga 300 xhandarë secili.

Por puna e mbrojtjes do të kishte një hop në fillim të majit 1913.

Më 5 maj 1913 (më 22 prill, sipas kalendarit të vjetër) Qeveria e Përkohshme e Vlorës do të diskutonte e miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës.

Në përbërje të Ministrisë së Luftës do të ishte Shtati (Shtabi) Madhor. Për shkak të njohjes dhe kredibilitetit që gëzonte, Major Ali Shefqeti do të emërohej në detyrën e lartë e të nderuar të Kryetarit të këtij Shtabi. Kjo ishte bërë e domosdoshme sepse kishin kaluar 5 muaj që Ministria e Luftës (nga 4 dhjetori 1912) funksiononte pa një akt themelor normativ (me siguri në bazë urdhrash të veçantë për çështje konkrete që dilnin). Ministria e Luftës do të kishte gjithashtu edhe zyrën Qertare (të prapavijës, apo intendencës), zyrën

Hertare (të organizimit e personelit) dhe zyrën Shëndetare, të cilat në disa artikuj e botime janë dhënë tjetër për tjetër. Që kishte një zyrë të tillë të Intendencës në Ministrinë e Luftës, e shkruan vetë Ali Shefqeti në një shkresë dërguar Ministrisë së Financave. E gjejmë edhe në një shkresë të 29 marsit 1914 për uniformat e oficerëve dhe ushtarëve, drejtuar gjeneralit holandez Dever, firmosur dhe vulosur po me atë vulë, "Qarku Qerta".

Në nyjën e dytë të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej edhe ndërtimi i brendshëm i vetë Shtabit Madhor, i cili, nga ana e tij përbëhej nga: 1. Qarqet e Shtabit Madhor (të themi drejtori, a departamente); 2. Shkresina e Shtabit Madhor (Sekretari arkivi); 3. Komisioni i rregulloreve; 4. Komisioni i trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë dhe 5. Komisioni i ndërtimit (a xhenios, si të thuash).

Rregullorja në mënyrë sintetike kish fiksuar edhe detyrat e të drejtat e Shtabit. Në nyjën 4 të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej se: "Zyra e Shtabit

Madhor asht e detyrueme për me i rradhit nomet, rregulloret dhe ushtrimoret e Armëve të ndryshme që i duhen ushtërisë dhe për me e sigurue disiplinën e ushtërisë e qetësinë e vendit".

Rregullorja kërkonte që, deri sa të bëhej Organizmi themelor, Qarqet e Shtabit Madhor do të vepronin si një Komision, i cili do të studionte projektet që do t' i paraqiteshin, të cilat edhe mund t' i ndryshonte dhe, bashkë me raportin përkatës, do t'ia kalonte Qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Luftës. Kështu vetë Shtabi Madhor vepronte në fillimet e tij si një Komision (Qark). Kjo del dhe nga vula që përdorte Qarku i Shtatit Madhor (1913), në një shkresë të firmosur nga Kryetari i Shtatmadhorisë, Ali Shefqeti. Ky është padyshim një tregues i gjendjes së vështirë financiare, në mos, edhe i mungesës së kuadrove përkatës, të cilët duhej të qenë të diplomuar si oficerë Shtabi. Në Vlorë ishin paraqitur e vënë në dispozicion të Qeverisë 70 oficerë dhe 150 nënoficerë shqiptarë.

Shtabi Madhor do të hartonte edhe projekt-detyrat e raportet e Zyrave të tjera, të cilat ai i konsultonte me to (ndryshoheshin kur duhej), i parapëlqente (ose jo) dhe ia kalonte gjithashtu Ministrisë së Luftës. Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor që më 1913, tregon se ndërtimi i Ushtrisë së rregullt filloi nga lart poshtë, karakteristikë për një shtet ligjor, modern.

Rregullorja e përkohshme e Ministrisë së Luftës, në nyjën 7 të saj përcaktonte se "Do të ishin në veprim nomet (ligjet) e Turqisë deri sa të radhiteshin nomet (ligjet) dhe rregulloret e reja". Kjo ndodhi edhe në organizmin ushtarak, ku mbet në fuqi dhe u zbatua ligji për mobilizimin e redifëve (rezervistëve) dhe mustafëzëve (forca vendore territoriale), që kishin qenë para shpalljes së Pavarësisë. Këto batalione u mobilizuan dhe luftuan kundër reparteve të ushtrisë greke që po përparonin në Shqipërinë e jugut. Në krye të tyre në terren ndodhej Xhelal Koprencka (firmosës i Pavarësisë), zëvendësministri i Ministrisë së Luftës. Komandantë të batalioneve me redifë (rezervistë) ose mustafëz (territorial) ishin vetë bejlerët, të zotët e bujqve ushtarë, që veç komandimit, përgjigjeshin edhe për logjistikën dhe ndërrimin e



batalioneve në front. Hajredin bej Cakrani, njëri nga firmosësit e deklaratës së Pavarësisë dhe feudal i madh nga Cakrani i Mallakastrës, që kishte mbaruar studimet e larta ushtarake në Stamboll, ai kishte qenë para 28 nëntorit dhe ishte edhe pas tij, komandant i batalionit “mustafëzëve” të Lushnjës, plus dhe komandant i operacionit qeveritar në front kundër grekëve. Për këto reparte dhe veprimtarinë e tyre pothuajse nuk bëhet fjalë në tekstet e historisë, por ato shkrihen e shihen thujse të gjitha si “forca vullnetare”, kur në fakt ato kishin detyrim ligjor, po se po patriotik, të shërbenin e luftonin, siç edhe bënë një pjesë e mirë e tyre, batalionet e Beratit, Mallakastrës, Skraparit, Tepelenës, Përmetit, Leskovikut e Gjirokastrës, në jug kundër pushtuesve grekë dhe në Shkodër redifët dhe mustafëzët nga Shqipëria e Mesme, (Shijaku, Tirana, Kavaja e Elbasani) dhe nga Shkodra e Dibra, kundër pushtuesve malazezë.

Por në praktikë nuk shkonte gjithçka siç shkruhej. Ministri i Luftës Mehmet Pashë Dëralla, më 31 janar 1914, i shkruante komandës së bylykut të Dukatit që të dërgonte emrat e 57 redifëve (rezervistë) që ishin nisur për të pasur nën këqyrje pozitën e Llogorasë dhe, siç kish raportuar ajo vetë, ishin arratisur. Më 2 shkurt, komandanti i batalionit Alem Mehmeti njoftonte se atje nuk kish mbetur asnjë redif. Edhe komandanti i batalionit mustafëzëve, Sadullai i shkruante, më 7 dhjetor 1912, Ministrisë së Luftës, se 200 ushtarët që pati, 100 në Delvinë e 100 në Sarandë, ishin arratisur nga mungesa e ushqimit dhe ai ishte kthyer në Tepelenë vetëm me ordinancën e tij. Kajmekani i Vlorës Mustaf Asimi njoftonte, më 15 dhjetor 1912, se ushtria popullore që ndodhet në anë të Mesaplikut ka mungesa municioni e ushqimi, e sidomos rregulli e disipline, dhe... armiku iu bën thirrje për dorëzim. Sidoqoftë këto mangësi nuk e zhvlerësojnë punën që ishte bërë për krijimin e ushtrisë dhe veprimin e saj në terren.

Përpjekjet e Qeverisë vijojnë më tej. Kryetari i Shtabit Madhor, Ali Shefqeti (Shkupi), më 3 qershor 1913, i përcjell për studim Ministrinë të Punëve të Brendshme, Myfit bej Libohovës, variantin e parë të rregullores së Milicisë shqiptare (para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave).





Kjo Rregullore sot gjendet në Arkivin e shtetit shqiptar, si një dëshmitare e punës së Shtabit madhor të atëherëshëm, madje edhe është botuar e bërë publike. Edhe konsulli austro-hungarez Lejhaetz, njoftonte Vjenën se Zyra (e Shtabit Madhor) hartoi “Rregulloren mbi formimin e Milicisë shqiptare”, sipas së cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohet një ushtri e rregullt.

Më pas del Urdhri për formimin e Kompanisë këmbësore model të ushtrisë, ku shtrohet edhe nevoja e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Nga informacioni i konsullit Lejhanetz del se: “Administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake europiane, pastaj të vendoste, ose të merrte njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri, të vetin, që u përshtatej kushteve të vendit. Prandaj konsulli i përcillte Vjenës lutjen e kësaj administrate për t’i vënë sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen dhe shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë...., si këmbësoria, kalorësia, artilleria, xhenioja, prapavija dhe shëndetësia”.

Në fakt brenda 26 ditëve nga krijimi i Shtabit, më 31 maj 1913, Kryetari i tij informonte ministrinë e Luftës, mbi punën që po bëhej për krijimin e kompanisë model të Ushtrisë, sipas të cilës do të ndërtohej Ushtria Kombëtare. Aty shtrohej edhe nevoja e fillimit së afërmi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Më 4 shtator, gazeta “Dielli” në SHBA shkruante se: “Qeveria mbledh ushtarë me 240 grosh në muaj, jo me pahir, po cili do vetë. ... Flitet se Guberna shqiptare do të mbledhë gjer në 20 mijë veta, të cilët do të jenë të veshur, mbathur dhe armatisur mirë, me topa, mitraloza dhe municione etj.”

Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Po në “Dielli”, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlora njoftohej se: “Në Vlorë janë tre taborë (batalione S.O) ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armatisur dhe të stërvitur mirë, me topa etj. ...Janë edhe 7 çeta shqiptare (pra vullnetare) të organizuara

fare mirë, të cilat kanë 300-500 njerëz njëra. Kryetarët e çetave janë këta: Mehmet Pavari, Nexhip Bënja, Salih Butka, Dino Çiçi Gjinokastra, Namik Delvina, kapedan Spiro Korça dhe Çerçiz Topulli”.

Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte

“

**Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Po në “Dielli”, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlora njoftohej se: “Në Vlorë janë tre taborë (batalione S.O) ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armatisur dhe të stërvitur mirë, me topa etj. ...**

me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake, dërgim oficerësh, armatimi e municioni në territore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave pushtuese greke dhe në Dibër, ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t’i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë.”

Që më 1913, Shtabi Madhor i pat hyrë një punë të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje ai pat angazhuar një komision të posaçëm, në të cilin bënin pjesë oficerë të kulturuar si Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejдини (dëshmor i atdheut nga Elbasani), ish-profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma që përdorim sot në fushën ushtarake.

Por puna e Qeverisë së Vlorës për Ushtrinë do të vështirësohej pas Vendimit të Konferencës së Ambasadorëve







"Shtëpia e Hamzarajve", vizatim Zamir Mati  
Koleksion i familjes



të 29 korrikut 1913, i cili ndonëse njëhte shtetin shqiptar (nën garancinë e Fuqive të Mëdha), e vinte atë nën kontrollin e një Komisioni Ndërkombëtar që ngarkohej për organizimin e gjithë degëve të administratës civile (por jo dhe asaj ushtarake), ashtu siç caktoi oficerë të huaj për organizimin vetëm të xhandarmërisë. Efektet negative të mungesës së organizimit ushtarak do të ndjeheshin fort në ngjarjet tronditëse e tragjike të vitit 1914, ndërkohë që garancia e Fuqive të Mëdha u shkri si kripa në ujë.

Historiografia zyrtare shqiptare nuk e ka evidentuar dhe vlerësuar sa duhet veprimtarinë ushtarake të Qeverisë së Vlorës. Prof. Arben Puto në "Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914", i referohet vetëm konsullit Lejhanetz për një "zyrë të shtatmadhorisë", që me nënvleftësim e quante njëllor organi ushtarak i Qeverisë së përkohshme, kur ai ishte një organ i vërtetë ushtarak. Për më keq teksti i Akademisë ushtarake, i vitit

1986, as nuk e përmend këtë "Zyrë shtatmadhorie". Prof. Arben Puto, konkludon se Qeveria e Vlorës mori disa masa organizative paraprake, por nuk arriti asnjëherë të krijonte as dhe bërthamën e një ushtrie kombëtare. Ndërsa teksti akademik i Historisë, i vitit 2002, ripërsërit konsullin austriak dhe e quan krijimin e një ushtrie të rregullt një "objektiv i parakohshëm, i porealizueshëm në ato rrethana. Po këtë shkruan edhe "Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit të XX".

Ky mendim për administratën ushtarake nuk na duket bindës dhe mendojmë se duhet hetuar e diskutuar më tej. Në kujtimet e tij Ismail Qemali shkruan se: "Si u ktheva (nga Londra, S.O) në Vlorë, në qershor 1913, Qeveria e përkohshme i dyfishoi përpjekjet për organizimin e vendit dhe për ruajtjen e rendit. Mund të ishin quajtur fare mirë detyra të pamundshme për t'u kryer, por punën e bënte më të lehtë karakteri i shqiptarit - durimin, maturinë dhe patriotizmin e paepur të

të cilit, mes gjithë atyre ngatërresave e halleve, nuk ka fjalë e lëvdatë që ta përshkruajë. Pikërisht falë virtyeteve të kësaj race....qeveria ime ia doli mbanë t'i sjellë stabilitet shtetit dhe të sigurojë një administratë normale".

Krijimi i Ministrisë së Luftës, i Shtabit Madhor, i bazës ligjore e normative, krijimi i xhandarmërisë, mobilizimi në luftë i disa batalioneve redifë e muztafëz, plus tri kompanive me nizamë shqiptarë, krijimi i një kompanie model të ushtrisë së rregullt dhe nën shembullin e saj të tre batalioneve me ushtarë aktiv, dhe një grupi me 120 kalorës, a nuk përbënin këto një bërthamë të ushtrisë së rregullt, apo një ushtri të vogël në numër? Kjo veprimtari nuk mbeti vetëm në disa masa organizative paraprake.

Ngritja e Ushtrisë së rregullt dhe asaj të përhershme ishin një nevojë e kohës, por ato nuk u realizuan sipas parashikimeve, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat u detyrua të vepronte Qeveria,



të mosnjohjes së saj nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha si qeveri kombëtare e të ndërhyrjeve të tyre të padrejta. Qeveria e Vlorës vepronte në një territor të lirë, të çliruar dhe në kushte lufte me pushtues të egër. Ajo nuk kish pse të vonohej, forcat ushtarake ishin një detyrë urgjente e kohës dhe ajo iu përgjigj asaj me sa mundësi pati.

Ndërkohë duhet shënuar se batalionet me redifë dhe ato mustafëz, brenda territorit ku shtrinte veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës në fakt i përkisnin një ushtrie të rregullt, sepse ishin organizuar mbi bazën e ligjit ushtarak, me organika standard, për moshën e pjesëmarrësve, numrin e tyre, komandën, uniformën dhe armët që i mbanin në magazinat e ushtrisë etj. Fakti që nuk ishin forca aktive, të përhershme, d.m.th. nizamë, apo ushtarë aktiv, nuk i bënë ato ushtri (forcë) e parregullt. Ato edhe sot janë pjesë e Forcave të armatosura në katër anët e Botës. Shtu këtu dhe faktin që Qeveria kishte vendosur, më 13 janar

“

**Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmanky dhe gjermanit Clanner, të cilët, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmanky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Clanner vizitoi Shqipërinë e Jugut.**

1913, dhe realizoi krijimin e armës së xhandarmërisë. Kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit edhe ushtar i luftës, një forcë ende e pa diferencuar. Pra ishte pjesë e ushtrisë së rregullt. Prandaj edhe në përbërjen e Shtabit Madhor kishte një Komision të trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë. Diferencimi i kësaj arme, ndarja e xhandarmërisë nga policia dhe ushtria u bë më vonë, deri në vitin 1920.

Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmanky dhe gjermanit Clanner, të cilët siç shkruan prof. as. dr. Marenglen Kasmir, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmanky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Clanner vizitoi Shqipërinë e Jugut. Raporti që ata hartuan mbi vizitën e tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm dhe të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Vidit, si për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë”. Dy kapitenët në raportin e tyre shkruajnë: “Qeveria e Ismail Qemalit, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si Qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë europiane. Në të vërtetë ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit”.

“Qeveria, - shkruajnë autorët, - kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj (nënvizimi im S.O), kishte një forcë ushtarake, me një Ministri Luftë si dhe një Shtab Madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit. Krahasuar me qeveritë e tjera lokale, ajo e Vlorës kishte të ardhurat më të mira si pasojë e vjeljes së taksave portuale... Brenda vendit mbizotëronte një farë qetësie e rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në të gjithë vendin.”

Ky raport i dy kapitenëve austro-hungarez e gjerman, nga dy vende të njohura për organizimin modern ushtarak në Europë, dhe përfundimi i tyre se Qeveria e përkohshme e Vlorës kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, mendojmë se vlen shumë për çështjen që po trajtojmë dhe mund të themi se i vë kapak asaj. Ndërkohë nuk duhet të harrojmë se kjo ushtri nuk ishte një ushtri evidencash dhe rrogëtarësh, por një forcë që kish luftuar e luftonte në front për të ndalur përparimin e forcave sidomos greke për të pushtuar Vlorën e territore të tjera nën autoritetin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe që përkrahte, aq sa kishte mundësi, edhe me oficerë, armatim e municion kryengritjen e Dibrës të shtatorit 1913.

# Ngritja e Ushtrisë, Institucioneve të Mbrojtjes dhe Sigurisë, 1925-1939



DR. ASLLAN ZEMANI

**H**istoria e Shqipërisë dhe e popullit tonë, jo vetëm ka qenë e mbushur me luftëra të shumta e të njëpasnjëshme për mbrojtjen e trojeve, të lirisë, që kanë siguruar mbijetesën e tij por, njëkohësisht edhe me personazhe të ndryshëm, aktorët politikë apo shtetërore, të cilët si pjesë e saj, kanë lënë gjurmë të thella e kthesa historike, duke u kthyer në pika referimi historik për patriotizmin dhe përkushtimin ndaj interesave kombëtare.

Në fillimet e viteve njëzet, situata politike dhe ekonomike e Shqipërisë ishte tejet e vështirë, gjë që pasqyrohej edhe në Ushtri. Këtë gjendje e ka përshkruar me shumë realizëm një personalitet i politikës, i historisë dhe i letrave shqipe, Ekrem Vlora. Ai, midis të tjerave ka shpjeguar edhe ndërhyrjet e politikës dhe të partive në punët e brendshme të Ushtrisë Shqiptare. Madje, ai ka shkruar edhe për oficerët shqiptarë të asaj kohe, të vitit 1922 që, "... nuk ishin çliruar nga mendësia e mer-

cenarit dhe psikologjia e Turqve të Rinj...". Në këtë rast ai e kishte fjalën pikërisht për servilizmin dhe vartësinë që kishte krijuar trupa e ushtarakëve nga politika e partive, e cila kishte depërtuar dukshëm edhe në radhët e tyre.

Vitet 1921, 1922, 1923 dhe 1924, qenë të mbushura me lëvizje antiqeveritare për shkak të mungesës së një tradite politike të stabilizuar, të luftës për pushtet dhe, sidomos të mungesës së një shteti demokratik. Po gjatë kësaj periudhe katërveçare lindën dhe u formësuan disa parti politike, të cilat, për shkak të grindjeve, luftës partiake dhe asaj për pushtet i sollën vendit shumë trazira dhe mungesë stabiliteti. Këto përplasje çuan në Revolucionin e Qershorit të vitit 1924, që rrëzoi A. Zogun dhe solli në fuqi një qeveri të kryesuar nga Fan S. Noli, e cila u rrëzua po me përdorimin e forcave ushtarake shqiptare, të ndihmuara nga ato të huaja, duke risjellë në fuqi A. Zogun.

Nuk ka dyshim se Ahmet Zogu, i cili vuri emrin e vet në së paku 15 vjet të historisë shqiptare, përbën një figurë komplekse dhe problematike, me kontribute, por edhe me qëndrime e veprime, të cilat në një gjykim objektiv kanë qenë në dëm të Shqipërisë. Nuk mund të mohohet roli që mund të ketë në konsolidimin e shtetit shqiptar, në forcimin e institucioneve, në përgatitjen dhe miratimin e kodeve themelore, në zgjerimin e rjetit shkollor fillor dhe hapjen e shkollave të para të mesme laike etj. Por kur flitet për Ahmet Zogun, nuk mund të sfumohen, madje nuk ka arsye "për të fshirë nga historia e tij ngjarje apo episode që përfaqësojnë njolla, në qëndrimet ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Domethënë është akti i pakuptimtë i vetë-shpalljes si mbret i shqiptarëve apo aq më shumë, braktisja e vendit në kohën e pushtimit nga Italia fashiste, në prill të vitit 1939".

Më 21 janarin e vitit 1925, Shqipëria u shpall Republikë, e cila, njihet në historinë tonë si Republika e Parë e Shqipërisë e tipit presidencial kurse në fundin e këtij muaji A. Zogu u zgjodh kryetar ose Presidenti i Parë i Republikës. Ai emëronte dhe ç' emëronte të gjithë oficerët e





Fuqive të Armatosura. Ndërsa në artikullin 111 të këtij Statuti përcaktohej se “..shërbimi ushtarak, asht i detyrueshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë”.

Qysh në krye të riorganizimit dhe reformimit u mbajt në qendër të vëmendjes ideja se ato duheshin bërë sipas ligjit dhe rregullave të kohës, që donte të thoshte se ato duhej të mbanin parasysh disa kritere standarde, që zbatoheshin nga shumë ushtri të vendeve europiane. Më herët se të aplikoheshin këto standarde, ndër masat e para që mori drejtuesi i shtetit, Presidenti, që sipas Statutit Themeltar ishte edhe Komandanti i Përgjithshëm i krejt Fuqive të Armatosura të vendit, ishte një më e pazakontë, suprimimi i Ministrisë së Luftës pas afro 12 vjetësh të ekzistencës. Në vend të saj u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Armate (F. të Armatosura), duke synuar, siç thuhej rëndom atë kohë e “lague krejt nga politika” të strukturave të armatosura shqiptare. Kjo masë u ndër mor pasi gjykohej se shumë nga pjesëtarët e tyre kishin qenë bashkuar me Lëvizjen e 16 qershorit 1924. Ushtria ishte spastruar mjaft thellë, aq sa nga 5 700 vetë, më 1924, tanimë numëronte vetëm 1 200 anëtarë.

Një tjetër pikë e Statutit nuk lejonte pas kësaj që ushtarakët të bënin pjesë në Parlament, ndryshe nga deri atëherë. Ndërsa sipas ligjit për zgjedhjen, të 14 marsit 1925, oficerët kishin të drejtën për të kandiduar për deputet, por nuk kishin asnjë siguri për t’u kthyer përsëri në detyrën që kishin pasur në kohën e kandidimit. Por, në të vërtetë përpjekjet e para konkrete për këtë qëllim i kishte ndërmarrë një ndër ministrat e Luftës më reformator të vitit 1921, kolonel Selaudin Said Shkoza. Ai ideoi dhe botoi disa rregullore, midis të cilave edhe ajo për “Depolitizimin e Ushtrisë”. Ndikimi i rolit të ushtarakut në politikë, që ishte i lejuar deri në vitin 1924, u sanksionua në Ligjin për Zgjedhjet, i cili pasoi promovimin e Statutit Themeltar të Republikës së Parë shqiptare.

Në thelb të dyja palët, të dy krahët e politikës, e kishin përdorur Ushtrinë mu në mes të viteve njëzet të shekullit të shkuar(XX), për të marrë dhe rimarrë pushtetin nga duart e njëra-tjetres, por e rëndësishme është ajo që erdhi më pas dhe që u kuptua qartë. Tashmë Ushtria dhe forcat e tjera të armatosura duheshin larguar nga lojërat politike të partive, përndryshe vendi do të njihete dhe pësonte edhe mjaft trauma të tilla të dhimbshme dhe shumë të kushtueshme. Mësimi më i hidhur, por njëherësh më i çmuar, ishte se Ushtria apo Fuqitë e Armatosura duhen përdorur sipas ligjit për të kryer misionin e tyre, me sigurinë e vendit dhe jo nga njërën palë kundër tjetrës!

Në vijim, morën formë dhe spikatën më qartë edhe koncepti dhe mendimi ushtarak për ndërtimin e organizimit, stërvitjen dhe përdorimin e Fuqive të Armatosura dhe të Ushtrisë në veçanti, sipas niveleve bashkëkohore. Pikërisht në këto vite u përvijuan dhe morën forma të qarta tiparet e Ushtrisë Shqiptare, si një ushtri e kohës gjithnjë në kërkim të vetvetes. Ajo hodhi gradualisht bazat e organizimit të mirëfilltë e të qëndrueshëm ushtarak, me një imazh të ri. Përgjatë këtij harku kohor, në përpjekje për t’u integruar me filozofi e konceptime perëndimore, sa më të kohës dhe, natyrisht, duke ruajtur traditën, me veçori e përshtatshmëri kombëtare, u synua dhe u arrit që arkitektura e organizimit, e pajisjes, e armatosjes dhe e përgatitjes së saj, t’u përafrohej atyre, për



aq sa e lejonin rrethanat dhe mundësitë ekonomike, shoqërore, trashëgimia e mentaliteti kombëtar dhe kërcënimin e vijueshëm i shovinistëve fqinjë. Pikërisht në këto vite u bë shkëputja nga mendësitë dhe sistemi mercenar, si dhe nga format e vjetra dhe tradicionale të stërvitjes, duke përzgjedhur dhe zbatuar edhe një infrastrukturë ligjore të nevojshme e të kohës, e cila u plotësua hap pas hapi përmes miratimit të bllokut të ligjeve përcaktues për krijimin, organizimin, pajisjen, arsimimin e kualifikimin, shërbimin ushtarak, trajtimin ekonomik e financiar e deri tek pensionimi apo lirimi i ushtarakëve. Këto ligje, që nga viti 1921 deri më 1939, gjetën mbështetje fillimisht në statute me vlera kombëtare, duke u dhënë atyre edhe fuqinë e duhur ligjore. Njëherësh, u punua për krijimin edhe të një kuadri po kaq të domosdoshëm me rregullore, të cilat rregulluan organizimin, jetën dhe veprimtarinë e Ushtrisë Shqiptare.

Midis të tjerave përcaktohej saktësisht se në planin ushtarak, Kryetari i Republikës ishte njëherësh Komandanti i Përgjithshëm i Fuqive Armate. Ai emëronte dhe ç’ emëronte të gjithë oficerët e Fuqive të Armatosura. Ndërsa në artikullin 111 të këtij Statuti përcaktohej se “..shërbimi ushtarak, asht i detyrueshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë”.

Dekreti i Kryetarit të Republikës në shkurt të vitit 1925 miratoi organikën e re, me pak ndryshime, siç ishin ngritja në gradën nënkolonel Xh. Aranitit dhe shkurtimin e postit të zëvendëskryetarit të Shtabit Madhor. Listat e oficerëve që ishin në dispozicion për t’u vendosur në detyra sipas organikës së re, me dekret dhe të Kryetarit të Republikës, u ndanë në tre grupe.

Në grupin “A” përfshiheshin 113 oficerë me grada të ndryshme, të cilët viheshin në dispozicion për t’u vendosur sipas organikës. Në grupin “B” u veçuan oficerët që do të nxirreshin në pension si dhe pjesa tjetër, u jepej një shpërblym në para. Ndërsa në grupin “C” ishin 139 oficerë, të cilët ishin të larguar së bashku me qeverinë e Nolit e aktualisht ndodheshin jashtë vendit. Kohë pas kohe, gjatë zbatimit të organikës së re u morën përsëri në shërbim aktiv disa oficerë, që kishin dalë në pension ose që u kthyen nga jashtë.

Ndonëse organizmi i Ushtrisë u ideua që të ngrihej mbi themelet e sistemit milic, me përfundimin dhe dekretimin e organikës së re u bë përpjekje, që pjesa që kishte mbetur nga sistemi ekzistues ushtarak, t’i bashkëngjitej sistemit milic.

Në krye të piramidës organizative të ushtrisë qëndronte Komanda e Fuqive Armate, me një personel mjaft të reduktuar. Në përbërje të saj ishte komandanti, sekretari personal i tij (nëntoger) si dhe shoferi. Në krye të kësaj Komande caktohej një oficer karriere, me gradë të lartë dhe

përgatitur profesionalisht. Ai ishte në vartësi të drejtpërdrejtë dhe emërohej nga Kryeministri; kurse pas miratimit të Kushtetutës nga Presidenti. Në vartësi të Komandës së Fuqive Armate bënte pjesë edhe zyra e Intendencës së Përgjithshme (Intendencia e Përgjithshme). Ajo kishte në përbërje të saj: kryetarin (major), zëvendësin e tij (nëntoger), 4 intendentë oficerë, 2 armëtarë, një nga këta aspirant, 3 nënoficerë si dhe 5 ushtarë, që shërbenin si ordinarca.

Hallkë tepër e rëndësishme ishte Shtabi Madhor. Ai përbëhej nga: kryetari, ndihmësi i tij (kapiten klasi I), sekretari (togër), dega personale (e personelit), dega materiale (gazemimit), dega e rekrutimit, drejtorja e kancelarisë, dega e përkthimeve, daktilografistë, 2 shkruer (n/oficerë) si dhe 1 inxhinier. Personeli përbërës i këtyre degëve në shtab ishte i reduktuar dhe nuk i kalonte më tepër se 2 vetë. Kryetari i Shtabit Madhor caktohej oficer karriere, me eksperiencë organizimi, drejtimi e planifikimi dhe njëkohësisht ishte një nga organizatorët e ushtrisë.

Për të siguruar një furnizim të përqendruar e të vazhdueshëm për ushtrinë në vartësi të intendencës mbetej Depoja e Përgjithshme në Tiranë, me në krye drejtorin që ishte oficer me gradë togër e me përbërje ndihmësin e tij si dhe 2 teknikë armëtarë. Element tjetër që kishte vartësi nga Intendencia ishte edhe punëtoria ushtarake. Ajo drejtohej nga 1 oficer (nëntoger). Në përbërje të punëtorisë bënin pjesë edhe 2 nënoficerë (kapterë) si dhe 30 ushtarë. Pjesë përbërëse të Komandës së Fuqive Armate qe edhe banda Muzikore si dhe Shkolla për Përgatitjen e Aspirantëve. Elementë të mbetur nga organizimi ushtarak i mëparshëm ishin edhe tre komandat e grupeve me organikë tepër të reduktuar që ndodheshin në Berat, Tiranë e në Shkodër. Në përbërje organike të këtyre komandave hynin 1 intendencier (aspirant), 1 mjek (kapiten i klasit II), 1 veteriner (togër), 1 armëtar (aspirant), 4 nënoficerë (2 rreshterë e 2 tetarë), 1 ushtar ordinarce. Pranë secilës prej tyre ndodhej edhe reviri ushtarak. Këto komanda, përmbushnin detyra ushtarako-administrative e inspektimi. Pas një viti në përbërje të tyre i vendosen edhe 20 ushtarë. Një element tjetër i përkohshëm mbeti detashmenti rus me këtë përbërje: 9 oficerë, 23 nënoficerë me rrogë e 19 rekrutë.

Sistemi milic, që organizatori i Ushtrisë u përpoq t'ia bashkëngjiste atij paraardhës, do të mundësonte stërvitjen e përgatitjen ushtarake të rekrutëve që shërbenin me pagesë në një kohë relativisht të shkurtër. Komanda e Fuqive Armate për mbrojtjen e vendit, parashikoi që në të 9 qarqet e vendit, ku ndodheshin edhe drejtoritë e mobilizimit, të vendosehin 2 kompani këmbësorie e 1 kompani lëvizëse xhandarmërie. Të tre këto nënreparte, në kuadrin e një mobilizimi të përgjithshëm, do të shërbenin si bërthama për kompletimin e organizimit e 3 batalioneve me një efektivi prej 660 vetash secili, kështu në të gjithë vendin mund të formoheshin 27 batalione. Pra për të vënë në jetë organizimin ushtarak mbi themele të sistemit milic u mendua që të formoheshin 18 kompani stërvitore këmbësorie, 3 kompani mitraljere, 2 bateri artilerie, 1 kompani xhenioje dhe telefoni (ndërlidhje). Për zbatimin e kësaj organike të Ushtrisë për kohë paqeje u parashikua që ajo të kishte në përbërje 144 oficerë, 152 nënoficerë, 2000 ushtarë dhe 164 kuaj.

Sistemi milic që u mendua të zbatohet në Ushtrinë Shqiptare ishte mjaft i kushtueshëm dhe një barrë e rëndë për buxhetin e kufizuar të shtetit shqiptar. Për këto shkaqe nuk u pa e arsyeshme që të zbatohet kjo ide, ashtu siç ishte parashikuar. Skema e këtij organizimi u praktikua në mënyrë të reduktuar si më poshtë: nga 18 kompanitë e instruksionit u krijuan vetëm 9 prej tyre, si dhe 3 kompani mitraljere e 2 bateri artilerie. Për të siguruar ruajtjen e bregdetit tonë, në fund të vitit 1925, Parlamenti miratoi një fond të veçantë "...për blerjen e mbajtjen e 2 vaporeve" nga 190 ton. Të pagëzuar me emrat "Shqipnia" e "Skënderbej" e me efektivi ushtarak shqiptar në bord ata filluan të kryenin detyra patrullimi, qysh në shkurt-mars 1926.

Pas Paktit të Dytë të Tiranës e në vijim të ndihmës ushtarake italiane, në



vitin 1928 pala italiane dhuroi 6 motoskafe (MS) ose masa kundër-nëndetëse të tipit "Elco" amerikane. Këto anije kishin një ekuipazh, që përbëhej nga: komandanti (oficer), 3 nënoficerë (timonieri, motoristi e ndihmësi i tij) si dhe 8-10 marinarë, që njëkohësisht mbulonin edhe detyrat luftarake pranë topit, mitralozave dhe bombave të thellësisë. Këto mjete, me peshë prej 40 tonësh ishin të gjata 27 metër e me gjerësi prej 3.5 metër. Ato kishin mbi kuvertë 1 top 75 mm kundërajror, e 2 mitraloza 6 mm "Colt" si dhe 5 bomba thellësie 25 kilogramësh secila.

Me emrat e katër qyteteve kryesore të vendit "Tirana", "Durrësi", "Vlora" e "Shkodra", ato u vendosën në limanet përgjatë bregdetit në Vlorë, Durrës, Sarandë dhe e fundit u caktua për në Shëngjin por rrinte në Durrës. Në këtë kohë efektivi i Marinës përbëhej nga: 9 oficerë, 20 nënoficerë dhe 50 detarë. Si anije të vogla e të lehta ato kryenin detyra në afërsi të bregdetit dhe në një farë mënyre forcuan ruajtjen e patrullimin, deri në vitin 1933.

Menjëherë pas pranimit të Paktit të Parë të Tiranës në Lidhjen e Kombeve, më 8 shkurt 1927, interesimi italian në rolin e kujdestarit për Ushtrinë Shqiptare u rrit së tepërmi, duke u realizuar "de facto" me ardhjen e organizatorëve ushtarakë, italianë në Shqipëri. Ata, nëpërmjet statusit ekskluziv të "mbrojtësit të Shqipërisë", të cilën ua lejonte Pakti i Miqësisë dhe i Sigurimit dhe me privilegjin e pagesit e të "stërvitësit" të Ushtrisë Shqiptare, depërtuan dalëngadalë në çdo hallkë të organikës të kësaj ushtrie. Ideja e tyre ishte, transformimi i sistemit milic në atë të ushtrisë së rregullt, i cili filloi të korrigjohej qysh nga fundi i këtij viti.

Në vitet 1925-1926, Shqipëria nënshkroi 2-3 traktate bashkëpunimi, edhe në fushën ushtarake, me Italinë. Në këtë kuadër, më 1927 arriti në Shqipëri një grup misionarësh ushtarakë italianë. Prania e misionarëve italianë për një kohë të gjatë afro 10-vjeçare që, deri nga mesi i viteve '30, u ndie jo vetëm në pikëpamje thjesht organizative, por edhe me ngritjen dhe vënien në punë të projekteve për furnizimin, armatimin, pajisjen, si dhe për stërvitjen e strukturave të Ushtrisë Shqiptare, duke instaluar një koncept dhe praktikë të re, atë të ushtrisë së rregullt, që ishte sistem organizimi bashkëkohor. Ndërkohë u rrit ndjeshëm shkalla e kualifikimit të oficerëve dhe nënoficerëve shqiptarë në shkollat ushtarake të huaja, kryesisht italiane.

Kalimi nga organizimi i Ushtrisë Shqiptare sipas sistemit ushtarak milic, që ishte aplikuar që pas vitit 1922 dhe sidomos 1925, çoi që aty nga



vitit 1927, në afirmimin dhe zbatimin e një tjetër sistemi organizimi. Ky ishte sistemi i Ushtrisë së rregullt, nga përdorimi i të cilit u përfitua rritja e përmasave numerike si dhe përmirësimi dhe modernizimi i strukturave të kësaj ushtrie. Kësisoj aty nga viti 1926, kur në Shqipëri, sipas marrëveshjeve të nënshkuara midis Italisë dhe Shqipërisë, në vend erdhën afro 240 misionarë ushtarakë italianë me atasheun e parë ushtarak, kolonel Alberto Pariani, të cilët u vendosën pranë Ushtrisë Shqiptare, pikërisht ky vit mund të quhet si nisje për shndërrimin e saj në Ushtri të rregullt, sipas modeleve europiane të asaj kohe.

Në periudhën e Republikës, Ushtria Shqiptare u shoqërua me ndryshime strukturore thelbësore, të cilat, lidheshin ngushtësisht me luhatje të politikës zyrtare e bazuar mbi aleancat ushtarake me spektër të gjerë interesash të ndërsjella. Organizimi milic i paarrir nga suprimimi i Ministrisë së Luftës tentoi drejt krijimit të një force ushtarake të vogël në numër, por mjaft të kushtueshme për realizimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së rendit në vend, me formacione stërvitjeje të nivelit kompani këmbësorie e shëtitëse, të cilat treguan qartë papërshtatshmëri dhe këtyrë sistemi në kushtet e rrethanat specifike ekonomike dhe të traditës ushtarake të Shqipërisë. Por gjithsesi, periudha e Republikës së Parë Shqiptare (1925-1928), formë mbretërie e pashpallur, si pjesë e rrugës historike që ka përshkuar shtetit shqiptar me shumë paqartësi dhe e mbushur me ekuivokë e të fshehta, është kushtëzuar dhe nga cilësi komplekse etnotipike shqiptare, si protagonizmi, autoritarizmi, autokracia, mosmarrëveshja, korrupsioni, individualizimi, papërgjegjëshmëria, që nuk është gjë tjetër vetëm “një pulsion i yni shkatërrimtar” ku përfaqësues të elitës politike shqiptare, për nevoja të ngushta personale favorizonin interesat e huaja në Shqipëri, madje pa hezituar edhe ta shisnin atë.

Me formën republikane, regjimi zogist nuk ishte shumë i sigurt. Statuti i Republikës linte shteg të hapur për ta zëvendësuar A. Zogun me një person tjetër gjatë zgjedhjeve të ardhshme për president republike. Për të kapërcyer këto vështirësi Zogu vendosi kalimin e formës së qeverisjes nga Republikë në Monarki. Më 1 shtator 1928, me miratimin e statutit të ri, zë fill monarkia shqiptare me Ahmet Zogun mbret. Pas shpalljes së monarkisë, më 5 shtator u formua qeveria e re, me kryeministër Koço Kotën. Këto ndryshime të brendshme politike patën ndikim të drejtpërdrejtë në Fuqitë e Armatosura dhe u shprehën gjerësisht në Statutin Themeltar.

Në këtë periudhë u rikonceptuan, u krijuan dhe u afirmuan shumica e institucioneve dhe e programeve të arsimit dhe të kualifikimit ushtarak shqiptar, të cilat tashmë synuan të përqasen me kulturën ushtarake perëndimore. I përkasin kësaj periudhe ndryshimesh e rritjeje institucionalizimi i hallkave të domosdoshme drejtuese e të komandimit, si Komanda e Përgjithshme e Mbrojtjes Kombëtare, kalimi në tre lloj forcash, krijimi i disa armëve e shërbimeve, si dhe futja e armatimeve, e pajisjeve dhe e teknikës luftarake më të përparuar se ato të mëparshme. Një rritje të dukshme pësoi buxheti i Forcave të Armatosura, i shprehur në shifra mjaft të larta.

Komanda e Mbrojtjes Kombëtare, mbështetur në një Shtab me elementët më të domosdoshëm, përipiqej të perfeksionohet për të përballuar kërkesat e kohës, duke i vënë vetes detyrë që të përfundonte një organizim ushtarak në përputhje me faktorët e brendshëm e të jashtëm, të mbështetur në buxhetin financiar, nivelin e teknikës, të armatimit dhe përvotjen e arritur në drejtimin e Fuqive të Armatosura. Në zhvillimin e Forcave të Armatosura, gjatë periudhës së Monarkisë së viteve 1928-1939, u vërejt se struktura organizative ka ndryshuar disa herë, me synimin që të gjendej një formë organizative sa më e përshtatshme për të mundësuar plotësimin e detyrave kryesore për mbrojtjen e atdheut e të shtetit. Sipas përcaktimeve të asaj periudhe kërkohet që: “Fuqitë Armate, mbi të cilat komandanti ma i naltë është N. M e Tij, Mbreti, kanë për detyrë me mbrojtje deri në fund të fundit, nderin,

pavarësinë e integritetin tokësor t’ Atdheut, me bam luftë në qoftë se dekretohet nga sovranin, e me i ruejtë e mbrojtë të gjitha institucionet e ligjet kombëtare”.

Vlerësim i posaçëm iu kushtua edhe zgjerimit të përmasave të strukturës rezerviste, veçanërisht në kohën e kalimit në sistemin e Ushtrisë Shqiptare të rregullt.

Shndërrimi konsistonte në disa pikëvështrime të rëndësishme, konceptuale, por edhe formale. Më të dukshme ishin ndryshimet e kryera në Ushtri kur, më 6 nëntor të vitit 1929, u shpall “Dekretligji për rregullimin e Ushtrisë Kombëtare”, i cili do të pasohet edhe nga dy të tjerë, në vitin 1934 dhe 1937. Ndryshimet sollën natyrshëm, për herë të parë, rënie e sistemit Milic të organizimit dhe vendosjen zyrtare të sistemit të organizimit të Ushtrisë së rregullt. Po ashtu, për herë të parë Ushtria u organizua mbi bazën e tri llojeve të forcave, Tokësore, Detare dhe Ajrore, midis të cilave siguri që ato Tokësore kishin peshën më të madhe dhe më të rëndësishme të forcave.

Në hapësirën kohore të viteve 1928-1939, në tërësi Fuqitë e Armatosura të Mbretërisë Shqiptare dhe veçanërisht Ushtria u pasuruan dhe përmirësuan me elementë të tjerë, duke i dhënë asaj gjithnjë e më tepër shëmbëlltërinë e një Ushtrie të rregullt e të përngjashme me ato të vendeve të tjera.

Kështu, 6 vjet pas ardhjes së misionarëve ushtarakë italianë pranë Fuqive Armate Shqiptare, dhe ndikimit të punës së tyre për t’i shndërruar ato sipas modelit të ushtrive të rregullta moderne të asaj kohe. Tanimë Ushtria përbëhej nga Forcat Aktive dhe ato Rezerviste, këto të fundit thirrshin në stërvitje deri në moshën 45-vjeçare. Forcën kryesore të Ushtrisë e përbënin Fuqitë Tokësore siç thirrshin atë kohë, të cilat ndaheshin në dy divizione dhe përfshinin Forcat e Këmbësorisë, të renditura në 6 grupe (regjimente) të përzier, arma e Artilerisë, ajo e Xhenios, si një grup tjetër përbënin 4 trupa, si Intendenca, Rekrutimi, Shëndetësore dhe Veterinarisë, grupi i shkollave ushtarake dhe disa elementë të ndryshëm. Në këtë kategori të fundit hynin Spitali i Përgjithshëm Ushtarak, Farmacia, Punëtorja etj.

Sipas Ligjit të ri, “Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare”, që u dekretua më 30 qershor 1931, Ushtria, si pjesë e Fuqive Armate, drejtohej nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare, që udhëhiqej prej një oficeri madhor me gradën gjeneral.

Pikërisht në këtë vit dhe në atë pasues, 1931-1932, buxheti i Ushtrisë kapi shifrën e paparë deri atëherë, 11.499 milion franga ari dhe, së bashku me atë të Xhandarmërisë, me 3.991 milion franga ari, arritën në 50 për qind të krejt Buxhetit të Shtetit. Kjo shifër përbënte kuotën më të lartë në tërë historinë e Fuqive Armate, të viteve 1912-1939.

Në këtë vit, që përkon me buxhetin e mësipërm, efektiv i Ushtrisë përbëhej nga 700 oficerë, 800 nënoficerë, 7 800 ushtarë dhe 1 350 kafshë. Gjatë vitit 1938 situata politike në Shqipëri pësoi keqësime të ndjeshme në marrëdhëniet me Italinë. Për rrjedhojë, u shtuan përpjekjet e Italisë në Shqipëri për të rritur praninë e tyre edhe në Ushtrinë Shqiptare, gjë që e pohonte edhe ministri i Jashtëm i Italisë, Konti Ciano. Ai shkruante mes të tjerave se: “Gjithashtu, edhe në gjirin e ushtrisë, me disa pak përjashtime, Italia gëzon simpati të plotë”. Tashmë, qeveria italiane kërkonte ta aneksonte Shqipërinë dhe për këtë arsye, asaj i duhej që të bënte sa më pak efektive dhe të qëndrueshme Forcat e Armatosura Shqiptare, për të shtrirë kontrollin e plotë mbi ato. Kjo mund të realizohej me rritjen në mënyrë të kujdeshme e të ndjeshme të instruktorëve ushtarakë italianë, “misioni i veçantë i të cilëve ishte krijimi i celulave aneksioniste në gjirin e ushtrisë shqiptare”. Situata politike dhe veçanërisht zhvillimi dhe keqësimi i shpejtë i ngjarjeve në fillim të prillit 1939, çoi, më datën 7 të këtij muaji, në një agresion ushtarak të tipit fashist të Italisë ndaj Shqipërisë.



# USHTRIA SHQIPTARE

## NË VITET 1945 - 1990



SAKIP CANI

Ushtria shqiptare pas vitit 1945 u përball me një sfidë të vështirë, atë të shndërrimit nga ushtri partizane në ushtri të rregullt dhe për këtë u angazhuan oficerët më të përgatitur në akademitë perëndimore. Gjatë këtij kalimi është ndeshur me përplasje të karakterit politik, diplomatik dhe ushtarak. Në fillim me ushtarakët jugosllavë, të cilët kishin ardhur në Shqipëri me misionin për ta shndërruar ushtrinë shqiptare në ushtri të republikës së shtatë të Jugosllavisë. Ushtarakët shqiptarë nuk e pranuan këtë varësi dhe kjo i kushtoi shkarkimin nga detyra e shefit të Shtatmadhorisë si dhe disa oficerëve të tjerë madhorë.

Pas prishjes me Jugosllavinë filloi asistenca ushtarake nga Bashkimi Sovjetik me kuadro dhe me materiale ushtarake si avionë, nëndetëse, helikopterë, tanke etj. Në Bashkimin Sovjetik mbaruan studimet shumë ushtarakë shqiptarë, të cilët këto dijeni i vunë në jetë në Shqipëri, duke e bërë ushtrinë shqiptare në një rang me të gjitha ushtritë e Traktatit të Varshavës, ku bënin pjesë Bashkimi Sovjetik dhe vendet e Lindjes. Denoncimi i Traktatit të Varshavës nga ana e vendit tonë dhe dënimi i pushtimit të Çekoslovakisë nga ana e trupave të Bashkimit Sovjetik, ishte një veprim politik dhe ushtarak shumë i guximshëm. Në të njëjtën kohë ai mbarte në vetvete edhe rrezikun e një sulmi ndaj vendit tonë. Në atë kohë u morën masa të jashtëzakonshme. U ndaluan lejet e vogla dhe lejet e zakonshme të të gjithë efektivave të ushtrisë. Efektiva të të gjitha njësive, veçanërisht atyre të drejtimeve bregdetare dhe zonave të desantimit ajror iu shpërnda armatim dhe municion luftarak, u kompletuan me

efektiv rezervist, sipas një grafiku, ndërkohë që njësitë tankiste dhe ato të artilerisë kundërajrore, aviacioni dhe flota detare kaluan në tërësi në organika të kohës së luftës, etj. Aq të shumta ishin këto masa gatishmërie, sa këto u shtrinë dhe në institucionet e ndërmarrrjet civile. Heqja e gradave ushtarake në tërësi në vitin 1966, si masë revolucionarizuese e Partisë së Punës, ndikoi ndjeshëm në rënien e disiplinës dhe të rregullit ushtarak, shkaktoi një tultajtje të kërkesës së llogarisë, veprim që u kundërshtua në mënyrë të hapur dhe të heshtur nga shumë ushtarakë të kohës.

Me lidhjen me Republikën e Kinës vazhdoi furnizimi me armatim i ushtrisë shqiptare, furnizim që u ndërpre në vitin 1972, me prishjen e marrëdhënieve politike midis dy shteteve. Në këtë periudhë, gjendja e ushtrisë shqiptare ishte si më poshtë: Ishin 127 brigada këmbësorie (BrK), brigada artilerie (BrA) dhe brigada sulmuese (BrS); rreth 1050 tanke të inkuadruar në 9 brigada tankesh e në dy batalione autonome, rreth 4 000 gryka zjarri artilerie tokësore; 34 regjimente të artilerisë kundërajrore, pa llogaritur artilerinë kundërajrore të brigadave, etj. Flota Luftarake Detare kishte 80 katera silurues, 4 nëndetëse, 4 gjuajtës të mëdhenj kundër nëndetëseve dhe 6 gjuajtës të vegjël, 8 minahedhëse, 2 prej të cilave të mëdha dhe 6 të vogla, si dhe anije ndihmuese (cisternë, rimorkiator, palombar, ç' magnetizuese). Aviacioni kishte rreth 240 avionë e helikopterë, cilësia e të cilëve në atë kohë ishte e njëjtë me atë të mjeteve ajrore të fqinjëve tanë. Në vitin 1980 flota detare shqiptare kishte 110 anije luftarake të tipave dhe destinacioneve të ndryshme të ardhura nga Bashkimi Sovjetik dhe Kina. Në vitet '80 ushtria shqiptare kishte 9 brigada dhe 2 batalione tankiste me nga 100 tanke. Kompania e parë e tankeve u krijua më 1 prill 1946 me tanket e mbetura si trofe nga Lufta e Dytë Botërore, ku të binte në sy kryesisht tanku i pro-dhimit italian tip "Spali". Përveç tankeve, ushtria shqiptare zotëronte dhe 3-4 batalione të mekanizuara me transportues të blinduar, të gjitha të prodhimit kinez. Pas vitit 1975 filloi procesi i fortifikimit të vendit me qëllim për të përballuar edhe të vetëm çdo sulm që mund t'i vinte vendit tonë. Ky proces e dëmtoi edhe vetë ushtrinë, por edhe ekonominë kombëtare. Në vitin 1983 pas vdekjes së Mehmet Shehut, kryeministër dhe ministër i Mbrojtjes dhe dënimit të Kadri Hazbiut, ministër i Mbrojtjes, struktura e ushtrisë u ndryshua dhe nga korpuset u kalua në divizione, brigada e shkolla të lira ushtarake, që të përgatitej i gjithë populli ushtar. Pas vitit 1990 ushtria shqiptare iu nënshtua proceseve demokratike, të shkurtimeve dhe modernizimit të saj, futjes në NATO.

# FIGURA TË SHQUARA TË LANÇ-IT DHE TË USHTRISË SHQIPTARE, TË NDERUARA ME TITUJT E LARTË “HERO I POPULLIT” DHE “NDERI I KOMBIT”

## **GJENERALLEJTËNANT SPIRO MOISIU, OFICER I USHTRISË SHQIPTARE QË NGA KONGRESI I LUSHNJËS, KOMANDANTI DHE DREJTUESI USHTARAK I LANÇ, REFORMATORI I USHTRISË SHQIPTARE**

Ai lindi më 3 maj 1900, në qytetin e Kavajës. Rrjedh nga familja e njohur e Moisiu, të dalluar për kulturë e patriotizëm. Pasi mbaroi shkollën fillore në qytetin e lindjes, vazhdoi mësimet në shkollën e mesme gjatë viteve 1914 - 1916, në Vels të Austrisë, të cilat i ndërpret për shkak të Luftës së Parë Botërore dhe kthehet në atdhe.

Në prill 1919 thirret në shërbim ushtarak dhe merr pjesë në forcat e mbrojtjes të Kongresit të Lushnjës dhe në shtator të atij viti titullohet oficer me gradën e “aspirantit”. Në muajt gusht - shtator 1920 merr pjesë në luftën kundër mësymjes së forcave serbe në drejtim të Tiranës, në vijën mbrojtëse të Kaptinës së Martaneshit, në detyrën shef Shtabi grupi dhe përfundimisht i kushtohet karrierës ushtarake.

Gjatë vitit 1923 ndjek kursin e rregullt të perfeksionimit për oficer, të drejtuar nga instruktorë gjermanë dhe në mbarim të tij i jepet grada e “nëntogerit”. Nga viti 1924 - 1927, shërben në forcat e Garnizonit të Tiranës.

Brenda vitit 1928 gradohet dy herë, “toger” në janar dhe “kapiten” në tetor të atij viti. Për dy vjet, nëntor 1928 deri në tetor 1930 ndjek kursin e perfeksionimit të oficerëve dhe klasifikohet i pari ndër 43 pjesëmarrësit. Pas mbarimit të kursit transferohet në Shkodër në detyrën shef Shtabi batalioni dhe në qershor 1931 emërohet komandant batalioni - Mali i Thatë, Korçë.

Gjatë viteve 1937 - 1938 ndjek kursin njëvjeçar për oficer madhor, duke e përfunduar me rezultate shumë të mira dhe gradohet “major”. Në shkurt 1939 emërohet komandant batalioni i rojeve kufitare, Shkodër. Në këtë detyrë drejtoi luftimet kundër pushtuesve fashistë në prill 1939, në Shëngjin dhe Ura e Bunës, Shkodër.

Në fund të prillit 1939 transferohet komandant i batalionit “Tomori” në Berat. Në krye të këtij batalioni, Spiro Moisiu kreu aktin historik - patriotik; braktisi frontin e luftës dhe doli hapur kundër agresionit fashist ndaj popullit fqinj grek.

Gjatë periudhës që gjeneral Spiro Moisiu ishte në krye të Shtatmadhorisë, është një fakt i pamohueshëm që ai e ndryshoi ushtrinë nga “partizane” në ushtri kombëtare të konsoliduar e të aftë të mbronte me dinjitet kufijtë e Atdheut. Një meritë të veçantë, gjeneral Spiro Moisiu ka në ngritjen e shkollave e institucioneve arsimore ushtarake. Me kujdesin e tij u dërguan qindra vetë për studime në shkollat e akademitë ushtarake sovjetike.

Më 6 korrik 1963, me rastin e 20-vjetorit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare gradohet “gjenerallejtënant”. Ai, për meritat e luftës dhe



detyrat e mëvonshme, është dekoruar me 15 urdhra e medalje. Gjeneral Spiro Moisiu gëzonte popullaritet e simpati në të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare. Ai ishte zgjedhur 9 legjislatura deputet në vendlindjen e tij, Kavajë, dhe nga 1962 Kuvendi Popullor e kishte zgjedhur anëtar të Presidiumit.

## **GJENERALLEJTËNANT PETRIT DUME, HERO I POPULLIT, ISH-SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË**

Heroi i Popullit, gjenerallejtënant Petrit Dume lindi në Kolonjë, në një familje atdhetare dhe u edukua me ndjenjat e saj dhe të krahinës së tij. Ai u bë luftëtar i famshëm, komandant i çetës dhe i batalionit “Hakmarrja”, luftoi me trimëri dhe pati suksese të mëdha. Ky batalion u bë tmerr për armikun. Në vitin 1944 u caktua komandant i Brigadës XVIII Sulmuese, ku u shqua për aftësi komanduese në të gjitha betejat që zhvilloi kjo brigadë. Më 1945 dërgohet për studime në Akademinë “Frunze” dhe më vonë edhe në Akademinë “Voroshilov”, të cilat i mbaroi me rezultate shumë të mira. U ngarkua me detyrë komandant divizioni, zëvendësues i Shtabit të Përgjithshëm dhe që nga viti 1950 deri në vitin 1975, për 25 vjet me radhë shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Gjeneral Petrit Dume në të gjithë punën e tij është shquar për aftësi profesionale të larta, për cilësi organizative dhe komanduese, për energji dhe përsosmëri në punë, për kërkesë llogarie dhe operativitet. Ai kujdesej jo vetëm për përgatitjen luftarake të ushtrisë, por edhe për jetën e njerëzve, të ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të cilët i donte shumë. Ai e drejtoi ushtrinë dhe shtabin e saj të përgjithshëm për 25 vjet me radhë dhe e ngriti atë në rangun e ushtrive të tjera moderne.



## **GJENERAL HITO ÇAKO, HERO I POPULLIT, ISH-ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES DHE DREJTOR POLITIK I USHTRISË**

Lindi më 3 mars 1923, në Progonat të Kurveleshit. Merr pjesë aktive në lëvizjen nacionalçlirimtare. Më datë 28 maj 1944 i jepet detyra e komisarit të Brigadës së 5-të. U shqua veçanërisht në luftimet për çlirimin e Lurës, marrjen e kalasë së Prizrenit dhe çlirimin e qytetit të Prizrenit.

Më 9 maj 1945, Hito Çako emërohet komandant i Divizionit të Parë, detyrë të cilën e kryen deri më 15



gusht 1945.

Duke qenë në detyrat më të larta në krye të ushtrisë, gjenerali Hito Çako mbaron tri akademi ushtarake, përkatësisht atë "Frunze" në Moskë (1950-1954), akademinë "Voroshilov" po në Moskë (të cilën e nisi pas tri vitesh punë), e më vonë Akademinë Detare në Leningrad. Të tri këto akademi i mbaron me rezultate të shkëlqyera.

Në gusht 1960 emërohet komandant i FLD.

Më datë 15 janar 1962, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor i jepet grada "gjeneral". Po ashtu i jepet titulli "Hero i Popullit". Hito Çako ka kryer detyra të tjera të larta si Drejtor i Drejtorisë Politike të Ushtrisë dhe zëvendësministër i Mbrojtjes. Më 5 dhjetor 1975, tre gjeneralët e lavdishëm të luftës dhe të drejtimit të ushtrisë shqiptare, Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako pushkatohe në Linzë, Tiranë.

### **GJENERALLEJTËNANT RRAHMAN PARLLAKU, HERO I POPULLIT DHE NDERI I KOMBIT, ISH-KOMANDANT I DIVIZIONIT V TË LANÇ-IT, ISH-ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES DHE ISH-ZËVENDËSHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË**

U lind më 17 prill të vitit 1919, në fshatin Novosej të Lumës, rrethi i Kukësit. Më 6 janar 1943 u caktua komandant i njësiteve guerile të qytetit të Vlorës deri më 28 nëntor 1943, kur e transferuan me detyrë komisar batalioni.

Pas rezultateve të mira në drejtimin e batalionit në luftimet kundër forcave naziste dhe ruajtjen e kompaktësisë të efektivit gjatë Operacionit armik të Dimrit 1943-1944, emërohet zëvendës komisar i Brigadës së 8-të, e përvuar më 26 prill 1944, në Sheper të Gjirokastrës.

Me çlirimin e Kosovës, më 22 nëntor, në qytetin e Pejës merr urdhrin e emërimit komandant i Divizionit të 5-të dhe u gradua "kolonel". Nga 20 dhjetori i vitit 1944 deri në mars të vitit 1945, forcat e komanduara nga Rrahman Parllaku në bashkëveprim me forcat jugosllave çliruan krahinën e Sanxhakut. Me ndërprerjen e luftimeve, forcat e Divizionit të 5-të e të 6-të Sulmues u kthyen në Kosovë.

Më 14 prill të vitit 1945, kur ndodhej në Mitrovicë, ai mori urdhrin e emërimit komisar i Korparmatës së 2-të në Berat.

Me shkrijen e saj e nxorën në lirim dhe e caktuan sekretar politik i Komitetit Qarkor të PK të Shkodrës.

Me kërkesën e tij rikthehet në ushtri në detyrën e drejtorit të Personalit në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitin 1947 i jepet grada "kolonel".

Në dhjetor të vitit 1947, Rrahman Parllaku u caktua në detyrën e drejtorit Politik të Ushtrisë, detyrë të cilën e kreu deri në prill të vitit 1948, kur u dërgua të studionte jashtë shtetit. Parllaku ka mbaruar studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sovjetike "Voroshilov".

Pas kthimit nga studimet, ai u emërua drejtor i Drejtorisë së Organizim-Mobilizimit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Në vitin 1952-1954 caktohet në postin e zëvendësministrit të

Mbrojtjes e drejtor i Prapavijës së Ushtrisë dhe mori gradën e lartë të "gjeneralmajorit".

Gjatë viteve 1954-1961 do të shërbente si zëvendësministër i Mbrojtjes për përgatitjen luftarake të ushtrisë.

Nga viti 1961 deri në vitin 1967 kreu detyrën e komandantit të Forcave Ushtarako-Detare dhe më pas komisar i këtyre forcave dhe iu dha grada "gjenerallejtënant".

Në vitet 1969-1970 do të shërbente si komisar i Forcave Ushtarako-Ajrore dhe një vit më vonë u emërua zëvendësministër për Përgatitjen Luftarake të Ushtrisë.

Për merita të veçanta i është dhënë titulli "Hero i Popullit" dhe është dekoruar me 9 urdhra e tri medalje të luftës dhe 3 urdhra të shërbimit ushtarak.

Rrahman Parllaku, ka qenë zgjedhur deputet i Kukësit në Kuvendin Popullor për 7 legjislatura rresht, që nga viti 1945 deri në vitin 1973.

Në 95-vjetorin e ditëlindjes, Presidenti i Republikës, Bujar Nishani nderon gjeneralin legjendar Rrahman Parllaku me dekoratën "Nderi i Kombit".

### **TAHIR KADARE, NDERI I KOMBIT, KOMANDANT I LAVDISHËM I LANÇ-IT, ZËVENDËSHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË**


Lindi në qytetin e Gjirokastrës, më 28 nëntor 1913. Shkollën e mesme e kreu në qytetin e tij të lindjes dhe vazhdoi studimet ushtarake në degën e Artilerisë. Me mbarimin e shkollës ushtarake, u emërua në detyrë pranë Komandës së Artilerisë në Tiranë. U përfshi në lëvizjen antizogiste, duke bërë pjesë në grupin e oficerëve që u godit nga regjimi në vitin 1935, me zbulimin e lëvizjes së Fierit.

Ai u përfshi që në fillim në Lëvizjen Antifashiste dhe u bë shpejt një nga udhëheqësit kryesor në rrethin e Gjirokastrës, duke u marrë kryesisht me organizimin e batalioneve partizane. Tahir Kadare shpaloji aftësitë e tij si udhëheqës e strateg i luftës partizane. Me krijimin e Brigadës së Parë Sulmuese, ai emërohet nga Shtabi i Përgjithshëm zëvendëskomandant i kësaj brigade. Detyrën e komandantit të Brigadës së Gjashtë Sulmuese, Tahiri e mori në kulmin e operacionit gjerman të dimrit, të vitit të acartë 1944.

Në gusht 1944, Tahiri caktohet komandant i Divizionit të Dytë Sulmues dhe në këtë detyrë drejtoi veprimet luftarake të brigadave që çliruan gjithë pjesën veriperëndimore të Shqipërisë, e bashkë me Shkodrën të gjithë Shqipërinë.

Pas çlirimit të vendit, Tahiri, si komandant i përmasave të mëdha caktohet komandanti i Korparmatës së Dytë, që kishte për detyrë të mbronte frontin e jugut, kur gjendja në Greqi ishte e paqëndrueshme dhe forcat shoviniste kishin pretendime territoriale ndaj vendit tonë.

Pas çlirimit, Tahiri mbaroi studimet e larta ushtarake në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike me rezultate të shkëlqyera. Për aftësitë e tij, përkushtimin në punë, si ushtarak i dimensioneve operativ - strategjike dhe si një





nga udhëheqësit e lartë të Luftës Nacional Çlirimtare, ai u ngarkua me detyra të larta në Ministrinë e Mbrojtjes, komandant i Artilerisë së Ushtrisë, zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm e Drejtor Operativ, zëvendës i parë i ministrit të Mbrojtjes etj.

Më 1962 pushoi së rrahuri zemra e komandantit trim, e njërit nga drejtuesit më të njohur të formacioneve më të mëdha të Ushtrisë Nacional Çlirimtare, e njërit nga gjeneralët dhe ushtarakët më të talentuar të ushtrisë shqiptare.

### **DALI NDREU, NDERI I KOMBIT, ISH-ZËVENDËSKOMANDANT I SHTABIT TË USHTRISË ANÇ**

Gjeneral Dali Ndreu ishte një nga figurat më të shquara udhëheqëse të LANÇ. Ai ishte zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm, njëkohësisht dhe operativ i këtij shtabi, i cili së bashku me komandantin e Shtabit, gjeneral Spiro Moisiun, e ka drejtuar luftën në të gjitha etapat e saj.

Më 1928 filloi studimet në shkollën ushtarake në Tiranë, në degën artileri. Më 1931 mbaron studimet me rezultate të larta, gradohet "aspirant" dhe emërohet zëvendëskomandant baterie. Pas një viti gradohet "toger" dhe emërohet komandant baterie artilerie.

Më 1938 fillon studimet në Fakultetin e Shkencave Ekonomiko-Politike në Itali, të cilat i ndërpret pas pushtimit fashist të Shqipërisë dhe më 1940 kthehet në Atdhe. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në korrik 1943, Dali Ndreu u zgjodh anëtar i shtabit dhe u caktua zëvendëskomandant e njëherësh operativ i këtij shtabi.

Gjeneral Dali Ndreu, përveç organizator e drejtues operativ-strategjik i Luftës, ishte edhe një komandant i suksesshëm në fushën e betejës, si në luftën partizane dhe në atë frontale. Këto aftësi i demonstroi edhe kur mori drejtimin e Brigadës së III-të Sulmuese në dhjetor 1943. Duke e vlerësuar si një nga oficerët me aftësi të lartë profesionale e zotësi të veçanta komanduese, Kongresi i Përmetit e gradoi Dali Ndreun "kolonel" dhe e emëroi komandant të Divizionit të Parë të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke i ngarkuar detyrën që divizioni të kalonte në mësimje për çlirimin e Shqipërisë Verilindore, krahinave të Matit, Dibrës e Mirditës, ku gjermanët kishin forca të shumta dhe mbështetje nga forcat e Ballit Kombëtar e të Legalitetit.

Pas këtij operacioni të suksesshëm, me krijimin e Korparmatis së Parë, me meritë, komandant i saj u emërua Dali Ndreu dhe u gradua "gjeneralmajor". Në krye të kësaj korparmatis, Dali Ndreu drejtoi operacionin e forcave për çlirimin e kryeqytetit, Tiranës, operacion që përfundoi me sukses brenda 20 ditëve. Më pas ai komandoi operacionin për çlirimin e gjithë Shqipërisë.



### **HERO I POPULLIT, GJENERALLEJTËNANT MUHAMET PRODANI**

Heroi i Popullit, gjenerallejtënant Muhamet Prodani, ishte njëri nga figurat e shquara të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe nga drejtuesit kryesor të Ushtrisë Shqiptare.

Me krijimin e Brigadës së Parë Sulmuese, Muhameti rreshtohet në radhët e saj si kuadër komandues, ku ai u shqua për guxim, trimëri dhe aftësi drejtuese. Duke vlerësuar këto cilësi dhe aftësi, atij, në maj 1944, iu besua detyra e drejtimit të kësaj brigade dhe bashkë me kolegun e tij, Arif Hasko, zëvendësuan në detyrë dy nga udhëheqësit e shquar të asaj brigade, Mehmet Shehun e Tuk Jakovën, që kishin lartësuar emrin e saj, si njësia kryesore luftarake.

Në kuadrin e Divizionit të Parë zhvilloi luftime të ashpra, për çlirimin e krahinave të Shqipërisë së mesme e të veriut dhe i kurorëzoi ato me çlirimin e kryeqytetit të vendi, Tiranës. Mbas çlirimit të Tiranës, më 1 dhjetor 1944, emërohet komandant i Divizionit të III, me gradën "nënkolonel". Më vonë emërohet në funksione të ndryshme në njësitë e ushtrisë.

Në vitin 1950 dërgohet për studime në Akademinë "Frunze" në Moskë, ku vlerësohet shkëlqyeshëm. Më 1956 emërohet komandant korpusi në Elbasan dhe gradohet "gjeneralmajor". Ka kryer detyrat e komandantit të Mbrojtjes Bregdetare, komandantit të Mjeteve të Blinduara, komandantit të Korpusit të Gjirokastrës për 10 vjet rresht. Në vitin 1971 emërohet drejtor i Përgatitjes Luftarake të ushtrisë dhe në vitin 1972 drejtor i Përgatitjes Operative në Shtabin e Përgjithshëm. Merr gradën "gjenerallejtënant" dhe më pas Presidiumi i Kuvendit Popullor për meritat e tij në luftë e dekoron me dekoratën më të lartë, atë të "Heroit të Popullit". Në vitin 1974 Muhamet Prodani dënohet nga sistemi i kohës dhe e vuan dënimin në burgun famëkeq të Burrelit. Muhameti nuk ishte vetëm një udhëheqës i shquar i luftës, por me mbarimin e studimeve të larta akademike, u bë një nga drejtuesit kryesor të ushtrisë. Ai për aftësi e merita mori detyra të larta komanduese të divizionit e korparmatis dhe funksione drejtuese në Ministrinë e Mbrojtjes.



### **HERO I POPULLIT, NDERI I KOMBIT, GJENERALMAJOR, VELI DEDI, TRIMI NGA MEDVEGJA, LUFTËTAR INTERNACIONALIST**

Më 5 prill 1912, në fshatin Dede të Komunës së Medvegjës në Kosovën lindore, në familjen e Jasharëve, lindi Heroi i Popullit Veli Dede. Shkollimin bazë e kreu në vendlindje dhe më pas studioi në Fakultetin e Makinerisë në Beograd. Me ardhjen në Shqipëri



vazhdoi Shkollën Mbretërore të Oficerëve, por njëherësh i lindi dëshira për të shkuar në akademi ushtarake në Itali, gjë që e shtyu për të mësuar gjuhën italiane shumë shpejt. Kështu, në vitin 1934 shkoi në Itali për studime ushtarake, ku për dy vite kreu Akademinë e Xhenios e të Artilerisë në Torino.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri dhe Itali njihet me shumë patriotë shqiptarë, si, Ali Kelmendi, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Emrush Myftari, Sali Vuciterna, Ibrahim Gjakova, Xhemal Kada, Asim Vokshi (një ndër shokët më të ngushtë të tij), etj.

Më 1933 bëhet anëtar i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës. Vazhdimisht e derisa ndërroi jetë, mendja i punonte e zemra i rrihte për Atdheun, për Shqipërinë e Kosovën e për mbarë trojet shqiptare.

Kur fashistët e Frankos iu vërsulën Spanjës Republikane, më 1936-ën, Veliu u nis në mbrojtje të lirisë së popullit spanjoll. Në vitin 1946 kthehet në Shqipëri me gradën e "majorit" francez, së bashku me bashkëshorten Elena, një italiane, antifashiste që e njohu në Marsejë, e cila iu bë bashkëpunëtoresh dhe krahu gjatë gjithë jetës së tij. Pas kthimit në Atdhe, emërohet në detyrën e drejtorit të Xhenios së Ushtrisë Shqiptare, ku dha një kontribut të lartë në organizimin, kompaktësimin e konsolidimin e trupave xheniore, si dhe në fortifikimin e brezit kufitar për përballimin e provokacioneve të monarko-fashisteve grekë të gushtit 1949. Gradualisht mori gradimet në Ushtrinë Shqiptare deri me gradën e "gjeneralmajorit" dhe titullin më të lartë "Hero i Popullit".

Gjeneralmajor Veli Dedi ka meritën e veçantë për kontributin e jashtëzakonshëm që dha personalisht për çminimin e më se 40 km front bregdetar të Shqipërisë, të minuara gjatë Luftës së Dytë Botërore nga nazistët gjermanë.


Pas daljes në pension, gjeneral Veli Dedi u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare për shumë vite me radhë dhe njëherësh edhe anëtar i Forumit Drejtues të Federatës Internacionale të Rezistencës Antifashiste (FIR-it). Gjeneralmajor Veli Dedi vdiq më 3 prill 1995, në Tiranë.

## **HEROI I POPULLIT, GJENERALLEJTËNANT SADIK BEKTESHI, ISH-ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES, ISH-DREJTOR POLITIK I USHTRISË**

Lindi më 1915 në Vuthaj, të krahinës shqiptare të Plavës e të Gucisë. Arsimin e përgjithshëm e kreu në gjimnazin e Shkodrës, ku dhe u përfshi në lëvizjen përparimtare të kohës.

Ai u gjykua dhe u dënua nga regjimi i Zogut. Pasi shpërthyen burgun, Sadiku u kthye në Shkodër. Atje ai u përfshi në lëvizjen antifashiste, duke u bërë një nga drejtuesit kryesorë të protestave, demonstratave dhe aksioneve kundër okupatorit fashist. Për këtë aktivitet, u arrestua dhe u internua në Itali. Më pas Sadiku u kthye në Shkodër ku filloi lëvizjen e tij me Tuk Jakovën e Vasil Shanton.

Ai u bë një nga udhëheqësit kryesorë të Luftës Nacionalçlirimtare në Qarkun e Shkodrës, si drejtuesi kryesor i Qarkorit të Shkodrës, komandant i çetës së parë, dhe më vonë i Batalionit "Perlat Rexhepi", që luftoi jo vetëm në Qarkun e Shkodrës, por edhe në krahinat e tij të lindjes, në Plavë dhe në Guci, në krahinat e Tropojës, Hasit e Kukësit. Sadiku qe një nga organizatorët e Konferencës së Bujanit,



në të cilën u morën vendime historike, që Kosova pas çlirimit nga fashizmi të kishte të drejtën për vetëvendosje. Ai e përfundoi luftën si komandant i Brigadës së 27-të Sulmuese.

Pas çlirimit të atdheut, Sadiku me të njëjtin vull dhe përkushtim iu përvesh punës për riorganizimin dhe transformimin e ushtrisë, nga partizane në ushtri të rregullt kombëtare. Ai duke pasur detyra të larta drejtuese, si drejtor Politik i Ushtrisë, zëvendësministër i Mbrojtjes, drejtor i Institutit të Studimeve Ushtarake dha një kontribut të veçantë në rritjen dhe forcimin e gatishmërisë luftarake të ushtrisë, për mbrojtjen e pavarësisë së atdheut.

I zgjedhur për disa legjislatura deputet i Kuvendit Popullor, Sadiku gjithë jetën ka pasur preokupim të madh çështjen për çlirimin e Kosovës. Ai e ka ndjekur dhe mbështetur me përkushtim luftën për çlirimin e Kosovës. Që në fillim mbështeti Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe përshëndeti ndërhyrjen e NATO-s, për rivendosjen e paqes dhe të drejtave të njeriut në Kosovë. Fatmirësisht Sadiku e pa Kosovën e lirë. Ai vizitoi të gjitha krahinat e saj, u takua atje me bashkëluftëtarët e tij të vjetër e të rinj dhe bashkëkombësit e tij.

## **GJENERAL VEHBI HOXHA, HERO I POPULLIT, ISH-ZËVENDËSHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË SHQIPTARE**

Vehbi Abaz Hoxha, lindi më 13.03.1916 në katundin Tërbaç të Vlorës, në një familje me ndjenja atdhetare të shquara. Arsimin fillor Vehbi Hoxha e kreu në vendlindje, ndërsa në vitin 1935 përfundoi studimet në Shkollën e Mesme Tregtare Italiane, në Vlorë. Në qershor të 1943-shit Vehbiu u inkuadrua në çetën partizane "Halim Xhelo" të Qarkut të Vlorës e mandej në çetën partizane të Mallakastrës.

Në muajin gusht 1943, me formimin e Brigadës së Parë Sulmuese u rreshtua në efektivat e saj dhe caktohet komandant toge, në tetor emërohet zëvendës komisar kompanie dhe në dhjetor komandant i Kompanisë të Batalionit V të Brigadës së Parë Sulmuese.

Disa ditë pas çlirimit të Shqipërisë, emërohet komandant i Brigadës së 24-të Sulmuese. Në prill të 1945-s Vehbi Hoxhës i ngarkohet detyra e komandantit të Brigadës së 17-të Sulmuese me gradën "kapiten I". Pas riorganizimit strukturor të ushtrisë, në shkurt të 1946-s, Vehbiu emërohet komandant i Regjimentit të 3-të të Divizionit të Tretë të Këmbëorisë, ndërsa në maj të po atij viti emërohet komandant i Regjimentit të 31-të të Divizionit të Pestë të Këmbëorisë.

Në dhjetorin e vitit 1947 dërgohet për studime të larta në Akademinë Ushtarake "Frunze" në Moskë. Më 26.11.1951, me gradën "nënkolonel", Vehbi Hoxha emërohet shef i degës operative në Drejtorinë e parë të Shtabit të Përgjithshëm, ku punoi me përkushtim e seriozitet, derisa u dërgua përsëri për studime të larta ushtarake në Moskë, në Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Voroshillov". Pasi i përfundoi studimet me rezultate të larta, në moshën 40-vjeçare, në kulmin e pjekurisë profesionale kthehet në atdhe dhe më 23.11.1955 emërohet përsëri shef i Degës së Përgatitjes Operative në Drejtorinë e parë të Shtabit të Përgjithshëm. Pas një viti e gjysmë, më 1966-n, Vehbi Hoxha emërohet drejtor i Drejtorisë së Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm.

Për këto merita, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor, në



vitin 1957 gradohet "gjeneralmajor".

Në vitin 1963 emërohet komandant i Korpusit të 7-të të Këmbësorisë dhe tre vjet më vonë, në vitin 1966, emërohet komisar i Korpusit të 9-të të Këmbësorisë. Në të dyja korpuset, në atë të Burrelit dhe të Shkodrës, ku gjeneral Vehbi Hoxha punoi dhe drejtoi për rreth katër vjet e gjysmë, evidenton aftësitë e tij të veçanta si komandant dhe drejtues i njësive të mëdha operative.

Më 26.12.1967, Vehbi Hoxha emërohet drejtor i Drejtorisë Operative të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe më 1970-n emërohet edhe zëvendës-shef i Shtabit të Përgjithshëm, ku punoi pesë vjet, duke përballuar një volum pune të tensionuar dhe të mbushur me aktivitete të rëndësishme me shpalosje në bazë ushtarake dhe vendi. Në vitin 1972 emërohet inspektor i përgjithshëm dhe më 1974-n përgjegjës i grupit të inspektorëve të përgjithshëm në MMP. Vehbi Hoxha emërohet drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Përgjithshëm të MMP-së dhe më pas i besohet detyra e komandantit në Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm, ku shërbeu deri në vitin 1977. Në moshën 61-vjeçare doli në pension.

### **GJENERAL NEXHIP VINCANI, NDERI I KOMBIT, ISH-KOMANDANT I BRIGADËS IV DHE ISH- ZËVENDËSSHEF I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË (GJENERALI QË U VARROS ME PLUMBIN NË TRUP)**

Biri i atdhetarit të shquar Karemancin Vinçani (Dervishi), pasi mbaroi shkollën fillore në Vinçan, filloi mësimet në Liceun e Korçës. Më pas vazhdoi mësimet në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë dhe i përfundoi në gjimnazin e Shkodrës në vitin 1939. Nexhip Vinçani studimet universitare i kreu në Romë. Sa dëgjoi kushtrimin e nënës Shqipëri, si gjithë bashkëmoshatarët u kthye në atdhe. Menjëherë, Nexhipi dhe shoku i tij i ngushtë, Pëllumb Dëshnica caktohen nga Qarkori i Korçës të organizojnë rezistencën dhe luftë kundër okupatorit italian. Nexhip Vinçani, nga viti 1940 deri në maj 1943 ishte drejtues dhe organizator kryesor në qarkun e Korçës, komandant dhe intelektual i talentuar. Në qarkun e Korçës në fillim ai organizoi njësitet e armatosura. Më vonë, në fillim të vitit 1942 deri në shtator të atij viti punoi në organizimin e çetave, si ajo e Pogradecit, Gorës, Vithkuqit etj., gjithsej 15 çeta partizane. Në janar-mars 1943 numri i çetave sa vjen e shtohet. Bilanci luftarak i Nexhip Vinçanit është shumë i pasur. Ai mori pjesë në 255 ditë luftime. Komandant Nexhipi ka drejtuar me aftësi të rrallë luftimet që ka zhvilluar Brigada IV S në dy operacionet armike, atë të Dimrit dhe të Qershorit. Komandant Nexhipi u caktua zëvendëskomandant i Shtabit Operativ për çlirimin e Tiranës. Luftimet e Brigadës IV S ishin shumë të suksesshme. Pas çlirimit të vendit, për merita të shquara gjatë LANÇ, Nexhip Vinçanit iu dha grada "kolonel" e më pas "gjeneralmajor". Mbasi kreu me sukses Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Voroshilov" në BS, Nexhipi dha një kontribut të çmuar për modernizimin e Ushtrisë Shqiptare. Caktohet zëvendës-shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe më 1956 komandant i Mbrojtjes Bregdetare. Mirëpo, gjithë vlerat e gjeneral Vinçanit pas çlirimit u mohuan nga regjimi komunist, duke dënuar padrejtësisht dhe larguar përfundimisht nga Ushtria. Vdiq në Tiranë, më 06.02.1997, duke lënë për historinë e brezat veprën dhe emrin e tij.



### **HEROI I POPULLIT MYSLIM KETA, DJALOSHI I NJËSITEVE GUERILE TË TIRANËS, ISH-KOMANDANT I ARMËS SË TANKEVE, RËNË NË KRYE TË DETYRËS**

Në formimin e Mysllimit, si njeri e luftëtar i lirisë, ndikim vendimtar pati familja e tij. Pushtimi i vendit nga fashistët italianë e hidhëroi pa masë Mysllimin, ashtu si gjithë rininë shqiptare. Ata u hodhën në rreshtat e para të demonstratave për të kundërshtuar pushtimin fashist, këto ndikuan në formimin e shpirtit të tij atdhetar. Mysllimi ishte gjithnjë në kryerjen e aksionit. Në prerjen e linjave telefonike të armikut, në hedhjen në erë të depove të municionit në Qesarikë, në rrëmbimin e letrës e të ciklostilit në depot e Postë-Telegrafit, në aksionin e daljes nga burgu të 26 të dënuarve antifashistë, e të tjera. I parë ishte edhe si atentator kundër oficerëve e policëve italianë e atyre nazistë gjermanë, kuislingëve e spiunëve të tyre.



Doli partizan, fillimisht në çetën e më vonë në batalionin "Dajti". Ai në krye të çetës që drejtonte zhvilloi shumë luftime të suksesshme, si sulmin kundër depove italiane të xhenios në Surrel e Lanabregas, ndaj postave të xhandarmërisë në zonën e Dajtit, të postbolloqeve në hyrjet e qytetit dhe në rrugët e Tiranës. Edhe gjatë tre ditë luftimesh, në tetor 1943, Mysllim Keta, i veshur me uniformën ushtarake gjermane, u doli prapa shpine forcave gjermane dhe i shpartalloi ato. Me krijimin e Brigadës së Tretë Sulmuese, Mysllimi u inkuadrua në formacionet e saj në detyrën e komandantit të kompanisë e më vonë zëvendëskomandantit të batalionit. Kur brigada u kthye përsëri në Shqipërinë e Mesme, Lymi në krye të kompanisë që komandonte, filloi goditjet kundër postbolloqeve të qytetit të Tiranës dhe garnizoneve armike të vendosura në periferi të qytetit. Edhe me kalimin e forcave të brigadës në Kosovë, në luftimet e zhvilluara në Junik, Deçan e rrethinat e Pejës për afër një muaji, Lymi u dallua si drejtues i luftimeve me fantazi e guxim. Më vonë, si zëvendëskomandant batalioni drejtoi luftimet në luftë të rregullt në Sanxhak e Bosnje. Atë e donin me shpirt bashkëluftëtarët dhe populli, me të gjithë miqësohej shpejt. Për aktivitetin në luftë, për trimërinë e vendosmërinë e treguar deri në vetëmohim, Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekretin Nr. 358, datë 7 korrik 1947, kur Lymi ishte 22 vjeç, i jep kapiten Mysllim Ketës titullin e lartë "Hero i Popullit", me motivacionin: "Dalluar për heroizma dhe abnegacion të pa shoq". Shembull qëndrese e vetëmohimi gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, u bë dhe mbeti një nga luftëtarët më të shquar të brezave të sotëm dhe të nesërëm të popullit shqiptar. Mbas lufte, ndër kuadrot e parë që u dërguan për studime ishte edhe Lymi, ai u dërgua në shkollën ushtarake të këmbësorisë në Bashkimin Sovjetik, por për arsye shëndetësore i ndërpreu ato. Me përmirësimin e gjendjes fizike, ndoqi studimet e larta për Inxhinieri Tankesh. Pas mbarimit të studimeve u emërua në detyra të rëndësishme si, komandant regjimenti tankesh, komandant i Brigadës së Tankeve, komandant i Forcave Ushtarake - Detare, shef i Forcave Tankiste, etj. Lymi ishte mjeshtër në njohjen e përdorimin e tankeve. Ai përgatiti breza të tërë tankistësh, (ushtarë, nënoficerë e oficerë), dhe ka një meritë të veçantë në organizimin, pajisjen dhe zhvillimin e trupave tankiste në ushtrinë tonë. Lymi njihet si themeluesi i kësaj arme. Ndahet nga jeta në një aksident automobilistik, më 26 shkurt 1961, në Fushë-Arrëz, Pukë.



# ARSIMIMI USHTARAK SHQIPTAR, 1958-2022

## Hapja dhe zhvillimi i shkollave ushtarake



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj,  
Mjeshtër i Madh



**Akademia u krijua si një institucion shtetëror, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe ishte institucion i lartë mësimor-edukativ e shkencor, që shërbente për kualifikimin e kuadrove të lartë të FA-së.**

**N**jë nga arritjet më të mëdha në fushën e zhvillimit të arsimit ushtarak shqiptar ishte krijimi, forcimi dhe zgjerimi i arsimit të lartë ushtarak. Në vitin 1958, me vendim të Këshillit të Ministrave u formua Shkolla e Lartë Ushtarake në qytetin e Tiranës. Kjo shkollë funksionoi fillimisht me një program mësimor 3-vjeçar. Në vitin 1962, institucioni u emërtua “Akademia Ushtarake” dhe oficerët konsideroheshin me arsim të lartë ushtarak. Akademia u krijua si një institucion shtetëror, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe ishte institucion i lartë mësimor-edukativ e shkencor, që shërbente për kualifikimin e kuadrove të lartë të FA-së. Një vlerësim i tillë për shkollën ushtarake përbente një dukuri të re në fushën e arsimit dhe të kualifikimit të oficerëve. Ishte kjo një arritje e nxitje për rritjen e cilësisë e të veprimtarisë mësimore, pedagogjike dhe studimore e shkencore të institucionit të arsimit ushtarak dhe të shkollave ushtarake. Kërkesat për shkollat ushtarake u reflektuan në format organizative, në plan-programet mësimore, në rritjen



profesionale dhe të metodave të mësimdhënies nga trupa pedagogjike, si dhe në zbatimin e kriterëve bashkëkohore të pranimit të nxënësve, kursantëve dhe akademistëve që ndiqnin studimet në shkollat ushtarake. Në shkollën e parë të lartë ushtarake u caktuan pedagogë me përvojë që quheshin në atë kohë “instruktorët”, të tillë si Ferik Hoda, Elami Hodo, Niko Dulaku, Veip Aliaj, Hysni Rusi, Dhimiter Ndrenika etj. Kursi i parë përbëhej nga oficerë me nivele të ndryshme arsimore. Kështu që u parashikua përgatitja e oficerit në dy nivele. Në nivelin e parë përfshiheshin lëndë të formimit të përgjithshëm, si shkencat e natyrës, ndërsa në nivelin e dytë zhvillohej programi i përbërë nga lëndët profesionale. Fillimisht, Akademia Ushtarake kishte tri katedra: gjitharmëshe, artileri tokësore e kundërajrore dhe formimi i përgjithshëm. Hapja e Akademisë Ushtarake ishte një arritje e madhe në fushën e arsimit ushtarak shqiptar. Misioni i saj ishte përgatitja dhe aftësimi i oficerëve shqiptarë,

që do të merrnin në dorë drejtimin e reparteve dhe të njëjstëve të ushtrisë. Këtij niveli cilësor ishte e natyrshme që t'i prihej me një trupë oficerësh që zotëronin e pasqyronin një nivel të lartë kulturor e njohurish profesionale ushtarake, veçanërisht në planëzim dhe drejtim. Në këtë kuadër, në bazë të urdhrat të ministrit të Mbrojtjes Popullore, filloi puna për organizimin e shkollës, për përgatitjen e bazës materiale të gjithanshme dhe të programeve për fillimin e vitit të parë mësimor. Vendi fillimisht u caktua te Rrapi i Treshit, i cili përmbushte kërkesat minimale për mësim, ku kishte zyra, klasa, kabinete, mensë, kuzhinë etj. Përveç pajisjes së lokaleve me orënditë e nevojshme, një ndër detyrat kryesore ishte hartimi i programeve mësimore, i leksioneve dhe i metodikave. Për këtë nevojiteshin kuadro të tjerë, të cilët u emëruan në korrik 1958. Këto funksione ishin kryesisht instruktorë për taktikën, zjarrin, artilerinë, artilerinë kundërajrore, xhënon, ndërlihdjen, kiminë etj., si dhe

shefa në administratë (financë, transport, intendent etj.). Më 24 shtator 1958, administrata e shkollës së lartë filloi rregullisht nga puna, duke marrë vulën zyrtare. Fillimisht, krijimi i kësaj shkolle synonte rritjen e kulturës dhe të aftësive komanduese të oficerëve të ushtrisë nga ana taktiko-operative, duke u përqendruar me një program të shkurtër akademie ushtarake. Kjo shkollë, për 4-5 vjetët e para ishte trevjeçare, ku në vitin e parë u zhvilluan lëndë të kulturës së përgjithshme dhe më pas do të kthehej në dyvjeçare. Komandanti i parë i shkollës, gjeneralmajor Thoma Xhixho së bashku me trupën pedagogjike dhe komanduese i kushtuan vëmendje problemeve të organizimit, të procesit të programeve mësimore dhe sidomos raportit midis lëndëve për kursin e parë dhe të dytë. Kështu në janar të vitit 1959 u hap Shkolla e Lartë Ushtarake, e cila filloi me një kurs përgatitor që vazhdoi gjatë atij viti. Fillimisht ishin dy grupe mësimore, një gjitharmësh dhe një artilerie tokësore. Në shtator 1961 Shkolla e Lartë Ushtarake mori emrin “Akademia Ushtarake”. Në Akademi po krijohet një përvojë e re si në mësimdhënie dhe në krijimin e një fondi materialesh teorike. Nga viti në vit shtohet numri i dëgjuesve, i pedagogëve dhe i fakulteteve. Kështu, ndërsa në vitin e parë mësimor (1959) studiuan 50 dëgjues dhe dhanë mësim 14 pedagogë, vitin mësimor 1965-1966 e ndoqën 340 dëgjues, 60 pedagogë dhe 7 fakultete si Gjitharmësh, AT, AKA, Prapavijë, Ndërlidhje, Kimi, Inxhinieri ushtarake. Në vitin mësimor 1961-1962, mbi 60% e efektivit të kursantëve në Shkollën e Bashkuar vinin nga shkolla e mesme ushtarake “Skënderbej” dhe me daljen nga Traktati i Varshavës nuk u dërguan më me studime jashtë shtetit studentë të shkollave ushtarake. Skënderbegasit e dalluar në mësimet dërgoheshin në Universitetin e Tiranës, sipas nevojave të ushtrisë për specialitetet të ndryshme. Me vendimin e Këshillit të Ministrave, në vitin 1961, kursantët që mbaronin Shkollën e Bashkuar quheshin me arsim gjysmë të lartë. Krahas shkollave ushtarake si shkolla e mesme ushtarake “Skënderbej”, Shkolla e Bashkuar e Oficerëve, të krijuara pas çlirimit dhe të Akademisë Ushtarake, u



shtuan dhe Shkolla e Lartë e Oficerëve të Flotës Luftarake Detare në vitin 1961, në Vlorë dhe, më 11 maj 1962, po në Vlorë nisi veprimtarinë Shkolla e Lartë Ushtarake e Aviacionit Shqiptar. Përpyekjet për rritjen e cilësisë akademike Në janar 1966, Akademia Ushtarake kaloi në program dyvjeçar. Në muajin maj të po atij viti, në Akademi u zhvillua stërvitja komando-shtabi me kurset e dyta me temë “BrK në mbrojtje në sistem tunel, në skalion të parë në drejtimin kryesor të KK”. Kjo stërvitje tregoi se dëgjuesit e këtyre kurseve (pjesëmarrës në stërvitje) njihnin në përgjithësi mirë teorinë e luftimit mbrojtës dhe ishin në gjendje ta organizonin dhe ta drejtonin atë. Komandantët dhe shtabet treguan njohuri të mira praktike në organizimin dhe drejtimin e luftimit. Në këtë stërvitje, për herë të parë u bënë përpjekje për të kombinuar luftën e ushtrisë së rregullt me atë partizane. Gjithashtu u bënë disa ndryshime në dokumente, duke kaluar në ato grafike. Në kushtet e atëhershme të organizimit të Forcave të Armatosura dhe të zhvillimit të shpejtë të koncepteve të artit ushtarak, përgatitja operative e kuadrit të lartë oficer, të cilët kishin mbaruar studimet në BS, apo e kuadrit të ri të ngarkuar me funksione komanduese të larta, por pa pasur arsim të lartë ushtarak, gjë që nuk i përgjigjej kërkesave të kohës, solli si domosdoshmëri hapjen e Kursit të Lartë Gjitharmësh pranë Akademisë Ushtarake, që u realizua më 15 shtator 1967. Në qershor 1968 u dha porosi që të hiqej fjala “dëgjues” dhe ajo të zëvendësohej me fjalën “akademist”. Kjo u diskutua në Institutin e Gjuhësisë, i cili ra dakord për këtë. Në mars 1969 efektivit i Akademisë Ushtarake mori pjesë në detyrën e ndërmjetësve në stërvitjet me trupa “Shpiragu”. Kjo ishte një formë e mirë për të lidhur teorinë me praktikën dhe për të testuar veten se sa zbatues ishin në detyra konkrete në rolet përkatëse që kishin në të tilla stërvitje. Gjatë viteve '70-të, vëmendja kryesore e katedrave ishte kthyer në drejtim të hartimit të teksteve e rregulloreve. Në fund të viteve '60-të, shkollat ushtarake me programet përkatëse po shiheshin me syrin e vazhdimësisë së arsimimit hap pas hapi dhe të plotësimit të njohurive të nxënësit, kursantit,

akademistit, oficerit me kulturë të përgjithshme dhe profesionale sipas nivelit të detyrave. Kjo kishte të bënte me politikat arsimore të kohës, të orientuara nga qeveria si një domosdoshmëri objektive për të zbatuar politikat e shtetit. E rëndësishme ishte se shkollat ushtarake të niveleve të ndryshme, si Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, Shkolla e Bashkuar e Oficerëve dhe Akademia Ushtarake po shiheshin si një proces arsimimi në funksion të njëra-tjetrës. Në këtë kuadër ishte e nevojshme të rishikohej procesi mësimor për të ripërcaktuar objektivat, synimet dhe strukturën e programeve të këtyre shkollave, duke i parë si hallka të të njëjtit “zinxhir arsimor ushtarak”. Në Akademinë Ushtarake, ndërtimi i sistemit të arsimit, afatet, përmbajtja dhe baza e zhvillimit të procesit mësimor ishin të lidhura ngushtë me Shkollën e Bashkuar. Studimi në Akademi duhej të ishte vazhdimi dhe rritja e dijeve për marrjen e arsimit të lartë ushtarak. Mendimi ishte që Akademia Ushtarake të përgatiste komandantë reparti (batalioni, grupi) dhe oficerë shtabi njësie taktike, si dhe shefa të llojeve të armëve e shërbimeve për këto njësi. Kjo kërkonte që Akademia Ushtarake të përgatiste kuadro me dije të thella taktike dhe që të merrnin njohuri të mira për artin operativ. Kjo bazohej në nevojën që kishte ushtria për kuadro të aftë që zgjidhnin problemet në mënyrë të pavarur, si në batalion (grup), ashtu dhe në shtabin e brigadës, me përparësi që pas një periudhe praktike në trupa, të drejtonin brigadën. Por u hodh ideja që Akademia Ushtarake të mos përgatiste komandantë batalioni (grupi), por brigadë e lart. Kjo kishte lidhje me atë që Shkolla e Bashkuar do të përgatiste komandantë batalioni. Lidhur me afatet e studimit në Akademi, meqë ishte hedhur ideja 3-vjeçare për Shkollën e Bashkuar, ajo duhej të vazhdonte studimet për 2 vjet. Kjo, sepse niveli i kuadrove ishte rritur dhe në të ardhmen do të vazhdonte të rritej si në drejtim të nivelit të përgjithshëm arsimor, ashtu dhe në atë ushtarak. Afati 2-vjeçar i studimeve në Akademinë Ushtarake bënte që oficeri i dalë nga Akademia, më vonë të vazhdonte kurse më të larta për të zgjeruar njohuritë e tij kryesisht në drejtim të artit operativ. Nga viti 1974 në programet e Akademisë

u përfshinë temat e nivelit të brigadës dhe të korpusit, që synonte të përmbushte një objektiv për të përgatitur oficerë të aftë, të nivelit taktiko - operativ. Programi ndërthurej me stërvitje komando-shtabi, dalje në terren, si dhe pjesëmarrje në stërvitje me trupa që organizoheshin në vitet 1970-1980 në Ushtrinë Shqiptare. Në prill 1975 komanda e Akademisë nxori urdhrin për organizimin, përgatitjen dhe zhvillimin e stërvitjes komando-shtabi me kurset e dyta. Në këtë urdhrë, përveç udhëzimeve organizative, u parashikuan dhe vlerat e qëllimit mësimor: të rriteshin e përmirësoheshin njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të oficerëve akademistë që në rol të komandës së Brigadës, shefave të llojeve të armëve e shërbimeve, të organizonin, planëzonin dhe drejtonin veprimet luftarake në mësymje dhe në mbrojtje. Stërvitja u zhvillua në fillim të qershorit në rajonin Priskë-Petrelë-Rrogzhinë, me metodën stërvitje komando-shtabi dyshkallëshe (Brigadë-batalion) e njëanshme në terren. Gjatë viteve '70-'90 në akademi u zhvilluan veprimtari mësimore pedagogjike dhe studimore-shkencore që lidheshin me përgatitjen e programeve të reja mësimore, metodika, rregullore luftimi, tekste mësimore, bazë materiale-didaktike. Gjithashtu u realizuan një numër botimesh cilësorë dokumentare për historinë ushtarake dhe artin ushtarak të periudhave të ndryshme. Vend të rëndësishëm zënë një numër i konsiderueshëm titujsh, artikujsh shkencorë e studime të shumta. Në këto vite, Akademia pësoi transformime cilësore në organizim dhe në përmbajtje, gjë që u pasqyrua në rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe sidomos në formimin profesional të akademistëve. Në të vërtetë, u bënë përpjekje të ndjeshme për t'i dhënë një natyrë gati tipike prej oficeri drejtues akademistëve gjitharmësh, ku përfshiheshin edhe oficerë të Flotës Luftarake Detare, të Aviacionit dhe të Ministrisë së Brendshme. Njëherazi, gjatë veprimtarisë së Akademisë Ushtarake u bënë përpjekje që krahas kurseve 2-vjeçare, që përbënin bazën e këtij institucioni mësimor, t'i jepnin frymëmarrje dhe horizont më të gjerë brenda misionit të saj. Kjo u synua përmes ngritjes dhe vënies në punë të kurseve të ndryshme, si ai i oficerëve të lartë, i perfeksionimit të





itete. Katedra e xhenios përgatiti kuadro për shef xhenier, por të kenë edhe nivelin e dijeve të inxhinierit zbatues. Deri në fillimin e viteve 1990, kjo shkollë kishte si mision përgatitjen e oficerëve komandues, që kishin njohuri të mira profesionale dhe teknike në specialitetin të cilit i përkisnin.

### **Përgatitja e kuadrit rezervistë**

Krahas kuadrit aktiv është vijuar përgatitja dhe kuadrit rezervistë. Përgatitja e organizuar e tij filloi që gjatë vitit 1950, ku pranë Shkollës së Bashkuar të Oficerëve funksiononte kursi 3-mujor për këtë qëllim. Ndërkohë nevoja e përgatitjes masive të kuadrit rezervist realizohej në mbledhje të shkurtra 4-ditore për çdo muaj në një periudhë 3-4 mujore. Ato organizoheshin pranë njërive e reparteve të ndryshme. Përgatitja e centralizuar e kuadrove rezervistë, më 26.01.1951, në Durrës u hap shkolla e posaçme. Më vonë, kurse për këtë qëllim u ngritën edhe sipas llojeve të armëve p.sh në vitin 1953 u hap në Elbasan kursi për kuadro artiljer. Nga vitet 1950 në përgatitjen paraushtarake u përfshinë edhe studentët (femra e meshkuj) të shkollave e kurseve të arsimit të mesëm e të lartë. Studentët që kalonin me sukses provimet e lëndëve ushtarake u jepej grada e oficerëve rezervistë, ata që nuk i fitonin këto provime caktoheshin nënoficerë. Në vijim ka pasur kurse respektivisht 6 mujore, 5 mujore, 4 mujore, 3 mujore për përgatitjen e oficerëve rezervistë. Ato ngriheshin pranë njërive të bashkuara, etj. Këtyre kurseve i nënshtroheshin dhe studentët e universitetit dhe të shkollave të larta në përfundim të shkollës.



Në sistemin e shkollimit ushtarak shqiptar u përfshinë edhe Qendrat ose Shkollat e Instruksionit për të përgatitur oficerë rezervë dhe nënoficerë të shërbimit të detyrueshëm. Në janar 1967 nisi të funksiononte Shkolla e Oficerëve Rezervë në Zall-Herr, Tiranë. Në vitin 1981 u ngritën dhe dy Shkolla Rezerviste në Vaun e Dejës, Shkodër dhe Bunavi, Vlorë. Organizimi i punës ushtarake-shkencore Në vitet 1972 e më tej përpunimi i mendimit teorik u zgjerua duke hartuar një numër të konsiderueshëm rregulloresh e teksteve u dëdësua veprimtaria shkencore, u bënë hapa për kuali-

oficerëve të artilerisë, të prapavijës, kurset e korrespondencës, ai i komandantëve të grupeve vullnetare, ai i funksionarëve partiakë e të pushtetit etj. Në vitet 1980, Akademia ndërmori ndryshime të reja cilësore në pikëpamje të organizimit dhe të përmbajtjes së programeve mësimore e studimore-shkencore. Kjo u pasqyrua ndjeshëm në procesin e mësimdhënies dhe në formimin profesional të akademistëve. Në Akademi u përfshinë dhe oficerë të FLD-së, të Aviacionit dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme. Për realizimin e misionit, Akademia bashkërendon punën e saj me

institucionet e larta arsimore civile, strukturat e Shtabit të Përgjithshëm, Komandat e Forcave etj. Institucioni vazhdimisht është reformuar në formë e përmbajtje. Më 31 janar 1984 filloi programi katër-vjeçar. Ai shtroi raportin e leksioneve e seminareve si dhe u shtuan tema e lëndë të reja, të cilat u afroheshin programeve të universitetit për degët përkatëse të specialitetit. Për këmbësorinë programi përfshinte dhe tema për brigadën dhe njohuri për divizionin në lloje të ndryshme luftimi. Disa katedra si ajo e radio-lokacionit përgatiste kuadro për tri specialitete, katedra e xhenios përgatiti kuadro për tri special-

fikimin shkencor pasuniversitar, ku ndihmesa e shkollës ushtarake është e ndjeshme. Megjithatë izolimi gati absolut i ushtarakëve dhe politizimet e rënduara patën ndikimet e tyre dhe në rezultatet e në objektivat e punës studimore e të mendimit teorik ushtarak në tërësi. Të mos harrojmë se motoja që zbatohet në ato vite ishte që gjithçka e huaj ishte armiqësore etj. Si kudo, shkolla ushtarake ushqente ushtarakun shqiptar në tërësi me të njëjtin delir nga i cili vuante diktatura shqiptare, me lavdinë historike e frikën ndaj të huajve, izolimin, të trajtuar si rezistencë ndaj armikut, sakrificimin e individualitetit për hir të kolektivitetit, ekzaltimin e sukseseve etj.

Akademia ishte njëherësh dhe një institucion studimor-shkencor, mision i dhënë nga ministri i Mbrojtjes, më 1 gusht 1973, ku thuhet të organizohet puna ushtarake-shkencore dhe të krijohet në akademi një bërthamë shkencore. Kështu, në këtë periudhë u krijua sektori i studimeve shkencore ushtarake. Një pjesë e këtyre studimeve janë botuar dhe publikuar në vend. Shumë punonjës shkencor e pedagogë u përfshinë në kualifikimin shkencor pasuniversitar me mbrojtje të disertacioneve, duke fituar grada shkencore.

Në vitin 1973, Akademisë iu dha e drejta për dhënien e gradave shkencore për kuadro e ushtarakë. Në vitin 1975 Akademia Ushtarake u cilësua nga Këshilli i Ministrave, institucioni i vetëm për kualifikimin e kuadrove të Ushtrisë, ndërsa në vitet 1990 iu dha e drejta e propozimeve për tituj shkencore, si “Profesor i Asociuar”, “Profesor” dhe “Drejtuës i Kërkimeve Shkencore”. Kështu Akademia u bë një qendër studimore-shkencore e përpunimit të mendimit shkencor ushtarak.

Prej vitit 1984 në Akademinë e Forcave të Armatosura janë mbrojtur mbi 130 doktoratura nga kuadro të fushave të ndryshme, shumica e të cilëve pedagogë e punonjës shkencorë të saj, midis tyre dhe “Profesorë të Asociuar” e “Profesorë”. Edhe sot, në fushën e kualifikimit



shkencor Akademia e Mbrojtjes, sipas ligjit të Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën të organizojë studime të thelluara pasuniversitare në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes të nivelit “Master”, organizimin e doktoraturës dhe klasifikimin e punonjësve shkencorë. Gjatë viteve 1970-1990, në Akademi u zhvilluan veprimtari mësimore-pedagogjike dhe studimore-shkencore që lidheshin me përgatitjen e programeve të reja mësimore, metodika, rregullore luftimi, tekste mësimore, bazë materiale-didaktike. Janë organizuar sesione, konferenca e simpoziume shkencore dhe është realizuar një numër botimesh cilësore dokumentare për historinë ushtarake dhe artin ushtarak të periudhave të ndryshme.

Akademia Ushtarake nuk ishte vetëm një institucion arsimor e mësimdhënës, por dhe një qendër ku përpunohej mendimi shkencor. Në të zhvillohej një veprimtari e gjerë ushtarake shkencore, përgatiteshin materiale, metodika, tekste mësimore etj., organizoheshin konferenca, sesione dhe këshillime shkencore për probleme të shkencës ushtarake, kryheshin studime për historinë e artit ushtarak etj. U dendësua dhënia e provimeve pasuniversitare nga dhjetëra pedagogë, filloi

mbrojtja e disertacioneve.

#### **Akademia pas vitit 1990**

Ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri në vitet ‘90-të u reflektuan dhe në Forcat e Armatosura, të cilat iu nënshtruan një reformimi të plotë. Në vitin 1991 Shkolla e Bashkuar e Oficerëve u emërtua Akademia Ushtarake e Forcave Tokësore “Skënderbej”. Në vitin 1991 Akademia nuk mori kontingjente të reja me objektiv rikonstruktimin e programeve. Me kontingjentet e viteve të dyta, të treta, të katërta programi u reduktua, duke zbritur nga niveli i divizionit në atë të batalionit me pak njohuri për brigadë këmbësorie. Në vitin 1995, pas një pune 3-vjeçare ristrukturimi, Akademia rimori kontingjente dhe filloi arsimin në bashkëpunim dhe përshtatje me standartet e ushtrive të NATO-s. Në këtë proces u përfshi dhe Akademia Ushtarake, si qendër formimi dhe kualifikimi e oficerëve për ecurinë në detyra dhe në grada më të larta. Ky proces kompleks dhe i rëndësishëm u gërshetua dhe me shkollimin e kualifikimin e oficerëve e të një numri oficerësh në shkollat dhe akademitë e vendeve të NATO-s dhe në SHBA. Më 4 prill 1995, në Akademi u çel për herë të parë Kolegji i Mbrojtjes. Në këtë





pjesëmarrës nga Kroacia, Gjeorgjia, Greqia, Kosova dhe Shqipëria. KLSM është në procesin e akreditimit nga Komanda e Aleancës për Transformim në Norfolk SHBA dhe statusi aktual i kursit është “NATO LISTED”. Akademia bashkëpunon me institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit, si: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Universitetin e Tiranës, Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, Universitetin e Durrësit, Universitetin Europian të Tiranës, Universitetin “Ilyria”, Qendrën “Franklin”, Qendrën “Hapësirë”, Qendrën “Marshall”, në Gjermani, Qendrën e Studimeve të Larta të Mbrojtjes (CASD) në Romë, Akademinë e Drejtimit të Hamburgut, si dhe akademitë e kolegjet e vendeve anëtare të NATO-s. Në këto vite në Akademi kanë lektura, si pjesë e procesit mësimor, profesorë e ushtarakë të lartë nga vendi ynë e nga vende të ndryshme si: SHBA, Gjermani, Angli, Itali, Greqi, Turqi, Maqedoni, Rumani, Bullgari, etj. Akademia funksionoi si një strukturë e arsimimit dhe kualifikimit pasuniversitar me katër departamente: Departamenti i Strategjisë dhe Sigurisë Kombëtare, Departamenti i Operacioneve, Departamenti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Menaxhimit të Mbrojtjes dhe Udhëheqjes Ushtarake; si dhe dy qendra: Qendra e Doktrinave dhe e Manualeve si dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja. Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja njëkohësisht zhvillohen programe të gjuhëve të huaja sipas standardeve të NATO-s në gjuhët: anglisht, gjermanisht, italisht, frëngjisht, greqisht dhe turqisht. Nga data 1 tetor 2012 institucioni ushtarak mori emrin Akademia e Forcave të Armatosura dhe përbëhet nga dy fakultete dhe një qendër, përkatësisht Fakulteti i Arsimimit të Përgjithshëm, Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja. Akademia ka vijueshmëri dhe përputhje të plotë me politikën e re të arsimimit të FA-së, sipas formatit perëndimor, duke qenë pjesë e ndryshimeve dhe transformimeve të FA-së.

kolegj u përgatitën dhe u kualifikuan ushtarakë të lartë e civilë, si deputetë, politikanë e gazetarë, me synim formimin e koncepteve bashkëkohore mbi komponentët e njësurar teorikë e metodologjikë të sigurisë e të mbrojtjes. Akademia vlerësohet si një nga qendrat më të rëndësishme kombëtare të përpunimit të ideve dhe të politikave në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Me vendim nr. 30, datë 04.08.1995 të Komisionit të Kualifikimit Shkencor, pranë Këshillit të Ministrave, Akademia e Mbrojtjes konsiderohet SHPU në Fushën Ushtarake të Mbrojtjes. Në këtë kuadër, në mbështetje edhe të VKM nr. 445, datë 14.08.1995 “Për arsimimin e oficerëve pranë Akademive Ushtarake”, në vitin 1998 u rihap Kursi i Shtabit të Përgjithshëm në sistemin 2-vjeçar. Po këtë vit, Akademia u pranua anëtare me të drejta të plota në Konsorciumin e Akademive të Mbrojtjes dhe të instituteve të studimit e sigurimit të vendeve anëtarë të NATO-s dhe PfP. Në Akademinë e Mbrojtjes, më datën 17.09.2007, u hap Kursi i Parë i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM), duke kualifikuar drejtuesit ushtarakë që mbajnë gradën e “kolonelit”, nga

Forcat e Armatosura të vendeve të rajonit: si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Italia, Shqipëria si dhe personel civil që punojnë në institucionet e Sigurisë. Në vitin 2008 dhe 2010 u rihap përsëri ky kurs me të njëjtin status. Nga data 5 shkurt 2011 e në vijim, mbështetur në VKM, nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Akreditimit, nr. 90, datë 03.09.2010, vijon cikli i dytë i studimeve, “Master i Shkencave” (Part Time) në “Studime në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”. Nga data 28 prill 2011 e në vijim, mbështetur në VKM, nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vijon cikli i tretë i studimeve, “Doktoraturë” në fushën e Sigurisë e Mbrojtjes. Nga data 04.11.2011 e në vijim, mbështetur në VKM, nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Akreditimit, nr. 53, datë 09.11.2009, vijon cikli i dytë i studimeve, “Master Profesional” (Part Time) në “Studime në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”. Më 10 shtator 2012 u hap Kursi i Katërt i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes me





GJENERAL BRIGADE (R)  
**BARDHYL KOLLÇAKU**,  
Ish-Shefi i Shtabit të  
Përgjithshëm të FARSH;  
Deputet i Kuvendit të  
Shqipërisë

# Forcat e Armatosura Shqiptare në demokraci

**FORCAT E ARMATOSURA JANË PJSË E SHQIPËRISË  
DHE ATO KANË ECUR, NDRYSHUAR DHE PËRJETUAR  
TË GJITHA NGJARJET, ZHVILLIMET DHE ULJE-NGRITJET  
E VENDIT TONË. NDRYSHIMET DEMOKRATIKE TË  
FUNDIT TË SHEKULLIT TË KALUAR, SOLLËN EDHE  
NDRYSHIMET MË EPOKALE DHE TË THELLA E TË  
GJITHANSHME NË FORCAT E ARMATOSURA.**



**M**ë 4 dhjetor 1912, burrat e mëdhenj atdhetarë dhe patriotë, që shpallën pavarësinë e Shqipërisë, i dhanë jetë edhe krijimit të Forcave të Armatosura të shtetit të parë shqiptar. Më 4 dhjetorin e këtij viti, ato mbushin 110 vjet. Është një rrugëtim historik mbi shekullor, i mbushur me angazhime, ndryshime, suksese, vështirësi dhe sfida. Forcat e Armatosura dhe gratë e burrat në uniformë kanë gjithë të drejtën dhe moralin të ndihen krenarë për kontributet dhe sakrificat e bëra gjatë kësaj ekzistence.

Unë ndihem i nderuar dhe i respektuar që kam shërbyer në Forcat e Armatosura për pjesën më të madhe të jetës time. Shërbimi në uniformë ushtarake ngelet i pakrahasueshëm për përvojat dhe eksperiencat që më ka dhënë dhe për ndikimin që ka pasur në formimin e aftësive të mia për menaxhimin e situatave, përballimin e sfidave të lidhshme, por edhe të integritetit moral e profesional dhe të profilit tim qytetar. Forcat e Armatosura më kanë rritur, prandaj unë dhe të gjithë, kemi detyrimin të evokojmë historinë e tyre në momente të tilla siç është ky 110-vjetor.

Forcat e Armatosura janë pjesë e Shqipërisë dhe ato kanë ecur, ndryshuar dhe përjetuar të gjitha ngjarjet, zhvillimet dhe ulje-ngritjet e vendit tonë. Ndryshimet demokratike të fundit të shekullit të kaluar, sollën edhe ndryshimet më epokale dhe të thella e të gjithanshme në Forcat e Armatosura. Forcat e Armatosura, në kohën e ndryshimit të sistemit politik, u gjendën me kapacitete njerëzore, teknike, infrastrukturore dhe materiale të jashtëzakonshme dhe tejet të mëdha për një vend si Shqipëria. Sigurisht që ishte normale dhe e natyrshme që, në kuadrin e ndryshimeve rrënjësore në fushën politike, sociale dhe ekonomike, që po kryheshin në vendin tonë, me përmbysjen e regjimit komunist në vitet '90, edhe në politikën ushtarake, mendimin dhe konceptet ushtarake, strukturën organizative dhe në çdo element dhe aktivitet tjetër të sektorit të mbrojtjes, do të bëheshin ndryshime të mëdha.

Fakti është se ndryshimet e sektorit të mbrojtjes kanë qenë nga të parat, më të thellat dhe të gjithanshmet. Ato filluan me ndryshimet e domosdoshme dhe të pashmangshme të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, të legjislacionit përkatës dhe vijuan me shpejtësi për reformimin dhe transformimin e gjithë sistemit dhe establishmentit të mbrojtjes, por veçanërisht të Forcave të Armatosura, si komponenti ushtarak dhe më thelbësor i këtij sistemi. Ky reformim filloi që në gjysmën e parë të viteve '90 dhe në mënyrë konsekuente vijoi deri në fund të dhjetëvjeçarit të parë të vitit 2000. Kjo ka qenë edhe faza më intensive e ndryshimeve dhe transformimeve, që u finalizua me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Faza tjetër, që në të vërtetë vazhdon të jetë në proces, është koha e zhvillimeve cilësore, e konsolidimit dhe rritjes graduale të forcës dhe fuqisë ushtarake të Forcave të Armatosura, me objektiva të qarta për një profesionalizëm të lartë dhe integrim të plotë në Aleancë.

Në zhvillimet e periudhës së parë, Forcat e Armatosura përjetuan një ndryshim rrënjësor në konceptet e tyre strategjike, ligjore dhe doktrinare, të shoqëruara këto me një reduktim masiv të strukturës organizative, forcës njerëzore, të teknikës dhe armatimit luftarak, por edhe të shtrirjes gjeografike dhe infrastrukturës e instalimeve ushtarake. Reformimi dhe transformimi i Forcave të Armatosura, për nga dinamika, thellësia, spektri dhe intensiteti, nuk ka paralele dhe është i pakrahasueshëm me asnjë nga sektorët e tjerë të vendit. Në vlerësimin tim, ai ka qenë një revolucion i vërtetë. Natyrisht që është e kuptueshme që zvogëlimi i shpejtë i numrit të personelit u shoqërua me konsekuenca të pashmangshme sociale, por është edhe një e vërtetë e pamohueshme që vetë ushtarakët e mbështetën, e mirëkuptuan dhe sakrificuan për zhvillimin e një force të re, në kushitet e reja të vendit. Kjo është padyshim një vlerë për t'u konsideruar dhe që i ka shërbyer vendit dhe shoqërisë tonë. Ushtarakët tanë nuk i kanë shërbyer kauzës

së demokracisë vetëm në këtë mënyrë, por ata, krahas që kanë qenë subjekt i reformave, kanë qenë, në terma praktik, edhe aktorët dhe faktorët kryesorë të realizimit të tyre. Padyshim që në këtë zhvillim kompleks dhe shumëplanësh, Forcat e Armatosura kanë pasur një mbështetje dhe asistencë reale dhe të dobishme nga Aleanca, SHBA-të dhe aleatë të tjerë si, Gjermania, Italia, Turqia, Britania, etj. Në përfundim të një pune të madhe, pothuajse për mbi një dekadë e gjysmë, Forcat e Armatosura morën pamjen e një force ushtarake profesioniste, moderne dhe fleksibile ndaj zhvillimeve dhe situatave të reja. Gjatë kësaj faze u vendosën bazat kryesore të forcës së re ushtarake, të tilla si: vendosja e kontrollit civil-demokratik, e sistemit të gradave, heqja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, profesionalizimi i plotë, reformimi rrënjësor i sistemit të edukimit dhe përgatitjes ushtarake, përhapja dhe vendosja e re strategjike e Forcave të Armatosura, etj. Këto zhvillime pozitive u ndërprenë, por edhe u vonuan në kohë nga ngjarjet traumatike të pranverës së vitit 1997. Forcat e Armatosura ishin komuniteti dhe institucioni që vuajti pasojat dhe kostot më të rënda të atyre ngjarjeve, që më pas kërkuan investime, energji dhe kohë të konsiderueshme për rigratjen e domosdoshme.

Paralelisht me reformat dhe transformimet e brendshme ushtarake në veçanti, dhe të sektorit të mbrojtjes në përgjithësi, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura, që në vitin 1992, kur vendi ynë u bë anëtar i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, kishin filluar edhe një rrugëtim historik dhe sfidues, që u kurorëzua me anëtarësimin në Aleancë, më 1 prill 2009. Në konceptin ushtarak, Forcat e Armatosura realizuan kështu me sukses detyrën e afërt: objektivin e anëtarësimit në NATO. Procesi i gjatë që solli këtë anëtarësim, ishte një garë dhe sfidë me kohën për të kryer ndryshimet, transformimet dhe zhvillimet e domosdoshme në mentalitet dhe koncepte, në legjislacion dhe doktrinë ushtarake; reforma të thella në organizime, riorganizime dhe struktura, në sistemin e edukimit dhe trajnimit dhe deri tek motivimi i personelit. Ai ishte një proces gjithëpërfshirës kombëtar, por në asnjë moment nuk mund të ndahet dhe të harrohet mbështetja, ndihma dhe asistencë e vazhdueshme e aleatëve dhe partnerëve tanë.

1 prilli 2009, është një gurë kilometrik në rrugëtimin e kohës demokratike të Forcave të Armatosura. Kjo është një ditë domethënëse, e shënuar dhe e veçantë për Shqipërinë, por sigurisht edhe për Forcat e Armatosura. Anëtarësimi dhe debutimi në NATO është një angazhim dhe kontribut kombëtar, por në terma praktikë, perceptimi publik i këtij anëtarësimi, konceptohet dhe simbolizohet kryesisht me forcën ushtarake të vendit. Kjo vjen për arsye se Forcat e Armatosura janë përfaqësimi më i madh, më aktiv, më i qenësishëm dhe i dukshëm në Aleancë. Megjithatë, duhet theksuar se ky perceptim publik është edhe rezultat i përfaqësimit dinjitos të ushtarakëve dhe efektivëve të Forcave tona të Armatosura në strukturat, misionet dhe operacionet e Aleancës.

Periudha e pas-anëtarësimit është faza e dytë e Forcave të Armatosura në demokraci. Kjo periudhë, që vijon edhe aktualisht, është një histori e veçantë suksesi dhe eksperiencash për Forcat tona të Armatosura. Që në fillimet e kësaj kohe Shqipëria vijon të zbatojë planin e integritimit në Aleancë, që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO-n. Si pjesë e këtij plani, Forcat e Armatosura kanë detyrimin të realizojnë të ashtuquajturën Paketë të Objektivave të Kapaciteteve, që janë një kontribut i dakordësuar ushtarak, i gatshëm dhe i aftë për të përmbushur detyrimet euroatlantike të vendit.

Gjithashtu, në këtë kuadër, pas anëtarësimit, Forcat e Armatosura kanë përjetuar ndryshime rrënjësore në aspektin organizativ, në strukturën e personelit, në konceptimin e misionit, në edukim dhe trajnim, në modernizim dhe në angazhimet në operacione. Midis të tjerave, një nga zhvillimet më të veçanta të kësaj periudhe janë ndryshimet në strukturën gjinore të personelit. Përqindja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në Forcat



por edhe cilësore. Kështu janë zhvilluar rreth 200 stërvitje të natyrave të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, me pjesëmarrje të rreth 30 mijë trupave ushtarake, pa përfshirë këtu një prej stërvitjeve më të mëdha strategjike të serisë "Defender Europe"; janë shkolluar, kualifikuar dhe specializuar vetëm në institucione të vendeve të NATO-s rreth njëmijë ushtarake të niveleve të ndryshme. Sigurisht që këto janë eksperiencia mjaft pozitive dhe një ndihmë konkrete e konsiderueshme dhe e vlerësueshme e aleatëve tanë, për të cilën ne ju jemi mirënjohës.

Në harkun kohor të pas-anëtarësimit janë kryer edhe modernizime domethënëse të kapaciteteve të Forcës së Armatosur, të tilla si Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Detare dhe Ajrore, janë siguruar mjete detare moderne, helikopterë të rinj Cougar dhe Eurocopter, mjete të blinduara, kapacitete të mbrojtjes kundërkimike, armatim i standardeve të

e Armatosura është dyshifrore dhe ato janë në çdo strukturë, armë dhe shërbim të forcës ushtarake të vendit, duke filluar nga ushtarë, nënoficere dhe oficerë. Ato shërbejnë me një integritet, dinjitet dhe profesionalizëm të admirueshëm edhe për kolegët e tyre djem e burra në uniformë, nga nivelet më të ulëta dhe deri në ato më të larta të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura. Vazjat dhe gratë me uniformë, me përkushtimin, sakrificat, aftësitë dhe kontributin e tyre, e kanë ndryshuar përgjithmonë peizazhin ushtarak modern të forcës ushtarake të vendit të kësaj kohe demokratike. Krahas këtyre ndryshimeve dhe zhvillimeve, Forcat e Armatosura pothuajse që në fillimet e demokracisë kanë qenë vazhdimisht të angazhuara në misionet dhe operacionet jashtë Shqipërisë. Ato prej vitesh vazhdojnë të japin kontribute të vlerësuara në misionet jashtë vendit, ku prej fillimit, në vitin 1994, në misionin e OKB-së në Gjeorgji, vlerësohet që të jetë angazhuar një personel ushtarak prej rreth dhjetëra mijë trupash. Këto efektivë të Forcave të Armatosura janë angazhuar në rreth qindra misione në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së, apo koalicione të kohës, në pikat më të nxehta të globit dhe në disa kontinente të tij, disa prej të cilëve vijnë në Kosovë, Letoni, Sudan dhe Bosnjë-Hercegovinë. Angazhimet dhe kontributet në këto misione kanë pasur edhe kosto në jetë njerëzore për Forcat e Armatosura.

Në vitet e anëtarësimit, një personel ushtarak pothuajse prej qindra ushtarakësh dhe civilësh të Forcave të Armatosura është i angazhuar në strukturat e komandimit dhe drejtimit të NATO-s. Këto kontribute në shërbime dhe misione janë një jehonë dhe dinjitet për vendin. Forcat e Armatosura, si përfaqësimi më i madh i Shqipërisë në NATO, kanë bërë më të mirën e tyre, me devocionin, vullnetin dhe profesionalizmin maksimal, për të kontribuar në sigurinë e vendit, rajonit dhe më gjerë. Këto angazhime marrin veçanërisht vlera në kushtet e një ambienti sigurie të cenuar rëndë nga agresioni rus në Ukrainë.

Në këto vite të demokracisë, Forcat e Armatosura kanë pasur edhe angazhime të jashtëzakonshme dhe të vazhdueshme brenda vendit, në detyra nga më të ndryshmet për nevoja të komuniteteve apo autoriteteve qendrore e lokale. Vetëm për emergjencat civile dhe situata të kërkim-shpëtimit, Forcat e Armatosura janë angazhuar në mbi një mijë raste operacionesh ose ndërhyrjesh me pjesëmarrje të konsiderueshme të kapaciteteve ushtarake. Ato kanë ndërtuar me mijëra metra ura, kilometra rrugë dhe argjinatura, kanë shpëtuar jetë njerëzore në zjarre, tërmete e përmbytje. Këto shërbime e kanë bërë Forcën e Armatosura të afërt, të shumëkërkuar dhe të dashur me qytetarët dhe komunitetet. Kjo është një arritje domethënëse.

Sigurisht që Forcat e Armatosura kanë edhe aktivitetin e tyre tipik ushtarak, sikurse janë stërvitjet, trajnimet, edukimet, kualifikimet, etj., që pas anëtarësimit kanë qenë shumë më intensive, kërkuese

NATO-s, etj. Këto investime dhe modernizime të tjera në të ardhmen e afërt si mjete ajrore pa pilotë, mjete të mbrojtjes ajrore, kapacitete të mbrojtjes kibernetike, sisteme larghedhëse me fuqi të madhe zjarri dhe deri tek investimi i NATO-s për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës, janë garanci për një forcë ushtarake dinjitoze për vendin, efektive, të shpejtë, të saktë dhe të sigurt për kryerjen e detyrave të saj në çdo kohë, vend dhe situatë. Ky përvjetor për Forcat e Armatosura, por jo vetëm, është dhe duhet të jetë padyshim një moment krenarie dhe festimi, por ai duhet të jetë veçanërisht moment reflektimi. Për mbi një dekadë anëtar i Aleancës e ka orientuar dhe ndihmuar Forcën e Armatosur të transformohet dhe zhvillohet në një forcë ushtarake pragmatike. Në konceptin dhe vizionin tim, unë shikoj dhe besoj që Shqipëria duhet të zhvillojë dhe mbajë kapacitete operacionale ushtarake të nevojshme, të arsyeshme dhe reale për t'iu përgjigjur në kohë nevojave të brendshme dhe për të siguruar kontribute ushtarake modeste por dinjitoze për Aleancën, BE-në, OKB-në dhe koalicione të mundshme. Ne e ndjejmë që ambienti i sigurisë është bërë shumë kompleks, i paparashikueshëm, i paqartë dhe i cenueshëm, prandaj edhe forca jonë ushtarake duhet të jetë shumë fleksibile dhe zhvillimi i kapaciteteve shumë dinamik. Është e qartë që kjo do mbështetje, por mbështetja nuk ka munguar, përkundrazi, Qeveria, por jo vetëm, ka treguar një vëmendje të shtuar ndaj Forcave të Armatosura. Kjo vëmendje është dhe duhet të jetë edhe në strukturat dhe autoritetet e tjera shtetërore.

Në të vërtetë, mendoj se është e evidente një nevojë e qartë që të zhvillojmë një sistem sa më të integruar të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo presupozon që parlamenti të punojë më nga afër me qeverinë dhe fushën e sigurisë e të mbrojtjes. Ndonëse ata punojnë për të njëjtin qëllim, rolet e tyre në thelb janë dhe duhet të jenë të ndryshme. Parlamenti ka përgjegjësinë e përcaktimit të parametrevë ligjorë, duke miratuar buxhetin dhe duke realizuar mbikëqyrjen e veprimtarive që lidhen me sigurinë. Si deputet i Parlamentit, por edhe si ish-ushtarak, unë do të kem angazhimin tim maksimal për këtë qëllim. Forcat e Armatosura e meritojnë çdo mbështetje dhe sakrificë të taksapaguesve shqiptarë. Përkushtimi dhe vullneti i njerëzve tanë në uniformë për t'i shërbyer vendit në kohë nevojë dhe të vështira dhe shpeshherë jo pa rrezik, shërbimi dhe sakrifica për të mbajtur denjësisht uniformën me simbolin e Shqipërisë, vlerësohet dhe respektohet nga të gjithë qytetarët shqiptarë. Është rasti, në këtë 110-vjetor, të përhëndesim të gjithë efektivët e Forcave të Armatosura, që kanë shërbyer dhe shërbejnë në emër të Shqipërisë, brenda dhe jashtë vendit. Një homazh i ndjerë për të gjithë heronjtë dhe dëshmorët që kanë sakrifikuar jetën e tyre në këtë rrugëtim mbi shekullor të Forcave tona të Armatosura.









**USHTRIA  
SHQIPTARE**

**77  
VJET**